



VSM - HZK KOMUNA E GJAKOVËS

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i
Hartës Zonale Komunale të Komunës së Gjakovës

2022 - 2026



INSTITUTI PËR SHKENCË DHE TEKNOLOGJI "INSI" Sh.P.K
Bregu i Diellit, Qendra e re Tregtare, Nr.42 - Prishtinë

Përmbajtja

Direktiva VSM e BE-së	9
Direktiva të tjera të BE-së.....	9
Strategjia 2020 e BE-së.....	10
Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB.....	10
Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit.....	11
Konventa Århus.....	11
Konventa ESPOO dhe Protokollin e Kievit.....	11
Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse	12
Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor	12
Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM).....	13
Planet dhe programet e tjera të rëndësishme	13
Pozita gjeografike	15
Veçoritë mjedisore	16
Karakteristikat hidrografike.....	19
Relievi (Hipsometria e terrenit).....	20
Kushtet klimatike.....	22
Biogjeografia	23
Rreziqet natyrore.....	27
KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE	28
Shfrytëzimi i tokës	42
1. VENDBANIMET	43
Sipërfaqja e vendbanimeve nënkupton sipërfaqen e ndërtuar të qendrës urbane të Gjakovës, subqendrave, qendrave locale dhe fshatërave. Në kuadër të saj përfshihen banimi, infrastruktura sociale dhe fizike.	43
2. TOKA E PUNUESHME	43
Paraqet tokën e cila është e shfrytëzuar për :	43
2a) BUJQËSI- që paraqet zonën e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore:	43
arë, kopsht, pemishte, livadh, kullosë si dhe tokat tjera shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor dhe zhvillimin e blegtorisë duke marrë parasyh vetitë natyrore dhe kushtet ekonomike.....	43
2b) KULLOSA- tokë e mbuluar kryesisht me vegjetacion natyror bimor e cila shërben për.....	43
kullotjen, lëshuarjen dhe pushimin e bagëtisë.....	43
3. VEGJETACIONI I LARTË	43
Këtu përfshihen të gjitha sipërfaqet mbi 0.2 ha të populluara në mënyrë të dendur me bimësi drunore.	43
4. ZONAT ME INTEREST TË VEÇANTË.....	43
5. LUMENJTË	44
Të gjitha ujërat sipërfaqësor të vazhdueshëm ose periodik siç janë: lumenjtë, pellgjet, liqenet dhe sipërfaqe të ngjajshme.....	44
6. SIPËRFAQET PËR TRANSPORT	44
Sipërfaqet për transport përbëhen nga korridoret për transport:	44
6a) Rrugët nacionale- janë korridore të cilat lidhin Kosovën me vendet fqinje.....	44
6b) Rrugët rajonale-nënkupton rrugën publike që lidh dy ose më shumë qytete të mëdha	44
6c) Rrugët kryesore lokale-janë rrugët publike që lidhin qendrat e bashkësive lokale brenda.....	44
komunës së Gjakovës.....	44

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

6ç) Rrugët lokale-janë rrugët publike që lidhin vendbaimet me rrugën kryesore lokale brenda komunës së Gjakovës.....	44
6d) Rrugët malore- shfrytëzohet për mirëmbajten dhe monitorimin e zonave malore, pyjeve si dhe për zhvillimin e turizmit.....	44
6dh) Rrugët turistike- paraqet rrugën publike që lidh pika të rëndësishme atraktive natyrore dhe kulturore në territorin e komunës.	44
7. QENDRAT	44
7a) Qendra kryesore- paraqesin qendrat urbane ku gjenden të gjitha shërbimet në nivel komunal.....	44
7b) Subqendra- janë qendra lokale ku ofrohen veprimtaritë shërbyese të decentralizuara me qëllim të zvogëlimit të qarkullimit të panevojshëm në drejtim të qendrës kryesore- Gjakovës, për shërbimet të cilat mund të ofrohen në kuadër të subqendrave.	44
7c). Qendrat lokale- janë qendrat e bashkësisve lokale ku ofrohen shërbimet në nivel të bashkësisë locale.	44
Infrastruktura e energjisë elektrike.....	78
Infrastruktura e ujësjellësit.....	90
Rrjeti i Ujësjellësit	90
Rrjeti i Kanalizimit.....	99
Zonat me Probleme Mjedisore	106
Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore	106
Agrumente të Analizës SWOT	107
Pikat e forta.....	107
Pikat e dobëta	107
Mundësitë	108
Kërcënimet	108
SHKALLA QË HZK-ja NDIKON NË PLANET E TJERA.....	111
Disa nga aspekte kryesore të gjendjes aktuale mjedisore	111
Shëndeti.....	111
Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin	112
Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen	112
Zonimi i territorit të komunës.....	112
Zona të mbrojtura	113
Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale.....	113
Pyllzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit	113
Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik.....	113
Biodiversiteti, Flora dhe Fauna	114
Rreziqet natyrore në mjedisin fizik.....	116
Mjedisi i ndërtuar dhe kultura	116
Cilësia e ajrit	116
Zhurma dhe Kundërmimi.....	117
Burimet ujore dhe furnizimi me uje	118
PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISOREVI. QËLLIMET E VSM-së PËR HARTËN ZONALE KOMUNALE TË GJAKOVËS	120
6.1 Projekt-Raporti perfundimtar	123
6.2 Roli dhe natyra e Hartës Zonale Komunale	123
6.3 Kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin komunal	124

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Kritere të forta mjedisore-shëndetësore	124
Kritere të trashëgimisë kulturore.....	125
Kriteret peisazhike	125
ZHVILLIMIN KOMUNAL.....	126
VIII. VSM - VLERËSIMI STARTEGJIK MJEDISOR I KOMPONENTEVE KRYESORE	
MJEDISORE.....	127
IX. KUSHTET ZHVILLIMORE të HZK-së KUNDREJT OBJEKTIVAT TË VSM-së	128
XI. PROBLEME TË MJEDISIT NË GJAKOVË DHE PËRGJIGJA QË JEPET PËRMES KUSHTEVE	
ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME, KUSHTEVE ZHVILLIMORE DHE MASAVE NË HZK.....	140
MONITORIMI.....	150
PERFUNDIME	154
LITERATURA.....	156

Tabelat

Tabela 1. Veçoritë gjeologjike	16
Tabela 2. Ndjeshmëria e ujërave nëntokësorë.....	20
Tabela 3. Ndarja e pjerrtësisë së terrenit sipas këndit të rënies (A. Bognarit).....	21
Tabela 4. Asetet e trashëgimisë natyrore të mbrojtur	26
Tabela 5. Popullsia e Komunës së Gjakovës sipas vendbanimeve (1948 – 2011);	30
Tabela 6. Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor në Komunën e Gjakovës;	32
Tabela 7. Popullsia e Komunës së Gjakovës sipas grup – moshave për periudhën 1961 – 2011;	35
Tabela 8. Shkalla e lindjeve në nivel komune sipas viteve;.....	38
Tabela 9. Numri i ekonomive familjare sipas vendbanimit;	40
Tabela 10. Asetet e trashëgimisë natyrore të mbrojtur	46
Tabela 11 Numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë (ASK)	49
Tabela 12. Kategorizimi i rrugëve	50
Tabela 13 Rrjeti rrugor në komunën e Gjakovës	52
Tabela 14 Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore.	61
Tabela 15 Vlerat minimale të rrezes së rrubullakësimit (harkut) në udhëkryqe	63
Tabela 16 Distanca dhe vendndodhja e vendkalimeve për këmbësorë	67
Tabela 17 Numri i vend-parkingjeve për biçikleta	70
Tabela 18 Kriteret për shfrytëzimin e infrastrukturës së përbashkët nga çiklistët dhe këmbësorët.....	70
Tabela 19 Gjerësia e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave	70
Tabela 20 Elementet teknike minimale horizontale në varësi të shpejtësisë së hyrjes	75
Tabela 21 Gjatësia e vendndaljes dhe zona e pritjes së autobusit në varësi të shpejtësisë së hyrjes, llojit të autobusit dhe numrit të autobusëve që ndalojnë në ndalesë në të njëjtën kohë.....	75
Tabela 22 Linjat transmetuese të energjisë elektrike me karakteristikat teknike.....	79
Tabela 23 Linjat transmetuese të tensionit të lartë dhe të mesëm në komunën e Gjakovës	82
Tabela 24 Te dhënat e transformatorëve energjetik të të gjitha niveleve të tensionit në distriktin e Gjakovës.....	83
Tabela 25 Te dhënat mbi kategoritë e shpenzuesëve dhe shpenzimi dhe ngarkesa në rrjet.....	83
Tabela 26 Koridoret që duhet të sigurohen për stabilimente energjetike –linja kablore egzistuese dhe ndertime të reja.....	84
Tabela 27 Koridoret që duhet të sigurohen për stabilimente energjetike –linja ajrore egzistuese dhe ndertime të reja.....	84
Tabela 28. Elementet e përfshira në VSM	127
Tabela 29. Lista e zonave bazë	128

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Tabela 30 Kushtet zhvillimore për zonat e banimit individual.....	129
Tabela 31 Kushtet zhvillimore për zonat e banimit kolektiv.....	130
Tabela 32. Lista e Zonave Mbishtresore.....	132
Tabela 33. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të HZK-së në komponentet mjedisore.....	139
Tabela 34 Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas HZK-së.....	141

Figurat

Figura 1 Rrugët nacionale dhe rajonale në komunën e Gjakovës.....	51
Figura 2 Brezi mbrojtës rrugor.....	61
Figura 3 Kushtet për kufizimin e shpejtësisë në rrugët lokale.....	64
Figura 4 Klasifikimi funksional i rrjetit rrugor.....	65
Figura 5 Kriteret për përzgjedhjen e vendkalimit optimal për këmbësorë.....	68
Figura 6 Shtegu dhe korsia për biçikleta.....	69
Figura 7 Brezi mbrojtës dhe rregullues hekurudhor.....	73
Figura 8 Elementet teknike minimale horizontale të vendndaljes së autobusit.....	75
Figura 9 Rrjeti nga furnizohet me energji elektrike komuna dhe rrethi i Gjakovës.....	78
Figura 10 Shtrirja e rrjetit 110 kV në qytetin e Gjakovës (linjat dhe nënstacionet).....	80
Figura 11 Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 35 kV (linjat dhe nënstacionet).....	81
Figura 12 Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 10 kV (linjat).....	82
Figura 13 Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 10 kV ne qytetin e Gjakovës (linjat).....	82
Figura 14 Detali i Ujëmatësit Zonal me standard.....	96
Figura 15. Detali i vendosjes së gypave të ujit dhe kanalizimi në një kanal në zona urbane dhe ruala, në riparimin e infrastrukturës së vjetër dhe investime të reja.....	98
Figura 16 Puset për ndarjen e ujerave të përziera (Owerflow Chamber).....	103

Hartat

Harta 1 Pozita gjeografike e komunës së Gjakovës.....	16
Harta 2 Formacionet pedologjike.....	18
Harta 3. Harta e formacioneve gjeologjike.....	19
Harta 4. Harta e hidrogjeologjisë.....	20
Harta 5. Hipsometria e terrenit.....	22
Harta 6. Vlerat e llogaritura të biodiversitetit.....	25
Harta 7. Dendësia e popullsisë për m2.....	36
Harta 8 Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve.....	37
Harta 9. Shfytëzimi i tokës.....	45
Harta 10. Ndikimi i HZK-së në ekosistemet natyrore.....	137
Harta 11. Parashikimi i ndikimeve të HZK-së në aspektin hapësinor.....	138

LISTA E SHKURTIMEVE

MMPHI - Ministria e Mjedisit i Planifikimit Hapësinor dhe

AKMM - Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit

BE - Bashkimi Evropian

KK - Komuna Gjakovës

GIS – Sistemi i Informacionit Gjeografik

GNP - Grimcat e Ngurta Pezull

NOQ - Ndotsë Organike të Qëndrueshem

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ - Organizata Jo Qeveritare

VBJ – Vendbanime jo Formale

OZHM - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal

HZK - Harta Zonale Komunale

PRRH – Plani Rregullues i Hollësishëm

TeR - Termet e Referencës

UNDP - Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP - Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara

VNM - Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VSM - Vlerësim Strategjik Mjedisor

ZVM - Zona e Veçanta e Mbrojtura



Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

HYRJJE

HYRJE

Hartimi i raportit të VSM-së për Programe, Plane Zhvillimore dhe Projekte të mëdha është detyrim ligjor. Qëllimi i raportit të VSM-së për Hartën Zonale Komunal të Gjakovës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikepamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet për kushtet zhvillimore dhe masat e HZK.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis“ dhe ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë, i cili është transpozimi i direktives së BE 2001/42/EC.

VSM-ja duhet të përfshijë pikat e mëposhtme:

- Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- Përshkrim të Vizionit, prioritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Gjakovës dhe marrëdhëniet e tij me politikën, Planin dhe Programet e tjera që kanë lidhje me të dhe reflektimi i tyre në HZK;
- Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani;
- Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me Planin dhe Programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
- Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

HZK për numurin e madh dhe diversitetin e gjerë të problematikës që trajton, kërkon konsultimin e një game të konsiderueshme dokumentacioni. Bëhet fjale për plane, raporte, projekte, studime dhe literaturë teknike nga sektorë të ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përvec materialeve që dispononte vete grupi hartues i VSM-s, u siguroi nga komuna e Gjakovës institucione të tjera publike dhe kerkimet në internet.

Raporti i Vlerësimi Strategjik Mjedisor të HZK është dokument i pari i llojit të tij që hartohet për këtë qëllim, dhe si i till besohet se do mundësojë që zhvillimet e ardhshme të jenë në harmoni me legjisllacionin vendore të mjedisit, si dhe me direktivat dhe konventat ndërkombëtare.

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktive nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti i Evropian..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legjislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & venditosen shfrytëzimet e tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejn një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmblihet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet eksultimeve merrën parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinionin dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke ushqyrtuar çështjet mjedisore dhe të. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha¹ është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor me që bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetete strategjisë janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nismat e tjera si *Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë përshkathtësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë* dotë mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme sipër shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjëra tepër të ritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB kan një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë përmes misionëve dhe projekteve të ndryshme në mënyrë që t’isigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mblodhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë iahte bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit². Ishin 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtoheshin qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohej vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programete vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetëte sëpaku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

¹http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit u bë një progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi axhendën e zhvillimit të post 2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Axhenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk e arritën. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, mjedisi konsiderohet të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa qështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore dhe në cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posatshme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva tjera substancialisht përmbajn çshtjet mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollit i Kievit

Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasjen...,1998) Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartoj në dis pozitave e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat iposedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- Të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisorenë për gjithësi.

Konventa ESPOO dhe Protokollit i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi..... Mjedisor, 1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktivitetëve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra

tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenën dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008).

Protokoll i Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë dotë mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokoll i është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësim i Strategjiki Mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin qëndrueshëm. Protokoll i poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokoll i kërkon që vlerësimi strategjik mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillimi rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (Qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 8 vjetëve dhe ta përfshijë një Plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e Planeve duhet të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin Plan obligohet përgaditja e raportit të VSM paralelisht me Planin.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

politikat për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin zhvillimet urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmonime politikat dhe programet nacionale si dhe duke rrespektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)

Ligji Nr. 03/L-230 nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të Planeve dhe të Programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e Planeve dhe e Programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato Plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi për katë s' duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet e tij. Raport i VSM-së identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikime të mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i Planit ose Programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në Ligj në mënyrë që t'iu ofrojnë qasje në dokumente të VSM-së organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM-së është një dokument për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa të posaçme për raste të këshillimeve ndërkuftare. Para se të aprovohet raporti VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Po ashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kriteret e caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve të VSM-së.

Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjisllacionit raporti i VSM-së duhet të merr parasysh edhe Planin Hapsinor të Kosovës 2010-2020+, Strategjin për Mjedisin dhe Planie Veprimi në Mjedis, si dhe disa Plane, Programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE

Pozita gjeografike³

Gjakova shtrihet midis gjerësisë gjeografike 42,22 dhe gjatësisë gjeografike 20,26 në bregun e majtë të lumit të Erenikut, në lindje të pllajës së Çabratit, në të dy anët e lumit Krena, në një lartësi mbidetare mesatare prej 365 metrash.

Në jugperëndim të Gjakovës shtrihen rrëzët e fundit të maleve të Pashtrikut, ku shtrihet krahina kodrinore e Hasit, e cila përfundon me rrafshinën aluviale (lumore) të Erenikut.

Në veri të qytetit shtrihen fushat neogjene të Piskotës dhe të Dushkajës. Sukat e Koznikut, të Cermjanit, të Baballoqit dhe të Hereçit e ndajnë fushëgropën e Gjakovës nga Rrafshi i Dukagjinit.

Në perëndim të Çabratit, që ka një lartësi mbidetare prej 440-460 metrash, shtrihen malet e Junikut dhe të Shkëlzenit-pjesë të Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare).

Në lindje të Gjakovës, aty ku derdhet Ereniku në Grykën e Drinit të Bardhë shtrihet pllaja gëlqerore e Gradishës, e cila e ndanë fushëgropën e Gjakovës prej asaj të Prizrenit.


Malet e ulëta me qafa siç janë Qafa e Prushit, ajo e Dobrunës, ajo e Morinës etj., kanë mundësuar ndikimin e erërave të Detit Adriatik nëpër luginën e Drinit. Prandaj Gjakova me rrethinë ka klimë të mesme kontinentale me elemente të asaj mesdhetare me verë të nxehtë dhe të thatë.

Fushë gropën e Gjakovës e përshkojnë 80 rrjedhje të ujërave sipërfaqësore që burojnë në veri nga vargu malor i Cermjanit dhe nga kurorat malore në jug të qytetit. Të 80-të përrojet derdhen në Erenik, i cili me degët e tij, e ujisin fushën pjellore të Gjakovës. Ai buron nga liqenet akullnajorë të Gjaravicës dhe derdhet në Dri, me një gjatë 51 km. Prej degëve të tij të majta është Bistrica e Lloqanit, që buron prej lartësisë Ploça në perëndim të Gjaravicës dhe, duke e ndarë Gjakovën me emrin Krena në dy pjesë, derdhet në Erenik, Trava, Trakaniqi, Raça etj. që janë lumenj tipikë fushorë që derdhen në Erenik.

Në pjesën jug-perendimore të Gjakovës shtrihen malet e Pashtrikut që fillojnë nga Qafa e Morinës e deri në luginën e Drinit të Bardhë në Vërmicë. Këto male shtrihen në mes të luginës së Drinit e Valbonës në Shqipëri dhe luginës së Erenikut e Drinit në Dukagjin.

Këto male janë më të ulëta, në to gjenden dy qafa: Qafa e Morinës dhe Qafa e Prushit dhe përfundojnë me Malin e Pashtrikut me 1988 metra lartësi i cili është i zhveshur dhe shkëmborë, me forma karstike dhe me pak ujë sipërfaqësor.

³ *Plani zhvillimor komunal dhe urban 2006-2015+ dhe web faqja e komunës*



Harta 1 Pozita gjeografike e komunës së Gjakovës

Veçoritë mjedisore⁴

Pedologjia (Përmbajtja pedografike)

Territori i komunës karakterizohet me përbërje të ndryshme pedologjike dhe morfologjike. Në pjesën rrafshinore, në lartësinë më të ulët mbidetare përreth luginës së lumit dhe fushëgropës së Gjakovës, përgjatë tërë gjatësisë së saj, dominojnë tokat shumë të pjellshme. Këto janë toka mjaft produktive, që japin edhe rendimente të mira nga të mbjellat me kultura të ndryshme bimore.

Sipërfaqet e rrafshëta, janë toka të pjellshme dhe të mbjella me kultura të ndryshme bimore, shpesh edhe me bimë industriale, si duhan etj. Luginat aluviale lumore kanë tokë të përshtatshme për kultivimin e shumë llojeve të kulturave bimore.


Tabela 1. Veçoritë gjeologjike

Kategoritë gjeologjike	Sipërfaqja (ha)	%
Alluvium	4997	9.03
Deluvium	464.47	0.84
Gabbro	326.68	0.59
Massive sandy limestone with rudists	1290.32	2.33
Serpentinised peridotite	1960	3.54
Pyroxenite	255.44	0.46
Serpentinite	1633	2.95

⁴ Të dhënat EULUP dhe Plani local i veprimit në mjedis 2019-2023

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026


Sandstone, phyllite, chlorite schist, conglomerate, chert, limestone	1960	3.54
Limestone, dolomite	188.6	0.34
Keratophyre, quartz keratophyre	22.28	0.04
Limestone, marlstone, calcarenite ëith chert	5.38	0.01
Limestone, dolomite, breccia	347.5	0.63
Feldspar-peridotite rock	116.5	0.21
Glacial sediment (moraine)	455.8	0.82
Gabbro-diabase	1367	2.47
River terrace	10479	18.93
Lake and river sediments	4648	8.40
Sand, clay, gravel, partly tuffite and lignite	16250	29.35
Proluvium	102.4	0.18
Orthoschist (epidote, actinolite and chlorite schist)	49.45	0.09
Marl, clay, sand, gravel	4248	7.67
Diabase, spilite, basalt	724.7	1.31
Conglomerate, breccia, sandstone, limestone	1922	3.47
Clastic sediments with fragments of diabase, chert, limestone with algae and rudists	184.4	0.33
Gabbro-diabase	1367	2.47



Harta 2 Formacionet pedologjike

Gjeologjia dhe tokat

Vlerësimi i përshtatshmërisë së terrenit për ndërtim, i evidentuar në pikëpamje hapësinore, është bërë sipas kriterëve të bartshmërisë dhe stabilitetit në terrene stabile, kushtimisht-stabil edhe jo stabil. Terreni sizmik aktiv, në kuptimin më të gjerë është karakteristikë edhe për rajonin e Gjakovës me tërmete të mundshme me intensitet deri 6-7 shkallë të rihterit. Toka e Gjakovës në aspektin gjeologjik apo përmbajtje të shkëmbinjve përbehet nga lloje të ndryshme të cilat janë të radhitura si më poshtë.



Harta 3. Harta e formacioneve gjeologjike

Karakteristikat hidrografike

Resurset ujore janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Lumenjtë dhe rrjedhat tjera ujore në Gjakovë janë pjesë e pellgut ujqor të lumit Drini i Bardhë, i cili formon kufijtë e Gjakovës me komunën e Rahovecit në lindje.

Lumi Ereniku- e ka burimin e tij në Bjeshkët e Nemuna dhe rrjedhë përmes territorit të komunës dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Ndërsa lumenjtë dhe përrenjë të vegjël si: Neci, Trava, Krena dhe Trakaniqi Raça, duke rrjedhur nga veriu në jug, derdhen në lumin Ereniku. Sot shtrati dhe brigjet e lumit janë degraduar nga shfrytëzimi i pa kontrolluar i rërës dhe zhavorrit.

Lumi Krena - kalon përmes qytetit dhe shtrati i tij është rregulluar në një gjatësi prej 1400m. Gjendja e lumit deri më tani ka qenë e mjerushme, po që aktualisht kanë përfunduar punimet në një pjesë të tij dhe deri në vitin 2021 pritet të rregullohet në tërësi.

Lumi Trakaniq - kalon në pjesën lindore të qytetit dhe shtrati i tij nuk është i rregulluar. Aktualisht gjendja e tij nuk është e kënaqshme jo vetëm përshkak të shkatërrimeve të ndryshme por edhe nga hudhja e mbeturinave në shtrat apo përgjatë tij.


Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Liqeni i Radoniqit - Në Komunën e Gjakovës ekziston edhe Liqeni i Radoniqit i cili ka filluar të mbushet në vitin 1982 nga ish lumi Radoniq dhe Lumbardhi i Deçanit me anë të kanalit derivues me ngritjen e Pendës që gjendet në Llukë të Epërme, dhe është në funksion që nga viti 1985. Kapaciteti maksimal i këtij Liqeni është rreth 117 milion m³ deri në kuotën mbidetare 456m.

Pjesa më e madhe e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësor në Gjakovës është e mesme me një sipërfaqe prej 23,027.09 ha apo 39.30 % të territorit, ndërsa sipërfaqja prej 14,532.63 ha apo 24.80 % e territorit të komunës ka ndjeshmëri shumë të lartë të ujërave nëntokësore.

Tabela 2. Ndjeshmëria e ujërave nëntokësorë

Kategoria	Sipërfaqja (ha)	Përqindja %
Ndjeshmëri shumë e ulët e ujërave nëntokësorë	14,532.63	24.80
Ndjeshmëri e ulët e ujërave nëntokësorë	2103.28	3.59
Ndjeshmëri e mesme e ujërave nëntokësore	23,027.09	39.30
Ndjeshmëri e lartë e ujërave nëntokësorë	7817.14	13.34
Ndjeshmëri shumë e lartë e ujërave nëntokësorë	11,109.51	18.96



Harta 4. Harta e hidrogeologjisë

Relievi (Hipsometria e terrenit)

Relievi karakterizohet nga një plastikë dinamike, sepse lumenjtë malorë bashkë me përrënjtë me energji të madhe kanë bërë erozionin duke formuar lugina relativisht të thella, të cilat

ndajnë malet e Pashtrikut njërin prej tjetrit në forma të izoluara malore dhe kodrinore. Kuptohet, pamjes së tyre morfologjike të tanishme i ka paraprirë predispozicioni i lëvizjeve tektonike që ndodhën në kohën e terciarit, ku mbi shtresat gëlqerore janë formuar shtresa të trasha të shkëmbinjve vullkanikë, të cilët, si rezultat i proceseve post-vullkanike janë bartëse të xeheve të plumbit e të zinkut.

Gjakova shtrihet midis gjerësisë gjeografike 42,22 dhe gjatësisë gjeografike 20,26 në bregun e majtë të lumit të Erenikut, në lindje të pllajës së Çabratit, në të dy anët e lumit Krena, në një lartësi mbidetare mesatare prej 365 metrash.

Pika më e ulët e terrenit është rrjedha e Lumit Drini i bardhë 300 m/lmd në Lluka-Sakra – Z.k. Rogovë, kurse pika më e lartë është në Bjeshkët e Nemuna Rrasa e Zogut 2305 m/lmd Z.K. Koshare.

Në jugperëndim të Gjakovës shtrihën rrëzët e fundit të maleve të Sharit, ku shtrihet krahina kodrinore e Hasit, e cila përfundon me rrafshinën aluviale (lumore) të Erenikut.


Në perëndim të Çabratit, që ka një lartësi mbidetare prej 440-460 metrash, shtrihën malet e Junikut dhe të Shkëlzenit-pjesë të Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare).

Përcaktimi i pjerrtësisë së territorit e sidomos i pjerrtësisë së shpateve jo stabile ka rëndësi të madhe praktike. Nëpër sipërfaqet e shpateve të pjerrëta zhvillohen shumë veprimtari njerëzore dhe procese natyrore morfodinamike. Proceset si erozioni, rrëshqitjet, shembjet etj. mund të jenë jashtëzakonisht të dëmshme në ato hapësira në të cilat paraqiten. Kriteret për kategorizimin e sipërfaqeve sipas pjerrtësisë së terrenit ndryshojnë varësisht nga qëllimet e kërkimeve shkencore dhe kategorizimit sipas autorëve të ndryshëm. Sipas A. Bognarit (1991) në sipërfaqe të rrafshëta hyjnë ato sipërfaqe këndi i rënies te të cilat është nga 0-20, terrenet me pjerrtësi të butë 2-50, terrenet me pjerrtësi të konsiderueshme 5-120, terrenet me shpate shumë të pjerrëta 12-350 dhe terrene me shpate të rrëpishme mbi 550. Po ashtu, i njëjti autor ka bërë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së pjerrtësisë së terrenit për ndërtim, i cili kategorizim është pak i dallueshëm me kategorizimin e lartpërmendur. Sipas këtij kategorizimi terrene shumë të përshtatshme për ndërtim janë ato me pjerrtësi 0 - 20, terrene të përshtatshme për ndërtim 2 - 50, terrene të përshtatshme për ndërtim me intervenime adekuate 5 - 120, terrene të papërshtatshme për ndërtim me përjashtime të caktuara 12 - 320 dhe mbi 320 terrene të pa përshtatshme për ndërtim.

Tabela 3. Ndarja e pjerrtësisë së terrenit sipas këndit të rënies (A. Bognarit)

Këndi i rënies	Emërtimi
0 - 20	Terrene shumë të përshtatshme për ndërtim
2 - 50	Terrene të përshtatshme për ndërtim
5- 120	Terrene të përshtatshme për ndërtim me intervenime adekuate
12-320	Terrene të papërshtatshme për ndërtim me përjashtime të caktuara
Mbi 320	Terrene të pa përshtatshme për ndërtim

Llogaritjet e këndit të rënies së terrenit janë bërë duke u bazuar në modelin digjital relievor “EUDEM” i cili ka përmasat e rezolucionit hapësinor 25*25m.




Harta 5. Hipsometria e terrenit

Kushtet klimatike

Komuna e Gjakovës karakterizohet me një klimë kontinentale me verë të nxehtë dhe me dimër të ftohtë, ku muaji më i nxehtë është muaji Gusht dhe muaji më i ftohtë është muaji Janar. Pozita gjeografike e Gjakovës me rrethinë ka kushtëzuar që në këtë regjion të dominojë klima e mesme kontinentale me një ndikim të klimës mediterane, e cila depërton përmes luginës së Drinit të Bardhë.

Në bazë të shënimeve shumë vjeçare klimatike, lokaliteti i Gjakovës karakterizohet me këto veçanti meteorologjike: Temperatura mesatare vjetore është +11.9 °C, muaji më i ftohtë i vitit është Janari me temperaturë mesatare -0.1°C, ndërsa muaji më i nxehtë i vitit është Gushti me +22.2°C. Temperatura mesatare gjatë vegjetacionit është +18,6°C ndërsa sasia e reshjeve vjetore 754,8mm por sasia e reshjeve gjatë vegjetacionit është vetëm 342,90mm.



Grafiku 1. Temperaturat mesatare vjetore Burimi: AMK

Biogjeografia

Flora⁵

Në kuadër të shumëllojshmërisë së botës së gjallë-biodiversitetit, vend me rëndësi padyshim se ka edhe mbulesa bimore apo thënë ndryshe flora dhe vegetacioni.

Sipas ndryshimeve bazuar në lartësinë mbidetare, në shtrirje vertikale të florës dhe vegetacionit të territorit të komunës së Gjakovës dallojmë disa zona. Këto zona janë të ndryshme varësisht nga pozita gjeografike, përbërja gjeologjike, relievi, madhësia e masivit të caktuar.

Në terrene në fragmente të shkëputura e shpesh të vogla si rezultat i veprimit antropogjen rriten lloje bimore të ultësirave të cilat hyjnë në kuadër të vegetacionit të pyjeve respektivisht shkurreve me shelg e plep por edhe me verr e marinë (brukë) të cilat zhvillohen më tepër përgjatë luginave lumenjëve, ndërsa në aspektin sintaksonomik i takojnë klasëve *Querco-Fagetea* e *Alnetea glutinosae*, rëndeve *Alnetalia glutinosae* dhe *Populetalia albae* si dhe alencave *Alnion glutinosae*, *Salicion albae* dhe *Populion albae*. Llojet më të shpeshta bimore të këtyre hapësirave në katin e drurëve janë prezente llojet *Salix alba* (dominon), *Populus nigra*, *Ulmus effusa*, *Alnus glutinosa*, *Salix fragilis*. Në katin e shkurreve janë prezente llojet bimore *Salix purpurea*, *Frangula alnus*, *Cornus sanguinea*, *Tamarix tetrandra* ndërsa në katin e bimëve barishtore gjenden llojet bimore *Galium palustre*, *Alisma plantago aquatica*, *Veronica anagallis*, *Mentha aquatica*, *Agrostis alba*.

Në hapësira të ultësirave pjesë të konsiderueshme u takojnë livadheve të ultësirave të cilat në aspektin sintaksonomik i takojnë aleancës *Trifolion resupinati*, rendit *Trifolio-Hordetalia* dhe klasës *Molinio-Arrhenatheretea* (Hundozi, B. 1980, Rexhepi, F. 1982, 1994, 2007, Krasnqi, E. 2003, 2006, Kastrati, A. 2015). Në këto livadhe janë prezente llojet bimore karakteristike për livadhet e ultësirave si: *Equisetum arvense*, *Equisetum palustre*, *Bellis perennis*, *Taraxacum*

⁵ PLVM 2019-2023

officinale, Tragopogon pratensis, Capsella bursa-pastoris, Rorippa pyrenaica, Dianthus armeria, Stellaria graminea, Convolvulus arvensis, Helianthemum nummuularium, Euphorbia cyparissias, Lotus corniculatus, Ononis spinosa, Trifolium pratense, Trifolium repens, Erodium cicutarium, Ajuga reptans, Mentha longifolia, Prunella laciniata, Prunella vulgaris, Salvia verticillata, Plantago lanceolata, Plantago media, Polygala vulgaris, Lysimachia nummuularia, Ranunculus acris, Ranunculus ficaria, Ranunculus millefoliatus, Filipendula vulgaris, Potentilla reptans, Sanguisorba minor, Cruciata laevipes, Gratiola officinalis, Parentucellia latifolia, Rhinanthus minor, Veronica beccabunga, Allium vineale, Carex distans, Scirpus lacustris, Juncus articulatus, Juncus effusus, Colchicum autumnale, Orchis laxiflora, Orchis morio, Agropyrum repens, Alopecurus pratensis, Briza media, Bromus sterilis, Chrysopogon gryllus, Cynodon dactylon, Cynosurus cristatus, Holcus lanatus, Lolium perenne, Poa pratensis. Reptans, Sanguisorba minor, Cruciata laevipes, Gratiola officinalis, Parentucellia latifolia, Rhinanthus minor, Veronica beccabunga, Allium vineale, Carex distans, Scirpus lacustris, Juncus articulatus, Juncus effusus, Colchicum autumnale, Orchis laxiflora, Orchis morio, Agropyrum repens, Alopecurus pratensis, Briza media, Bromus sterilis, Chrysopogon gryllus, Cynodon dactylon, Cynosurus cristatus, Holcus lanatus, Lolium perenne, Poa pratensis.

Fauna

Komuna e Gjakovës ka një faunë mjaft të pasur me një numër të madh organizmave të renditura si me poshtë. **Ichtiofauna e Gjakovës:** *Eudontomyzon stankokaramani Karaman, Rhodeus meridionalis Karaman, Phoxinus phoxinus, Barbus barbus, Alburnoides bipunctatus, Squalicus cephalus, Leuciscus leuciscus, Leucaspius delineatus, Barbus rebeli, Chondrostoma nasus, Cyprinus carpio, Carassius gibelio, Scardinius erythrophthalmus, Ctenopharyngodon idella, Gobio gobio, Pseudorasbora parva, Alburnus alburnus, Rutilus rutilus, Cobitis ohridana Karaman, Sabanejeëia balcanica, Cottus gobio Linnaeus, Perca fluviatilis, Salmo trutta Linnaeus.*

Ujëtokësorët me bisht - Caudata: Salamandra atra, Salamandra maculosa, Triturus vulgaris, Triturus alpestris, Triturus cristatus.


Ujëtokësorët pa bisht -Eucaudata: Rana ridibunda, Rana graeca, Rana dalmatina, Rana temporaria, Bufo vulgaris, Bufo viridis, Bombinator pachypus.

Reptilia ose rrëshqitësit: Vipera ammodytes, Natrix natrix, Natrix tessellata, Dolichophis caspius, Coronella austriaca, Zamenis longissimus, Testudo hermanni, Algyroides nigropunctatus, Emys orbicularis, Podarcis muralis, Lacerta agilis, Lacerta viridis, Anguis fragilis, Podarcis tauricus.

Shpezët (Aves): Regjioni i Gjakovës është poashtu i pasur me një shumëllojshmëri të shpezëve (mbi 150 lloje) ku pjesën më të madhe e dominojnë shpezët këngëtare (*familja Corvidae, Paridae , Motacillidae, Turdidae, Sylvidae, Lanidae, Hirundinidae, Columbidae*), pastaj grabitësit e vërtetë të sistematizuar në rendin Faloniformes me familjet *Aqualidae dhe Falconidae*. Disa prej shpezëve janë të përhershme (*harabelat, pëllumbi i egër, kumria, pikthat,*

kukuvajka, huti, përfaqësues të familjes corvidae). Disa prej tyre vijnë gjatë verës (Mars-Prill dhe qëndrojnë deri në shtator- tetor, e disa tjera vijnë në vjeshtë dhe qëndrojnë deri në pranverë ose disa tjera që shihen kalimthi dhe mund të shihen ose në pranverë apo edhe në vjeshtë. Disa shpezë ndonjëherë mund të jenë të dëmshme duke u ushqyer me fara dhe frute të ndryshme të pemëve, me fara dhe frute të drithërave duke ju shkaktuar dëme të mbjellurave dhe kopshtijeve, pastaj me vezë dhe të vegjël të shpezëve shtëpiake, por në të njëjtën kohë të njëjtat shpezë me sukses i shfarosin shumë larva dhe vezë insektesh të cilat i shkaktojnë dëme mjaft të mëdha pemëve dhe kulturave tjera bujqësore, disa prej tyre ushqehen me brejtës të vegjël të cilët poashtu i shkaktojnë dëme të mëdha të lashtave bujqësore. Pra në këtë rast dobia është më e madhe se dëmi i tyre prandaj duhet edhe të kujdesemi për to.

Gjitarët (Mammalia): *Vulpes vulpes, Canis lupus, Ursus arctos, Sciurus vulgaris, Mustela nivalis, Lutra lutra, Lepus europaeus, Mustela putorius, Martes martes, Capreolus capreolus, Meles meles, Mustela erminea, Sus scrofa, Talpa caeca, Erinaceus roumanicus, Canis aureus, Felis silvestris, Vespertolinidae.*



Harta 6. Vlerat e llogaritura të biodiversitetit

Asetet e trashëgimisë natyrore

Mbrojtja e karakteristikave natyrore ose gjysmë-natyrore, pyjet, lumenjtë, liqenet, parqet edhe në qytet përbëjnë elemente kyçe për sigurimin e rrjetit ekologjik.

Trendi i rënies së biodiversitetit është trend në gjithë botën. Fragmentarizimi dhe shpërndarja e vendbanimeve, ndotja e ajrit, mbipërdorimi i zonave natyrore dhe krijimi i peizazheve artificiale rrisin shkallën e erozionit, duke reduktuar mundësinë e specieve për shpërndarje, migracion dhe shkëmbim. Rrjetet ekologjike mund të ndikojnë pozitivisht në kushtet për

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

mbijetesën e specieve në zonat e fragmentuara dhe peizazheve natyrore njerëzore të dominuara. Përveç kësaj, ato lejojnë një përdorim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore përmes lidhjes së brendshme të elementeve të tyre fizike me peizazhin dhe strukturat ekzistuese sociale/institucionale.

Me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë natyrore ministria e EA konkretisht AMMK ka hartuar listen për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në baze të kësaj liste në komunën e Gjakovës janë të mbrojtura 37 asete të kategorizuara sipas kategorive të listuara në tabelën e më poshtme.

- Monument i Natyrës – 1 Kanioni i Drinit të Bardhë;
- Pejsazh Natyror – 1 Shkugëz;
- Park Kombëtar – 1 Bjeshkët e Nemuna;

Asetet natyrore të përmbledhura:

- Monument i Natyrës - karakter botanik, 27 asete;
- Monument i Natyrës - karakter hidrologjik, 6 asete;
- Monument i Natyrës – speologjik, 4 asete.

Përveç listës së monumenteve natyrore të mbrojtura komuna e Gjakovës ka edhe disa lokalitete tjera të cilat kanë potencial që të trajtohen si zona të mbrojtura në nivel komunale dhe në të ardhmen të shiqohet mundësia e vendosjes së këtyre lokaliteteve në liste të mbrojtur të trashëgimisë kulturore.

1. Shpella e Kukës;
2. Gurra e Thatë;
3. Gurra e Kusarit;
4. Ujëvara e Currelit

Tabela 4. Asetet e trashëgimisë natyrore të mbrojtur

Vendbanimi	Aseti	Kategoria	Statuti
Gjakovë	Çabrati	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Gërgoc	Kompleks i trungjeve	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Zhabel	Kompleks i trungjeve	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Molliq	Kompleks i trungjeve	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Koshare	Maja e Gllavës	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Firzë	Pejsazh i mbrojtur (Shkugëza)	Pejsazh i Mbrojtur - botanik	I mbrojtur
Koshare	Parkut Kombëtar Bjeshkët e Namuna	Monument gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, speleologjike	I mbrojtur
Goden, Greçinë	Park i Mbrojtur i Natyrës (Malet e Pashtrikut)	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Dobrosh	Trungjet e blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Berjah	Trungjet e blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Vogovë	Trungjet e qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Dobrosh	Trungu i blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Stubëll	Trungu i blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Rrracaj	Trungu i blirit dhe qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Bec	Trungu i bungut	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Bec	Trungu i bungut	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Qerim	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Zhdredhe	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Palabardh	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Hereq	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Dobrosh	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Madanaj	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Gërçinë	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Vogovë	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Madanaj	Trungu i shkozës	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Shqiponjë	Zabeli i Gojanit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Molliq	Burim i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Kusar	Burimi i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Potok (Morinë)	Burimi i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Potok (Morinë)	Burimi i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Demjan	Gurra e Demjanit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Fshaj	Kanioni i Drinit të Bardhë	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik	I mbrojtur
Molliq	Shpella e Arushës	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur
Kusar	Shpella e Kusarit	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur
Greçinë	Shpella e Qirave	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur
Gërçinë	Shpella e Xhytezes	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur
Marmull	Bashkësia e Brukës		I mbrojtur

Rreziqet natyrore

Vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse të njerëzimit, të shtazëve dhe të bimëve dhe fatkeqësi të tjera, që i shkakton natyra.

Fatkeqësitë e tjera nënkupton fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror dhe hekurudhor, zjarret, fatkeqësitë në xeherore, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale, që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rryme, telekomunikacioni dhe teknologjisë informative, aktet terroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikimit masiv. Territori i komunës së Gjakovës vazhdimisht është

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

ballafaquar dhe mundë ballafaqohet me fatkeqësi natyrore dhe të tjera, kështu që Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtëje dhe Shpëtim ka përgjegjësi për menaxhimin e këtyre situatave emergjente, siç që janë:

- Zjarret
- Vërshimet
- Tërmetet
- Fatkeqësitë e tjera elementare

Njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është Tërmeti, dihet se në pikëpamje sizmologjike, Komuna e Gjakovës si edhe pjesa ma e madhe e Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të fortë, të cilët i kanë vatrat të cekëta.

Thatësira

Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

Vërshimet

Përmbytjet janë fatkeqësi elementare të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme. Përmbytjet konsiderohen dukuri të cilat paraqiten në sezone të caktuara, të cilat janë të rrezikshme për jetën e njeriut dhe sjellin dëme të konsiderueshme materiale. Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji i cili grumbullohet nga reshjet ose shkrirja e botes patjetër duhet ta gjejë një rrugë të lëvizjes së tij. Në këtë rast është e rëndësishme që atij t'i krijohet kushte për një shkarkim sa më të lirë pa pengesa. Komuna e Gjakovës vite me radhë ballafaqohet me problemin e vërshimeve si të lokaliteteve të banuara, ashtu edhe tokave bujqësore. Po ti bëhet një analizë e kësaj gjendje të shkaktuar nga këto vërshime mund të vijmë deri te këto konkluzione:

- a. *Dëmet ekonomike*
- b. *Rrezikimi i shëndetit të njeriut*
- c. *Ndotje permanente e ambientit*
- d. *Përhapje e epidemive etj.*

Në komunën e Gjakovës

është me rëndësi të trajtohen ujërat që shkaktajnë përmbytje e që vinë si rezultat:

- I dëmtimit të argjinaturave të lumenjve dhe dëmtimi i shtratit të lumenjve.
- I përrenjve në zonat malore gjatë motit të lig me shira intensive bëhen shumë rrëmbyeshëm dhe të bartin material që e gjejnë në rrugën e tyre dhe kanë fuqi të madhe
- Në zonën e rrafshët ku për shkak të mungesës së pjerrësisë së terrenit ujit të shiut ose nga bora e shkrirë nuk lëviz, por qëndron deri në momentin sa të thithet nga shtresa e tokës.

KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE


Popullsia dhe karakteristikat e saj luajn një rol të rëndësishëm në zhvillimet e gjithmbarshme të territorit. Bazuar në dinamikën e popullsisë sipas vendbanimeve dhe strukturave demografike, është e mundur planifikimi hapësinor i territorit.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Kosova dhe Komuna e Gjakovës shikuar në retrospektivë kishte një trend të thjeshtë pozitiv të dinamikës së popullsisë mirëpo, ky trend në këto dy dekadat e fundit ka filluar të ketë ndryshime, të cilat ndryshime qojnë në zvogëlimin e dinamikës së popullsisë. Natyrisht, këto ndryshime demografike është e domosdoshme të bëhen pjesë e analizave dhe politikave populatave territoriale në mënyrë që të ruajmë trendin pozitiv mirëpo, edhe zhvillimin e balancuar territorial gjithashtu.

Sipas regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë (ASK, 2011), Kosova kishte 1,739,825 milion banorë rezident. Ndërsa, sipas vlerësimit të ASK-së, në vitin 2018 Kosova ka shënuar rritje të popullsisë në 1,795,666 banor. Ndërsa, Komuna e Gjakovës sipas regjistrimit të vitit 2011 (ASK), kishte 94,556 banor ose rreth 5.5% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Ndërsa, sipas vlerësimit të ASK-së për vitin 2018, Komuna e Gjakovës numëron 94,869 banorë, kurse për vitin 2019, Komuna e Gjakovës ka një rënie të numrit të përgjithshëm të popullsisë (93,740 banor, Vlerësim - ASK, 2019). Në këto dy dekadat e fundit, sikur Kosova ashtu edhe Komuna e Gjakovës nuk kanë pasur rritje të përgjithshme të popullsisë krahasuar me trendët në vitet e kaluara (tri dekada më parë). Kjo situatë na bënë të kuptojmë se kemi të bëjmë me zvogëlim apo stagnim të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune.

Grafiku 2. Popullsia (ndryshimet) e Komunës së Gjakovës sipas viteve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / Baza e të dhënave ASK data-baza.

Sa i përket përbërjes etnike të popullsisë, sikurse popullsinë e Kosovës që e përbënë shumicën e popullsisë shqiptare (92,93%) po ashtu edhe Komuna e Gjakovës për nga përbërja etnike është kryesisht kompakte, ku rreth 93% e popullsisë e përbëjnë shqiptarët, pasuar nga egjiptianët, ashkali, romë, etj.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Ndërsa, sa i përket besimit religjioz, në Kosovë dominon besimi mysliman/feja Islame (95.60%), katolik 2.2%, ortodoks 1.48% etj, kurse në komunën e Gjakovës feja Islame përfaqësohet me 81.74%, katolik 17.23% dhe besime të tjera.

Ka një hendek midis vlerësimeve të institucioneve të ndryshme përgjatë fillim viteve 2000 dhe të dhënave të regjistrimit të popullsisë. Sidoqoftë, ka një rritje konstante të numrit të popullsisë në Komunën e Gjakovës. Por nga ana tjetër, ka ardhur në shprehje fenomeni i de-popullimit të disa vendbanimeve rurale. Ky fenomen nuk i takon vetëm viteve të fundit, por Kosova dhe vet vendbanimet rurale të Komunës së Gjakovë janë njohur me këtë fenomen prej vitesh. Kjo situatë ka ardhur në shprehje si rezultat i proceseve urbanizuese, sepse një pjesë e fenomenit të de-popullimit të zonave rurale ka ndodhur dhe besohet do vazhdojë të ndodhë në favor të rritjes përtej ritmeve natyrale të pjesës urbane kryesore të Komunës Gjakovë dhe migrimeve të jashtme.

Nga numri i përgjithshëm i popullsisë, 53.729 ose 57% e popullsisë jeton në vendbanime rurale dhe 40.827 ose 43% jeton në vendbanime urbane (ASK, 2011). Shih fig. në vazhdim;

Tabela 5. Popullsia e Komunës së Gjakovës sipas vendbanimeve (1948 – 2011);

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Babaj i Bokës	404	423	474	575	700	742	595
Bardhaniq	311	319	348	429	463	535	498
Bardhasan	377	411	497	603	788	807	316
Batushë	585	643	760	972	1276	1389	957
Bec	575	672	762	881	1096	1188	1223
Berjah	116	120	123	152	236	299	154
Bishtazhin	327	356	402	503	627	681	429
Bitesh	33	53	65	101	159	191	212
Brekoc	209	449	597	1156	841	1224	2948
Brovinë	396	406	418	518	649	708	565
Cërmjan	922	961	1147	1382	1719	1862	1141
Dallashaj	103	114	136	166	156	148	334
Damjan	1256	1393	1683	2279	3077	3519	5133
Devë	288	368	443	538	658	701	547
Doblibarë	504	537	634	783	971	1049	902
Dobrixhë	216	229	228	262	309	317	176
Dobrosh	314	342	389	506	682	801	568
Dol	362	407	468	579	837	854	872
Dujakë	501	562	631	831	1143	1319	715
Duzhnjë	111	124	136	168	224	260	467
Firajë	154	131	160	210	232	263	158
Firzë	173	189	231	259	399	505	443

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Fshaj	404
Gërçinë	471	499	537	669	870	985	1255
Gërgoc	279	285	262	351	447	496	324
Goden	152	150	180	188	202	274	72
Guskë	97	104	141	201	242	254	136
Gjakovë	15190	17065	21368	31281	42031	59008	40827
Hereç	453	494	570	761	1137	1380	843
Jabllanicë	326	392	447	555	665	694	439
Jahoc	87	126	189	230	470	615	553
Janosh	241	260	264	273	283	356	318
Kodrali	154	162	223	204	215	197	145
Korenicë	303	378	433	566	749	863	460
Koshare	160	156	200	240	250	277	..
Kralan	575	622	732	997	1195	1208	1153
Kusar	173	201	260	336	457	541	195
Kushavec	180	182	212	266	299	293	190
Lipovec	394	409	464	635	835	956	860
Lugbunar	349	411	370	385	396	355	190
Llugaxhi	83	100	115	139	73	151	424
Madanaj	248
Marmull	447	517	617	708	874	840	641
Mejë	203	216	271	351	499	618	4888
Meqe	143	185	199	208	286	303	181
Moglicë	337	202	257	337	462	502	345
Molliq	352	410	443	581	803	907	624
Morinë	337	394	473	565	680	653	189
Nec	167	222	218	222	277	281	253
Nivokaz	387	386	480	594	775	861	654
Novosellë e Epërme	409	481	584	742	899	949	691
Novosellë e Ulët	337	367	436	548	766	933	532
Orize	78
Osek Hylë	247	250	348	465	668	826	1151
Osek Pashë	158	178	205	295	416	511	267
Pacaj	190	115	137	180	238	274	270
Palabardhë	142	158	205	303	389	435	253
Pjetërshan	175	200	247	312	425	504	209
Plançor	168	217	280	413	498	523	613
Ponoshec	386	433	512	575	710	764	585
Popoc	171	166	174	192	242	302	300
Qerim	130	157	206	274	372	440	802
Qerret	6

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Raçë	125	175	226	280	387	466	393
Radoniq	409	455	465	495	283
Rakoc	380	423	480	565	378	220	19
Rakovinë	81	106	125	152	190	207	561
Ramoc	494	529	593	724	555	671	190
Rashkoc	130	166	160	199	280	293	269
Rogovë	1199	1362	1800	2553	3307	3731	4115
Rracaj	226	248	261	300	457	606	195
Rrezinë	191
Rrypaj	131	120	126	208	321	304	155
Skivjan	914	971	1107	1461	1993	2368	2254
Smaq	275	305	322	326	487	594	435
Smolicë	351	332	377	456	621	737	493
Sopot	110	131	154	198	276	206	126
Stubëll	168	167	203	200	259	292	187
Sheremet	180	181	191	219	281	314	177
Shishman	318	338	422	443	609	729	503
Trakaniq	192	215	240	289	401	485	349
Ujz	330	386	459	614	795	897	412
Vogovë	190	212	250	309	376	399	450
Vraniq	197	231	294	304	317	288	279
Zylfaj	156	178	208	234	261	254	59
Zhabel	336	383	385	339	403	417	404
Zhdredhë	157	163	181	242	294	464	283
Zhub	159	179	250	269	335	363	136
GJAKOVË	39998	44415	53270	71374	92203	114996	94556

Nga të dhënat e prezantuara më lartë mund të kuptojmë se një numër i konsideruar i vendbanimeve rurale (shih tabelën më lart), posaçërisht vendbanimet e thella kodrinore – malore kanë pasur zvogëlim apo de-popullim të popullsisë. Ky trend i de-popullimit mund të ndalet vetëm përmes hartimit dhe zbatimit të politikave të mirëfillta për zhvillimin rural, duke filluar me ndërtimin e infrastrukturës e deri te subvencionimi i ekonomive private familjare dhe ndërmarrjet.

Bazuar në indeksin bazik dhe vargor të rritjes së popullsisë në komunën e Gjakovës mund të kuptojmë periudhat kohore kur ka pasur rritje/rënie më të theksuar të popullsisë (shih tabelën në vazhdim).

Tabela 6. Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor në Komunën e Gjakovës;

Viti	Popullsia	Indeksi Bazik	Indeksi Vargor
1948	39,998	100	100
1953	44,415	111	111

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

1961	53,270	133	119
1971	71,374	178	134
1981	92,203	230	129
1991	11,3754	284	123
2011	94,556	236	0.83
2020 VI	96,159	240	101

Burimi: Regjistrimet e popullsisë – Agjencia e Statistikave të Kosovë. Për vitin 2020 janë vlerësim nga INSI.


Rritjen më të madhe popullsia në Komunën e Gjakovës e kishte në vitet e '70 – '90 – ta, pastaj ka vazhduar me një rënie të dukshme të numrit të popullsisë së përgjithshme. Ndërsa, nga viti 1991 – 2011, popullsia e Gjakovës ka pasur zvogëlim të numrit të përgjithshëm.

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi të veçante për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Në aspektin demografik kjo strukturë ka rëndësi për riprodhimin biologjik, sepse krijohet kontingjenti fertil ndërsa, në aspektin socio-ekonomik, ndikon në krijimin e kontingjentit të punës. Komuna e Gjakovës në aspektin e zhvillimit demografik ka veçoritë e saj edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktorë demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Gjakovës ka popullsi kryesisht të re ngjashëm sikurse edhe në nivel vendi dhe, me bazë të zgjeruar të piramidës, sipas moshës edhe pse, në dy dekadat e fundit, vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Struktura gjinore e popullsisë, po ashtu është karakteristike, kemi të bëjmë me një balancim gjinore përkundrejt që në nivel vendi dominon gjinia mashkullore. Deri në vitet e 90-ta, në komunën e Gjakovës ka dominuar plotësisht tipi progresiv i popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta, kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëherë-it edhe ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, piramida e popullsisë së Kosovës sikurse edhe ajo në komunën e Gjakovës kishte bazë të zgjeruar me dominim të grup-moshave 0 deri 4 vjeç. Aktualisht (ASK, 2011) rreth 11% e popullsisë së përgjithshme në Kosovë dhe Komunë të Gjakovës janë nën moshën 6 vjeç. Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës edhe ky është një indikator mjaft i rëndësishëm, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.


Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Grafiku 3. Popullsia në Komunën e Gjakovës sipas grup – moshës dhe gjinisë, 2011



Ekziston një bilanc gjinor në popullsinë e Kosovës sikurse edhe në atë të komunës së Gjakovës (50%), ku raporti gjinor është rreth 50%, në popullsinë e gjithmbarshme. Struktura gjinore dhe moshore kanë pasur ndryshime në kohë, kanë krijuar efekte të reja socio-ekonomike dhe demografike. Këto dy struktura kanë ndikuar në krijimin e kontingjenteve të rëndësishme siç janë: kontingjenti i punës, fertil, shkollor, i moshuar etj. Analiza dhe vlerësimi afatgjatë i këtyre kontingjenteve ka rëndësi të shumëfishtë, por para se gjithash, për planifikime dhe politika hapësinore, në sfera të ndryshme të organizimit shoqëror, ekonomik dhe politik. Ato reflektojnë efekte në planifikimin hapësinore afatgjatë siç janë punësimi, shkollimi dhe entet parashkollore, mbrojtja shëndetësore etj.

Grafiku 4. Piramida e popullsisë sipas grup moshës pesë-vjeçe dhe gjinisë në Gjakovë dhe Kosovës,



Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Nga të dhënat e prezantuara është e qartë se grup-moshat e hershme të popullsisë kanë pasur ndryshime me periudhat e më hershme, duke shënuar ulje apo zvogëlim ndërsa, grup-mosha e tretë e popullsisë (65+ vjeç) ka pasur rritje.

Tabela 7. Popullsia e Komunës së Gjakovës sipas grup – moshave për periudhën 1961 – 2011;

	0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54
2011	7133	8293	9874	10453	8946	7133	6450	6490	5935	5353	4627
%	7.5	8.8	10.4	11	9.5	7.5	6.8	6.9	6.3	5.7	4.9


	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+
2011	3799	3011	2537	2007	1410	1105
%	4	3.2	2.7	2.1	1.5	1.1

Ndërsa grup-mosha e mesme nuk ka ndryshime që vlen të theksohet. Megjithëkëtë ndryshime, ende popullata e Komunës së Gjakovës sikurse edhe ajo në nivel vendi është e re (mosha mesatare rreth 30 vjeç).

Dendësia e popullsisë


Dendësia e popullsisë paraqet numrin mesatar të popullsisë në një hapësirë të caktuar (vendbanim apo territor) dhe zakonisht shprehet apo matet me numrin e banorëve në km². Llogaritet ashtu që numri i banorëve të një territori që na intereson dhe ndahet me sipërfaqen e atij territori. Historikisht, ashtu si në nivel vendi (Kosovë) edhe në komunën e Gjakovës, qyteti –et kanë pasur dendësi më të madhe të popullsisë.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026



Harta 7. Dendësia e popullsisë për m2

Dendësia e popullsisë në komunën e Gjakovës është 161.1 banorë në 1 km², që njëherit është edhe e njëjte me mesataren në nivel vendi (Kosovë) – 163 banorë në 1 km² (vt. 2011). Brenda territorit të komunës së Gjakovës ekzistojnë dallime të theksuara sa i përket dendësisë së popullsisë. Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe, e kundërta, në vendbanimet rurale që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël. Dendësia më e lartë e popullsisë për km/2 është në qytetin e Gjakovës.



Harta 8 Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

Lëvizjet natyrore të popullsisë

Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës dhe Komunës së Gjakovës, paraqet një komponentë mjaft karakteristike. Ato janë ndër komponentët që së bashku me migrimet, paraqesin ecurinë dhe dinamikën e lëvizjeve të përgjithshme të popullsisë. Si rezultat i rrethanave politike dhe kushteve shoqërore - ekonomiko nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe Gjakova, shtimi natyror i popullsisë ka shkuar drejt zvogëlimit. Megjithatë, trendi aktual i shtimit natyror të popullsisë në Kosovë është pozitiv krahasuar me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së. Kosova sikurse edhe Komuna e Gjakovës ende ka trend pozitiv të shtimit natyror mirëpo, me tendencë të zvogëlimit. Shtimi natyror i popullsisë së Kosovës sikurse edhe i Komunës së Gjakovës deri në vitet ‘90 të shekullit XX, pavarësisht disa oscilimeve ka qenë e lartë. Pas vitit 2000 ka filluar të bjerë në mënyrë shumë të shpejtë, si pasojë e emigrimit, shtyrjes së martesave, dhe faktorëve të tjerë, pasoja këto që po e ndihen edhe tani. Popullsia e komunës së Gjakovës, në vitin 2018 kishte shtim natyror rreth 1% ose në numra absolute (794 banor) gjë që, është më e ulët se mesatarja e Kosovës (1.02%) e që tregon për një shtim të thjeshtë të popullsisë dhe krahasuar me vitet paraprake, ka tendencë të uljes së shtimit natyror të popullsisë edhe në vitet në vazhdim. Faktorët kryesor që kanë quar në uljen e shtimit natyror të popullsisë janë migrimet e brendshme dhe të jashtme, vdekshmëria e lartë, gjendja socio-ekonomike, arsimimi etj. Ulja e

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

shtimit natyror të popullsisë ka për pasojë de-balancimin e strukturave demografike, efektet në rritjen e grup-moshës së tretë, humbjen e fuqisë punëtore, zvogëlimin e numrit të nxënësve, etj.

Tabela 8. Shkalla e lindjeve në nivel komune sipas viteve;

Periudha	Shkalla e lindjeve
1988 – 1993	27,0
1993 – 1998	24,9
1998 – 2003	23,0
2018	10,0

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Bazuar në trendin e lëvizjeve natyrore (lindje, vdekje dhe shtimin natyror) por edhe në lëvizjet mekanike të popullsisë së Komunës së Gjakovës, komuna e Gjakovës parashikohet të ketë trend të uljes së numrit të përgjithshëm të popullsisë.


Lëvizjet mekanike të popullsisë

Ajo që e bën kompleks diskutimin mbi demografinë është larmia e fenomeneve demografike me të cilat është përballur e gjithë Kosova. Ajo është përballur që në vitet '70 me fenomenin e migracionit ndërkombëtar dhe kombëtar, por duke patur gjithmonë asetin e një rritje të konsiderueshme natyrale të popullsisë. Dinamikat e popullatës kanë njohur luhatje të jashtëzakonshme sidomos përgjatë kulmimit të përndjekjes së popullatës shqiptare në vitin 1999 nga regjimi serb.

Pas çlirimit të Kosovës, dinamikat e lëvizjes së popullatës brenda vendit njohën një nivel më të lartë. Proceset urbanizuese në drejtim të kryeqytetit njohën ritme të larta brenda një kohe të shkurtër. Vitet e fundit Kosova është përballur edhe me një valë lëvizjeje jashtë Kosovës. Mund të arsyetohet që fenomenet e emigrimit prekin në mënyrë më të dukshme kryesisht zonat rurale.

Komuna e Gjakovës është njëra ndër komunat e Kosovës më shkallën më të lartë të migracionit. Pas Prishtinës, Komuna e Gjakovës zënë vendin e dytë në nivel vendi me numrin absolut më të madh të të emigruarave ndërsa, me numrin e të emigruarave në raport me popullsinë rezidentë, renditet në mesin e pesë komunave me shkallën më të lartë të emigracionit. Vendet ku më së shumti kanë emigruar qytetarët nga Gjakova janë: Zvicrra, Gjermani, Austri etj. Grup-mosha që më së shumti ka emigruar është popullsia aktive (veçanërisht grup - mosha 24 – 39 vjeç) ndërsa, sa i përket raportit gjinor, kjo ka ndryshuar pas vitit 2000, me dominim të lehtë gjinia femërore. Arsyet e emigrimit janë: punësimi, familjare, lufta, etj (ASK, 2014). Gjithnjë sipas të njëjtit burim (ASK, 2014), migrimi ndërkombëtar më së shumti sikurse në nivel të Kosovë ashtu edhe në komunën e Gjakovës ka ndodhur në vitet e '90 – ta dhe pas vitit 2000. Shih figurën;

Grafiku 5. Emigrimi sipas viteve nga tri komunat me numrin më të madh të emigrantëve, 2014



Bilanci i migrimit ndërkombëtar për vitin 2011 ishte -142 (apo -142 migrantë në 1000 banorë) në Kosovë. Komunat me bilancin më të lartë negativ të migrimit ishin: Suhareka me 40.2, Klina me 29.1, Mitrovica me 28.3 si dhe Gjakova me -25.4% (ASK, 2014). Persona të cilët jetojnë jashtë Komunës së Gjakovës sipas komunës së lindjes, gjinisë dhe vendit të qëndrimit aktual janë: gjithsej 29,707 qytetar prej numrit të përgjithshëm 16,611 meshkuj dhe 13,096 femra. Bilanci i migrimit ndërkombëtar në komunën e Gjakovës është -25.5% (ASK, 2014).

Sa i përket migrimit kombëtar, Komuna e Gjakovës renditet në mesin e dhjetë komunave të Kosovës me shkallën më të madhe të migrimit. Rreth 8.000 qytetarë kanë emigruar nga komuna e Gjakovës (emigrimi kombëtar) dhe janë vendosur në komunat tjera të Kosovës (ASK, 2014). Këto të dhëna tregojnë komuna është duke humbur një numër të konsiderueshëm të popullsisë (migrim neto negative). Bilanci i migrimit kombëtar në Komunën e Gjakovës është - 0.2%.

Pavarësisht migrimit ndërkombëtar dhe atij kombëtar, qytetarët që kanë migruar kanë pasur paluajtshme dhe vizitojnë Gjakovën gjatë vitit dhe, natyrisht se planifikimet në infrastrukturë dhe shërbime publike komuna duhet të planifikoj edhe për këtë kategori të qytetarëve.

Numri i ekonomive familjare

Numri i ekonomive familjare në Komunën e Gjakovës ka pasur një rritje të vazhdueshme nëpër vite. Që nga viti 1981 e deri në vitin 2011, ka pasur një rritje mbi 4 mijë ekonomi familjare. Numri i ekonomive familjare vazhdon të ketë rritje në qytetin e Gjakovës dhe vendbanimet e afërta dhe rrafshinore mirëpo, ka një tendencë të vazhdueshme të zvoglimit në vendbanimet me distancë të theksuar nga zona urbane dhe vendbanimet kodrinore malore. Më shumë se 50% e ekonomive familjare janë të koncentruara në qytetin e Gjakovës pastaj, në vendbanimin Mejë, Brekoc, Cërmjan dhe vendbanime të tjera.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Komuna e Gjakovës rënditet në mesin e 7 komunave me numrin më të madh të popullsisë në Kosovë. Numri mesatar i anëtarëve për ekonomi familjare në Kosovë është 5.9 ndërsa në Komunën e Gjakovë kemi 5.8 anëtarë për një ekonomi familjare. Gjithsej 16,303 ekonomi familjare janë në komunën e Gjakovës (vt. 2011, ASK).

Tabela 9. Numri i ekonomive familjare sipas vendbanimit;

Nr	Ekonomitë familjare sipas vendbanimi, viti dhe variabla							
	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	
1	Babaj i Bokës	64	63	75	80	82	88	87
2	Bardhaniq	38	33	49	45	48	56	58
3	Berdosanë	44	44	56	56	65	68	54
4	Batushë	97	95	101	119	167	176	144
5	Bec	91	101	111	103	129	139	186
6	Berjah	20	20	16	24	25	33	27
7	Bishtazhin	43	43	44	48	61	66	68
8	Bitesh	7	13	15	17	21	28	33
9	Brekoc	17	53	91	139	78	123	530
10	Brovinë	57	51	49	62	62	68	96
11	Cërmjan	128	130	178	176	200	218	172
12	Dallashaj	21	23	27	28	24	24	73
13	Damjan	131	140	158	167	224	260	535
14	Devë	37	47	70	58	73	77	76
15	Doblibarë	54	51	62	79	90	101	125
16	Dobrixhë	35	35	38	36	26	27	29
17	Dobrosh	45	47	62	55	68	83	89
18	Dol	48	55	69	61	72	73	127
19	Dujakë	65	66	74	82	112	130	108
20	Duzhnjë	17	20	24	21	26	31	70
21	Firajë	21	13	22	18	18	23	29
22	Firzë	24	25	29	32	44	59	73
23	Fshaj	66
24	Gërçinë	44	46	57	56	77	90	131
25	Gërgoc	41	43	41	48	53	63	47
26	Goden	14	11	15	20	17	26	10
27	Guskë	14	13	19	26	28	29	20
28	Gjakovë	3136	3359	4049	5594	7183	10089	8326
29	Hereç	60	66	83	100	137	173	137
30	Jabllanicë	46	53	51	62	66	69	61
31	Jahoc	15	16	26	30	57	77	77
32	Janosh	39	37	37	39	38	49	50
33	Kodrالی	15	22	35	34	35	32	22
34	Korenicë	57	65	73	76	81	95	89

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

35	Koshare	24	28	33	31	25	28	...
36	Kralan	54	59	62	91	103	104	159
37	Kusar	18	19	29	29	44	57	30
38	Kushavec	26	21	22	27	27	28	34
39	Lipovec	35	45	39	65	85	98	106
40	Lugbunar	63	73	78	69	58	57	30
41	Llugaxhi	15	17	22	17	10	20	62
42	Madanaj	51
43	Marmull	71	85	92	67	76	76	100
44	Mejë	28	35	41	45	61	77	830
45	Meqe	19	25	29	25	34	36	27
46	Moglicë	40	23	27	33	47	52	58
47	Molliq	46	43	45	63	71	81	97
48	Morinë	45	47	59	55	66	63	33
49	Nec	37	45	58	30	27	28	39
50	Nivokaz	48	46	57	54	71	79	96
51	Novosellë e Epërme	50	52	65	57	62	69	100
52	Novosellë e Ulët	40	39	38	36	52	65	77
53	Orize	12
54	Osek Hylë	54	48	64	78	83	107	175
55	Osek Pashë	20	23	26	35	36	46	42
56	Pacaj	27	20	22	22	22	26	44
57	Palabardhë	12	12	15	24	39	47	35
58	Pjetërshan	25	28	29	38	49	60	35
59	Plançor	21	27	30	41	49	52	95
60	Ponoshec	57	65	95	87	86	93	106
61	Popovec	28	28	30	33	26	34	44
62	Qerim	16	18	26	28	39	48	137
63	Qerret	1
64	Raçë	20	20	27	31	37	48	56
65	Radoniq	69	60	69	64	29
66	Rakoc	45	44	48	59	43	27	4
67	Rakovinë	16	18	23	22	24	28	84
68	Ramoc	74	70	79	73	50	64	30
69	Rashkoc	25	18	20	24	37	37	37
70	Rogovë	137	162	210	247	289	333	547
71	Rracaç	32	41	45	33	39	58	35
72	Rrezinë	35
73	Rrypaj	21	20	23	25	30	32	28
74	Skivjan	116	133	144	164	204	246	322
75	Smaq	32	31	32	36	37	47	70

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

76	Smolicë	49	46	63	65	75	96	57
77	Sopot	10	11	13	14	26	22	18
78	Stubëll	26	22	30	27	31	37	30
79	Sheremet	31	26	30	24	30	34	34
80	Shishman	39	44	59	62	68	91	77
81	Trakaniq	23	22	28	24	25	35	56
82	Ujz	53	55	55	68	76	86	60
83	Vogovë	22	21	34	43	43	47	72
84	Vraniq	23	30	42	41	33	34	46
85	Zylfaj	14	13	14	20	24	23	10
86	Zhabel	46	46	47	34	41	42	55
87	Zhdredhë	21	13	14	17	22	34	39
88	Zhub	6	10	22	32	36	41	21
	GJAKOVË	6454	6846	8210	10020	12184	15816	16303

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / Data e krijimit 16.1.2017

Shfrytëzimi i tokës

Kategoritë e shfrytëzimit të tokës së komunës janë:

1. Vendbanimet
2. Toka e punueshme
3. Vegjetacioni i lartë
4. Zonat me interes të veçantë
5. Lumenjtë
6. Sipërfaqet për transport
7. Qendrat

1. VENDBANIMET

Sipërfaqja e vendbanimeve nënkupton sipërfaqen e ndërtuar të qendrës urbane të Gjakovës, subqendrave, qendrave locale dhe fshatërave. Në kuadër të saj përfshihen banimi, infrastruktura sociale dhe fizike.

2. TOKA E PUNUESHME

Paraqet tokën e cila është e shfrytëzuar për :

2a) BUJQËSI- që paraqet zonën e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore:

arë, kopsht, pemishte, livadh, kullosë si dhe tokat tjera shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor dhe zhvillimin e blegtorisë duke marrë parasyh vetitë natyrore dhe kushtet ekonomike.

2b) KULLOSA- tokë e mbuluar kryesisht me vegjetacion natyror bimor e cila shërben për kullotjen, lëshuarjen dhe pushimin e bagëtisë.

3. VEGJETACIONI I LARTË

Këtu përfshihen të gjitha sipërfaqet mbi 0.2 ha të populluara në mënyrë të dendur me bimësi drunore.

4. ZONAT ME INTEREST TË VEÇANTË

Janë zonat të cilat për vlerat që I kanë ose shërbimet që I ofrojnë janë më interes të posaçëm në nivel kombëtar: Kjo zonë është paraparë për zhvillimin e prodhimit dhe eksportit industrial dhe në të janë përcaktuar kushtet vijuese të përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës së veçantë janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor, si: Miniera dhe Karriera
- Përdorime të Prodhimit dytësor, si: Prodhim Energjetik
- Shërbime Terciare, si: Shërbime Komunitare, si: Burg, Varreza, Repart Ushtarak,

Rrjete të Transporteve Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale, si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës së veçantë janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulturë dhe Peshkim.
- Përdorim të Banimit.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës së veçantë janë, si më poshtë:

- Rrjete të Transporteve Logjistikës dhe Infrastrukturës, si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondar dhe terciar.

5. LUMENJTË

Të gjitha ujërat sipërfaqësor të vazhdueshëm ose peridik siç janë: lumenjtë, pellgjet, liqenet dhe sipërfaqe të ngjajshme.


6. SIPËRFAQET PËR TRANSPORT

Sipërfaqet për transport përbëhen nga korridoret për transport:

- 6a) Rrugët nacionale- janë korridore të cilat lidhin Kosovën me vendet fqinje.
- 6b) Rrugët rajonale-nënkupton rrugën publike që lidh dy ose më shumë qytete të mëdha
- 6c) Rrugët kryesore lokale-janë rrugët publike që lidhin qendrat e bashkësive lokale brenda komunës së Gjakovës.
- 6ç) Rrugët lokale-janë rrugët publike që lidhin vendbajmet me rrugën kryesore lokale brenda komunës së Gjakovës.
- 6d) Rrugët malore- shfrytëzohet për mirëmbajten dhe monitorimin e zonave malore, pyjeve si dhe për zhvillimin e turizmit.
- 6dh) Rrugët turistike- paraqet rrugën publike që lidh pika të rëndësishme atraktive natyrore dhe kulturore në territorin e komunës.

7. QENDRAT

- 7a) Qendra kryesore- paraqesin qendrat urbane ku gjenden të gjitha shërbimet në nivel komunal
- 7b) Subqendra- janë qendra lokale ku ofrohen veprimtaritë shërbyese të decentralizuara me qëllim të zvogëlimit të qarkullimit të panevojshëm në drejtim të qendrës kryesore-Gjakovës, për shërbimet të cilat mund të ofrohen në kuadër të subqendrave.
- 7c). Qendrat lokale- janë qendrat e bashkësisve lokale ku ofrohen shërbimet në nivel të bashkësisë lokale.



Harta 9. Shfytëzimi i tokës

Trashëgimia kulturore

rpos vlerave të larta të kulturës së trashëguar materiale e shpirtërore dhe trashëgimisë arkitektonike, komuna e Gjakovës karakterizohet me një trashëgimi natyrore shumë të pasur, disa prej të cilat janë inventarizuar.

Në Komunën e Gjakovës janë të mbrojtura 37 asete të kategorizuara sipas kategorive të listuara në tabelën e më poshtme.

- Monument i Natyrës – 1 Kanioni i Drinit të Bardhë;
- Pejsazh Natyror – 1 Shkugëz;
- Park Kombëtar – 1 Bjeshkët e Nemuna;

Asetet natyrore të përmbledhura:

- Asetet me karakter botanik, 27 asete;
- Asetet me karakter hidrologjik, 6 asete;
- Asetet me speologjik, 4 asete.

Përveç listës së monumenteve natyrore të mbrojtura komuna e Gjakovës ka edhe disa lokalitete tjera te cilat kane potencial qe të trajtohen si zona të mbrojtura në nivel komunale dhe ne të

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

ardhmen të shiqohet mundësia e vendosjes se këtyre lokaliteteve ne liste të mbrojtur të trashëgimisë natyrore.

1. Shpella e Kukës;
2. Gurra e Thatë;
3. Gurra e Kusarit;
4. Ujëvara e Currelit

Tabela 10. Asetet e trashëgimisë natyrore të mbrojtur

Vendbanimi	Objekti	Kategoria	Statuti
Gjakovë	Çabrati	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Gërgoc	Kompleks i trungjeve	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Zhabel	Kompleks i trungjeve	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Molliq	Kompleks i trungjeve	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Koshare	Maja e Gllavës	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Firzë	Parku i Shkugëzës	Monument i Natyrës - botanik	Pejsazh i mbrojtur
Koshare	Parkut Nacional Bjeshkët e Namuna	Monument i Natyrës - botanik	Park kombëtar
Goden, Greçin	Park i Mbrojtur i Natyrës (Malet e Pashtrikut)	Monument i Natyrës - botanik	Park i Natyrës
Gërçinë	Mali Pashtrik dhe Liqeni Vermicës	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Dobrosh	Trungjet e blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Berjah	Trungjet e blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Vogove	Trungjet e qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Dobrosh	Trungu i blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Stubëll	Trungu i blirit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Rracaj	Trungu i blirit dhe qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Bec	Trungu i bungut	Monument i Natyrës -	I mbrojtur

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

		botanik	
Bec	Trungu i bungut	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Qerim	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Zhdredhe	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Palabardh	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Hereq	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Dobrosh	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Madanaj	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Gërçinë	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Vogovë	Trungu i qarrit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Madanaj	Trungu i shkozës	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Shqiponjë	Zabeli i Gojanit	Monument i Natyrës - botanik	I mbrojtur
Molliq	Burimi i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Kusar	Burimi i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Potok (Morinë)	Burimi i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Potok (Morinë)	Burimi i ujit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Demjan	Gurra e Demjanit	Monument i Natyrës - hidrologjik	I mbrojtur
Fshaj	Kanioni i Drinit të Bardhë	Monument i Natyrës - hidrologjik	Monument Natyror
Molliq	Shpella e Arushës	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur
Kusar	Shpella e Kusarit	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Kusar	Shpella e Qirave	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur
Gërçinë	Shpella e Xhytezes	Monument i Natyrës - speologjik	I mbrojtur
Marmull	Bashkësia e Brukës		I mbrojtur

Prodhimtaria bujqësore

Bujqësia është një ndër degët bazë të ekonomisë dhe si e tillë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e një regjioni apo komune. Komuna e Gjakovës gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës. Territori i komunës së Gjakovës ka një sipërfaqe prej 586.00 km² (58,600 hektarë), Rreth 40% e territorit të komunës është tokë bujqësore, që d.m.th gati gjysma e territorit komunal është tokë buke. Në bazë të dhënave 23,423 ha janë sipërfaqe bujqësore, duke llogaritur tokat bujqësore, livadhet, kullosa dhe vendbanimet që shfrytëzojnë kopshtet në parcelat e tyre kadastrale.

Edhe pse bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë së komunës së Gjakovës, vërehet një rënie e interesimit për tu angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm një numër i vogël i prodhuesve janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Përkundër potencialit, sektori i bujqësisë përballet me sfida dhe pengesa zhvillimore, një pjesë e të cilave janë potencuar në vazhdim. Barrierat mund të grupohen në produktivitetin e ulët, çmimet e ulëta dhe kosto të larta. Trendi i humbjes së tokës bujqësore, madhësia e kufizuar e parcelave të tokës se punëshme, papunësia e lartë, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, si dhe mungesa e shkathtësive profesionale në shfrytëzimin e makinerisë dhe teknologjisë bujqësore paraqet një pengesë kryesore në zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, edhe blegtoria ballafaqohet me kufizime zhvillimore për tu përballur me kushtet dhe konkurrencën e tregut, për shkak të ekzistimit të fermave të vogla. Me madhësinë e fermës ndërlihet shumë edhe mundësia e shfrytëzimit të teknologjive të reja, implementimi i teknikave dhe të arriturave të reja shkencore, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e koston dhe në shtimin e prodhimit bujqësor.

Aspekt tejet kufizues i bujqësisë është mungesa e shkathtësive profesionale në përgatitjen dhe zbatimin e politikave dhe projekteve në sektor. Për këtë qëllim, Ministria e Bujqësisë ka hartuar strategjinë për këshillime, që koordinon ofrimin e këshillave me institucione dhe akterë në nivel vendi. Strategjia këshilluese ka synuar rritjen e numrit të fermerëve dhe palëve tjera me interes që marrin këshilla për bujqësi dhe zhvillim rural. Nevoja për këshillime dhe përkrahje teknike është e vazhdueshme.

Kjo gjendje e përgjithshme për pasojë ka produktivitetin e ulët meqë nuk ka parakushte për aplikimin e teknologjive të avancuara në sektor:

- Sistemet e ujitjes dhe kullimit janë të vjetërsuara dhe nuk arrijnë të sigurojnë kontroll përkatës të ujit;
- Qasja e dobët e fermerëve në tregje;

- Mungesa e magazinimit dhe ftohjes shtynë prodhuesit vendorë të shesin prodhimet e tyre gjatë, apo menjëherë pas vjeljes me çmime të ulëta;
- Munges e zinxhirit industrial prodhes i produkteve blegtorale;
- Përveç inputeve të shtrenjta, shkalla e vogël e operacioneve shkakton kosto të larta prodhimi;
- Sektori i bujqësisë nuk është rentabil sa duhet në mënyrë që të financojë rritjen e ardhshme përbrenda dhe ka qasje të kufizuar në fonde të jashtme;
- Kamata të larta - kreditë komerciale dhe mikrofinanciare nuk mund të përballohen financiarisht;
- Struktura dhe infrastruktura e dobët e fermës, që si pasojë karakterizohet me humbje të tregjeve për prodhime dhe pamjaftueshmëri të resurseve financiare të ndara për përkrahjen e bujqësisë;
- Shfrytëzimi jo adekuat i tokës dhe mungesa e konsolidimit;
- Numri i kufizuar i shoqatave të prodhuesve dhe mungesa e rregulloreve;
- Cilësia e ulët e prodhimeve bujqësore;
- Të hyrave të ulëta në dispozicion të ekonomive shtëpiake;
- Niveli i ulët i edukimit të fermerëve ndërmjet moshës madhore të fermerëve dhe popullatës që jetojnë në viset rurale;

Fuqia punëtore në sektorin e Bujqësisë

Fuqia punëtore në bujqësi është e rëndësishme për të vlerësuar se deri në çfarë mase bujqësia mund të absorbojë fuqinë punëtore rurale dhe shkallën deri në cilën punët jobujqësore kërkohen në viset rurale. Kjo e fundit tregon që politikat përtej bujqësisë, të cilat synojnë zhvillimin rural janë të domosdoshme. Gjatë analizës janë grumbulluar informata rreth punësimit të anëtarëve të familjeve në bujqësi, rreth përkushtimit të tyre në bujqësi, me orar të plotë apo të kohëpaskohshëm (sezonal).

Në sektorin e bujqësisë janë të angazhuar një numër i lart i të punësuarve, sipas ASK-së numri i të punësuarve në këtë sektor është mbi 13,749 punëtor të rregullt si dhe një numër i madh i atyre sezonal nga e cila kuptojmë se bujqësia është një sektor shumë i rëndësishëm në sigurimin e jetesës të një numri të madh të ekonomive familjare.

Tabela 11 Numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë (ASK)

Të punësuarit si bartës të ekonomisë bujqësore	Numri i të punësuarve	% pjesëmarrjes
Nën 25 vjeç	125	2.29
Nga 25 deri nën 35 vjeç	390	7.13
Nga 35 deri nën 45 vjeç	1113	20.36
Nga 45 deri nën 55 vjeç	1610	29.45
Nga 55 deri nën 65 vjeç	1124	20.56
65 vjeç e më shumë	1105	20.21

Të punësuarit sipas anëtarëve të ekonomisë bujqësore		
Nën 25 vjeç	1652	19.95
Nga 25 deri nën 35 vjeç	1437	17.35
Nga 35 deri nën 45 vjeç	2099	25.34
Nga 45 deri nën 55 vjeç	1624	19.61
Nga 55 deri nën 65 vjeç	893	10.78
65 vjeç e më shumë	577	6.97

Me qëllim të përmbushjes së normave dhe standardeve teknike të projektimit, hartimi i hartës zonale për infrastrukturë rrugore është bazuar në:

Ligjin NR. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor

Ligjin mbi rruget

Normat teknike të planifikimit hapsionor

Udhëzimin administriv (MI) Nr. XX/2017 për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor

Ligjet dhe rregulloret mbi mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjes në punë.

Ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

Në pozicionet për të cilat në Republikën e Kosovë nuk ka standarde të aprovuara, projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Rrugët publike, të motorizuara dhe jo të moterizuar me kategorizimin dhe nivelimin

Lloji (kategorizimi) i rrugëve në Komunën e Gjakova

Sipas Ligjit mbi rrugët, varësisht nga rëndësia e tyre shoqërore, ekonomike dhe e qarkullimit rrugët publike, kategorizohen në:

Tabela 12. Kategorizimi i rrugëve

Nr.	Kategoria	Përgjegjësi
1	Autoudhë	Ministria e Infrastrukturës
2	Rrugë nacionale	Ministria e Infrastrukturës
3	Rrugë rajonale	Ministria e Infrastrukturës
4	Rrugë kryesore lokale	Komuna
6	Rrugët transite Urbane	Komuna
7	Rrugët Transite nëpërmjet	Komuna
8	Rrugët përmbledhëse /	Komuna
9	Rrugët Servisore	Komuna
10	Rrugët banesore	Komuna
11	Rrugët industriale	Komuna
12	Rrugët qaseshe / dykahëshe	Komuna
13	Rrugët qaseshe / njëkahëshe	Komuna

Nëpër territorin e Komunës së Gjakovës, kalojnë rrugë me karakter të ndryshëm si: rrugët nacionale, rrugët rajonale dhe rrugët lokale.

Lidhur me infrastrukturën rrugore në Komunën e Gjakovës, Ministria e Mjedist, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për menaxhim, mirëmbajtje dhe ndërtim rrugëve nacionale dhe regjionale, ndërsa Komuna është përgjegjëse për rrugët lokale dhe ato në vendbanime.

Autoudhët

Nëpër territorin e Komunës së Gjakovës nuk kalojnë autoudhë. Lidhja më e afërt e Gjakovës është në autoudhën “Ibrahim Rugova” (afërsisht 30 km) në Prizren.




Figura 1 Rrugët nacionale dhe rajonale në komunën e Gjakovës

Rrugët nacionale dhe rajonale

Gjakova, në kuadër të rrjetit rrugor ekzistues përmban rrugën nacionale N-9.1 e cila vjen nga Prishtina dhe kalon në pjesën lindore të qytetit. Përmes rrugës nacionale N-9.1, Gjakovës i mundësohet lidhja me pjesën veriore të Shqipërisë.

Katër rrugë rajonale e lidhin Gjakovën me qytetet dhe fshatrat tjera në Kosovën perëndimore. Një ndër rrugët më të rëndësishme rajonale është rruga rajonale R-107 e cila e lidhë Gjakovën me Pejen dhe Prizrenin.

Rruga tjetër, gjithashtu mjaft e rëndësishme e cila ndërlidhet me rrugën nacionale N9-1, është rruga rajonale R-203 e cila kalon nëpër nëpër qytetin e Gjakovës dhe mundëson lidhjen me qytetin e Kukësit në Shqipëri. Ndërsa, përmes rrugës rajonale R-109, Komuna e Gjakovës lidhet me Junikun Deçanin dhe Pejen.

Rrugët lokale

Sipas Ligjit për rrugët, rrugët lokale janë rrugët që lidhin vendbanimet e një komune, ku kompetencë mbi kategorizimin dhe ndryshimin e tyre i takon qeverisë lokale.

Rrugët në qytetin e Gjakovës, kryesisht janë me nga dy korsi trafiku (2x1), përveq rrugës “Tirana” e cila ka nga dy korsi trafiku për kahe dhe rruga “Nënë Tereza” e cila është rrugë një kahore me dy korsi për kahe (1x2).

Rrugët lokale të cilat lidhin lokacione të ndryshme brenda qytetit të Gjakovës kanë karakter të ndryshëm. Rrugët e karakterit më të lartë janë plotësuar nga rrugë lidhëse të karakterit më të ulët. Shumica e rrugëve lokale nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, sidomos mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për çiklist shkakton vështirësi për këmbësorë dhe çiklist.

Sipërfaqja e rrjetit rrugor në komunën e Gjakovës

Sipërfaqja e rrjetit aktual rrugor në komunën e Gjakovës është dhënë në Tabelën në vazhdim.

Tabela 13 Rrjeti rrugor në komunën e Gjakovës

Kategoria e Rrugëve	Gjatësia (m)	Gjatësia (km)
Autoudhë	0	0
Rruge Nacionale	58753.45	58.753
Rruge Rajonale	62585.65	62.585
Rruge Lokale	929152.2	929.152
Totali:	1050491.30	1050.491

Kapaciteti i rrugëve

Kapaciteti është definuar si madhësia maksimale e qarkullimit të automjeteve të cilat mund të kalojnë nëpër pjesën e vëzhguar të shiritit qarkullues të rrugës në periudhën e caktuar kohore nën ndikimin e kushteve të komunikacionit në rrugë.

Kapaciteti i autoudhëve

Nëpër territorin e Komunës së Gjakovës nuk kalojnë autoudhë. Lidhja më e afërt e Gjakovës është në autoudhën “Ibrahim Rugova” (afërsisht 30 km) në Prizren.

Kapaciteti i rrugës nacionale N-9.1

Nga niveli qëndror, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është planifikuar zgjerimi i rrugës nacionale N-9.1 Gjakovë - Dollc me gjatësi 30.43 km. Ndërtimi i kësaj rruge është paraparë të zgjerohet në rrugë me nga dy korsi të trafikut për kahe, fizikisht të ndara dhe një pjesë e kësaj rruge kalon nëpër territorin e Komunës

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

së Gjakovës në segmentin Gjakovë – Rakovinë me gjatësi 16.16 km. Punimet në këtë rrugë me karakter nacional janë në proces të ndërtimit.

Gjithashtu nga niveli qendror, në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës është projektuar dhe është në realizim e sipër rruga “Bujar Roka” e cila devijon trafikun tranzit nga pjesa e qytetit në drejtim të kufirit me Shqipërinë dhe anasjelltas.

Bazuar në parametrat teknik të rrugëve nacionale, gjerësinë dhe numrin e korsive të trafikut, në përgjithësi këto rrugë i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte të mira për qarkullim të mjeteve motorike dhe kapaciteti potencial ndryshon në pjesë të ndryshme të rrugës varësisht nga numri i korsive për kahe. Për pjesët e rrugës nacionale me nga një korsi trafiku për kahe kapaciteti potencial sillet rreth 1200 - 1500 aut/h, ndërsa për pjesët e rrugës nacionale me nga dy korsi trafiku për kahe kapaciteti potencial sillet 2500 – 3000 aut/h.

Kapaciteti i rrugëve rajonale R-112, R-107, R-203, R-109 dhe R-201

Rrugët rajonale të cilat kalojnë nëpër territorin e Komunës së Gjakovës janë rrugë dy kahore me nga një korsi të trafikut për secilen kahe. Gjerësia e korsisë sillet nga 3.0 – 3.5 m. Bazuar në gjerësinë dhe numrin e korsive (nga një korsi për secilen kahe), kapaciteti potencial për rrugët rajonale për kahe sillet rreth 1100 - 1300 aut/h.

Kapaciteti i rrugëve lokale

Gjendja dhe elementet gjeometrike të rrugëve lokale në Gjakovë janë të ndryshme, duke filluar nga gjerësia prej 4.0 – 6.5 m. Bazuar në gjerësitë dhe gjendjen e rrugëve (përfshirë faktorët reduktues nga ndikimet e lëvizshmërisë urbane), kapaciteti i rrugëve lokale sillet nga 500 – 800 aut/h/kahe.

Kushtet e përgjithshme teknike për projektim dhe ndërtim

Projektet për rrugët e reja duhet të hartohen në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Në pozicionet për të cilat në Republikën e Kosovë nuk ka standarde të aprovuara, projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Gjatë hartimit të projekteve duhet të mbahen parasysh të gjitha normat dhe standartet e miratuara për personat me aftësi të kufizuara, të verberit, etj. Në projekte të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Projektet dhe elaborati gjeodezik

Qëllimi i hartimit të dokumentacionit gjeodezik është që të formohet baza e shënimeve për punimin e dokumentacionit teknik- projektit, bartjen e shënimeve në terren dhe mirëmbajtjen e të dhënave gjeodezike gjatë eksploatimit të rrugës. Gjithsesi të bashkëngjiten të dhënat për koordinatat e pikave të rrjetit gjeodezik të vërtetuar nga organi kompetent.

Projektuesi duhet të incizoj gjendjen ekzistuese të terrenit në aspektin horizontal dhe vertikal, duke u lidhë në rrjetin gjeodezik referent të Republikës së Kosovës “KosovaRef 01 apo Pozicionimi Satelitor i Kosovës (KOPOS)“.

Të gjitha matjet gjeodezike, llogaritjet dhe barazimet duhet të bëhen me saktësi sipas Kornizave të Matjeve Kadastrale në Republikën e Kosovës.

Të gjitha matjet dhe punët gjeodezike duhet të kryhen sipas Ligjit për Kadastër të Republikës së Kosovës. Të gjitha objektet e incizuara në terren si: objektet ekzistuese, largpërçuesit, shtyllat elektrike, urat, lëshesat, pikat gjeodezike, pikat detale, kufijtë e njësive kadastrale, rrethojat prej materiali të ndryshëm, instalimet nëntokësore dhe mbitokësore (të paraqiten me shenja topografike përkatëse sipas çelësit topografik) të vizatohen- paraqiten në planin e situacionit në përpjesë $P= 1: 1\ 000$, e cila do të shërbejë si bazë për hartimin e projektit ndërtimor dhe projekteve të veçanta.

Gjerësia e incizimit gjeodezik duhet të jetë minimum 50.00 m majtas dhe 50.00 djathtas nga aksi i rrugës ekzistuese, te objektet, udhëkryqet, devijimet e rrugës dhe rrugët lidhëse në gjerësi të nevojshme si dhe të gjitha njësit kadastrale me të cilat kufizohet toka rrugore (për shkak të elaboratit të shpronësimit).

Në bazë të incizimeve të bëra duhet të dorëzohet elaborati gjeodezik i cili do të jetë pjesë e veçantë dhe përbërëse e projektit ndërtimor.

Elaborati i shqyrtimeve Gjeoteknike (Gjeomekanike)

Për punimin e projektit kryesor të rrugës dhe strukturave (mureve mbrojtëse dhe urave, pjerrësive të skarpateve) duhet të bëhen shqyrtimet gjeoteknike.

Shqyrtimet gjeoteknike, përfshijnë punimin e shpimeve adekuate dhe sondave, me qëllim të definimit të profilit gjatësor gjeoteknik dhe aftësisë bartëse të tokës.

Në bazë të nxjerrjes së sondave dhe ekzaminimeve laboratorike, duhet të punohet Elaborati Gjeoteknik. Numri i shpimeve do ta përcakton projektuesi, ashtu që niveli i ekzaminimeve të jep numër të mjaftueshëm të dhënave për përcaktimin e stabilitetit të gjermimit, mbushjes, përcaktimit të konstruksionit të rrugës dhe fundimit të objekteve.

Në Elabarat të paraqitet Raporti me të dhënat e nevojshme, pas shqyrtimeve gjeomekanike. Projektuesi duhet të punoj elabratin e mbrojtjes së mjedisit. Gjatë projektimit nevojitet që të parashihen të përdoren materialet që kanë testet e pranuara ndërkombëtare, në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit dhe punëtorëve. Duhet të parashihet deponimi i materialeve teprice sipas rregullativës për deponimin e hedhurinave. Në lokacionet ku parashihet që niveli i zhurmës të jetë për 5dB më e lartë se lejuar, duhet të parashihen barriera për pengimin e zhurmës, sipas tipit dhe standardeve të aprovuara në shtetet e BE. Për parandalimin e erozioneve të dëmshme duhet që në vend të drunjtëve të prerë të parashihet mbjellja e fidanëve të reja dhe të mbjellët bari në pjerrësitë e mbushjeve dhe gërmimeve. Dislokimi i rrjedhave të ujërave atmosferike, mund të bëhet vetëm në rastet e domosdoshme. Duhet ti largohemi mbushjeve shumë të ulëta, në pjesët e rrugës nëpër teren të rrafshët. Gjatë projektimit duhet ti largohemi gërmimeve të thella. Mbrojtja e ujërave nëntokësor duhet të bëhet përmes drenazheve adekuate.

Projekti i sinjalizimit të trafikut dhe pajisjeve të rrugës

Sinjalizimi i trafikut ka rolin kyç në udhëheqjen, rregullimin dhe sigurinë e trafikut. Për realizimin e projektit të sinjalizimit të trafikut duhet të respektohet legjislacioni në fuqi, si dhe rregullat dhe normat teknike dhe standardet. Në bazë të shënimeve nga projekti ndërtimor (situacioni- planimetria), projektuesi duhet të hartoj projektin e sinjalizimit dhe pajisjeve të rrugës, në përputhje me rregullativen ligjore në fuqi mbi projektimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal (Udhëzim administriv (MI) Nr. XX/2017 për për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor).

Projekti i strukturave (Urave, nënkalimeve, mbikalimeve dhe mureve mbrojtëse)

Projektuesi duhet të punoj projektin kryesor të urave, mbikalimeve, nënkalimeve për automjete dhe këmbësor, mureve mbrojtëse dhe strukturave tjera.

Pozicioni, gjatësia dhe forma e mureve mbrojtëse dhe strukturave do të caktohet nga projektuesi.

Elaborati i Shpronësimit

Ligjet dhe Standardet për Hartimin e Elabratit të Shpronësimit

Gjatë punimit të “Hartimi i Elabratit të Shpronësimit “, hartuesi i këtyre Elabrateve duhet ti përmbahet Ligjeve dhe plotësimeve të tyre:

- Ligjit për Kadastër.
- Kornizave për matje kadastrale në Republikëne Kosovës.
- Ligjit mbi RDPP.
- Ligji mbi Shpronësimin e pronave të paluajtshme.
- Ligji mbi rrugët të Republikës Kosovës.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- Ligjeve dhe rregulloreve mbi mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjes në punë.
- Planifikimi i rrugëve nga ministria e mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës (mmphi)

Autoudha

Në aspektin e projektimit dhe normave teknike të planifikimit, me qëllim të ruajtjes së brezit brojtës rrugor, duhet të respektohen kriteret:

Brezi mbrojtës rrugor ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme, në distancë më të vogël se 100 m nga autoudhat.

Brezi mbrojtës rrugor ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme, në distancë më të vogël 40 m nga autoudha.

Zgjerimi i rrugës nacionale N-9.1

Nga niveli qëndror, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është planifikuar zgjerimi i rrugës nacionale N-9.1 Gjakovë - Dollc me gjatësi 30.43 km. Ndërtimi i kësaj rruge është paraparë të zgjerohet në rrugë me nga dy korsi të trafikut për kahe fizikisht të ndara dhe një pjesë e kësaj rruge kalon nëpër territorin e Komunës së Gjakovës në segmentin Gjakovë – Rakovinë me gjatësi 16.16 km. Punimet në këtë rrugë me karakter nacional janë në proces të ndërtimit.

Zgjerimi i rrugës rajonale R-107 në drejtim të Prizrenit dhe Pejës

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (2016 – 2021), në kuadër të prioriteteve infrastrukturore, është paraparë rikonstruimin e rrugës Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren, respektivisht opsionin e zgjerimit të rrugës Rajonale R107 dhe R101 dhe R103, edhe për dy korsi të trafikut për kahe.

Në territorin e Komunës së Gjakovës, zgjerimi është paraparë në rrugën rajonale R-107 në drejtim të Prizrenit dhe Pejës. Zgjerimi përfshinë shtimin edhe të dy korsive shtesë, respektivisht dy korsi trafiku për kahe.

Me qëllim të rritjes së kapacitetit dhe shkallës së sigurisë për pjesët e rrugëve nacionale, duhet të përmirësohen dhe plotësohen kriteret:

Shpejtësia e lejuar, për pjesë të caktuara të rrugës, të jetë në varësi të kushteve të sigurisë, ndërsa në afërsi të udhëkryqeve dhe rrethrotullimeve shpejtësia e lëvizjes të kufizohet në 40 km/h;

Në pjesët e rrugës në të cilën janë të ndërtuara pronat e shumta ngjitur me shtrirjen e rrugës shpejtësia të kufizohet në 60 km/h, ndërsa në pjesët e rrugës ku janë evidentuar kyçjet nga

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

rrugët dytësore dhe nuk janë kushtet e mjaftueshme të sigurisë, shpejtësia të kufizohet në 40 km/h.

Përgjatë rrugëve të vlerësohet nevoja dhe përmbushja e standardeve teknike për infrastrukturë për lëvizje jomotorike;

Të gjitha objektet afariste të cilat janë të vendosura në të dy anët përgjatë rrugëve, duhet të plotësojnë kriteret teknike dhe të sigurisë me rastin e kyçjes në rrugë, në përputhje me Udhëzimin administrativ për kyçje teknike në rrugët nacionale dhe rajonale (MI- Drejtoria e rrugëve);

Me qëllim të rritjes së sigurisë gjatë kyçjes nga rrugët dytësore në rrugët kryesore, të eliminohen kyçjet e pakontrolluara, ndërsa kyçjet e lejuara të pajisen me sinjalizimin adekuat dhe korsitë për ngadalësim dhe përshpejtim, duke respektuar kriteret e sigurisë dhe standardet për kyçje në rrugë kryesore;

Gjatë proejktimit të rrethrotullimeve, të eliminohen hyrjet tangjenciale në rrethrotullim;

Në përputhje me numrin e korsive në degët hyrëse, të respektohen standardet e projektimit për të gjitha elementet projektuese të rrethrotullimit;

Të vendoset sinjalaizimi adekuat në afërsi dhe hyrje të rrethrotullimeve dhe udhëkryqeve, në përputhje me Udhëzimin administrativ (MI) Nr. XX/2017 për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor.

Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore të jenë në përputhje të plotë me UA 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor (Tabela 2 - Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore).

Kushtet e përgjithshme teknike për projektim dhe ndërtim të rrugëve të reja në nivel lokal

Në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal të Gjakovës, përpos rrugëve tjera të planifikuara në vendbanime dhe lokale, Komuna e Gjakovës ka planifikuar ndërtimin e rrugëve të reja që lidhin shumë vendbanime brenda pjesës urbane dhe në tërë territorin e Komunës.

Rrugët më të rëndësishme të cilat kanë për synim përmirësimin e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit:

Ndërtimi i rrugës qarkore në pjesën jugore të qytetit-Rruga “Bujar Roka”. Nga niveli qëndror, në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës është projektuar dhe është në realizim e sipër rruga “Bujar Roka” e cila devijon trafikun tranzit nga pjesa e qytetit në drejtim të kufirit me Shqipërinë dhe anasjelltas. Profili i kësaj rruge është planifikuar të jetë rreth 30 m, me nga dy

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

korsi trafiku për kahe, ndarje fizike mes kaheve, gjelbërim në dy anët e rrugës dhe infrastrukturë për lëvizje të pamotorizuara.

Ndërtimi i rrugës qarkore në pjesën lindore të qytetit - Rruga nacionale N-9.1 lidhet me rrugën rajonale R-107 në drejtim të Prizrenit. Rruga është planifikuar të jetë me nga dy korsi trafiku për kahe, ndarje fizike mes kaheve dhe infrastrukturë për lëvizje të pamotorizuara varësisht nga zhvillimet e zonës.

Ndërtimi i rrugës tranzitore (rrugën X) në pjesën veriore të qytetit – Rruga nacionale N-9.1 lidhet me rrugën R-107 drejtim Pejës. Rruga është planifikuar të jetë me nga dy korsi trafiku për kahe, ndarje fizike mes kaheve dhe infrastrukturë për lëvizje të pamotorizuara varësisht nga zhvillimet e zonës.

Ndërtimi i rrugës qarkore në pjesën veriore të qytetit - Rruga nacionale N-9.1 lidhet me rrugën rajonale R-107 në drejtim të Pejës. Rruga është planifikuar të jetë me nga dy korsi trafiku për kahe, ndarje fizike mes kaheve dhe infrastrukturë për lëvizje të pamotorizuara varësisht nga zhvillimet e zonës.

Ndërtimi i rrugës qarkore në pjesën perëndimore të qytetit – Rruga rajonale R-107 lidhet me rrugën nacionale N-9.1 në drejtim të Shqipërisë. Rruga është planifikuar të jetë me dy korsi trafiku (nga një korsi trafiku për kahe), infrastrukturë për lëvizje të pamotorizuara varësisht nga zhvillimet e zonës.

Në përputhje me normat e planifikimit dhe me qëllim të përmbushjes së strukturës dhe kërkesave për qarkullim rrugët duhet të plotësojnë këto kritere teknike:

Ndërtimi i rrugëve kryesisht duhet të bëhet konformë PZHU-së të Komunes. Në pjesët e rrugës kur hase ne zgjerimin e rruges, projektuesi duhet të propozoj zgjidhje alternative e cila do t'i prezantohet Komisionit për aprovim.

Shpejtësia e lejuar, për pjesë të caktuara të rrugës, të jetë në varësi të kushteve të sigurisë, ndërsa në afërsi të udhëkryqeve dhe rrethrotullimeve shpejtësia e lëvizjes të kufizohet në 40 km/h;

Përgjatë rrugëve të vlerësohet nevoja dhe përmbushja e standardeve teknike për infrastrukturë për lëvizje jomotorike;

Vendkalimet për këmbësorë të jenë në funksion të mobilitetit;

Të gjitha objektet afariste të cilat janë të vendosura në të dy anët përgjatë rrugëve, duhet të plotësojnë kriteret teknike dhe të sigurisë me rastin e kyçjes në rrugë, në përputhje me Udhëzimin administrativ për kyçje teknike në rrugët nacionale dhe rajonale (MI- Drejtoria e rrugëve);

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Me qëllim të rritjes së sigurisë gjatë kycjes nga rrugët dytësore në rrugët kryesore, të eliminohen kycjet e pakontrolluara, ndërsa kycjet e lejuara të pajisen me sinjalizimin adekuat dhe korsitë për ngadalësim dhe përshpejtim, duke respektuar kriteret e sigurisë dhe standardet për kycje në rrugë kryesore;

Gjatë projektimit të rrethrotullimeve, të eliminohen hyrjet tangjenciale në rrethrotullim;

Në përputhje me numrin e korsive në degët hyrëse, të respektohen standardet e projektimit për të gjitha elementet projektuese të rrethrotullimit;

Të vendoset sinjalaizimi adekuat në afërsi dhe hyrje të rrethrotullimeve dhe udhëkryqeve, në përputhje me Udhëzimin administrativ (MI) Nr. XX/2017 për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor.

Vendimi për shtrirjen e trasesë së rrugës (nëpër trasenë sipas Planit Zhvillimor Urban ose trase të re do të merret, pas shqyrtimit të varianteve të prezantuara nga projektuesi në Projektin ideor dhe arsyeshmërinë e dhënë zgjidhjes së variantit më të favorshëm).

Për shkak të sigurisë së lëvizjes, në pjesët e rrugës jashtë vendbanimit të projektohen shtigjet për çiklist të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës qarkulluese, ndërsa në vendbanime, nëse nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme për shteg të ndarë për çiklist, atëherë të projektohet korsi e shënuar për çiklist në sipërfaqen qarkulluese të rrugës;

Shtegu për këmbësorë me gjerësi minimale 1.20 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten probleme të shtrirjes së shtegut për këmbësorë, atëherë në pjesë të caktuara të rrugës, gjerësia mund të zvogëlohet, por nuk duhet të jetë më e vogël se 0.80 m.

Korsi/shteg për çiklist në të dy anët e rrugës me gjerësi minimale 1,5 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten problemet shtrirjesshtegut për çiklist, atëherë në pjesët e caktuara të rrugës, gjerësia mund të jetë 1.0 m.

Nëse korsi/shtegu për çiklist projektohet vetëm në një anë, atëherë gjerësia e korsisë duhet të jetë me gjerësi 2.0m - 2.5 m.

Nëse në pjesën e rrugës është e nevojshme qetësimi i trafikut (në afërsi të shkollave ose institucioneve tjera arsimore), duhet të vendosen masat për qetësimin e trafikut dhe sinjalizimi përkatës për reduktimin e shpejtësisë në 20-30km/h (zone 30km/h).

Pjesët e rrugëve të cilat shtrihen në vendbanim duhet të jenë të ndriçuara sipas normave teknike për ndriçimin e rrugëve publike.

Gjatë projektimit, projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet me largpërçuesit, rrjetin e telefonisë, rrjetin e ujësjellësit si dhe instalimet tjera që janë trupin e rrugës, brezin e rrugës dhe brezin mbrojtës të Rrugës dhe kycjet e objekteve rreth rrugës. Për të gjitha instalimet

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

nëntokësore dhe mbitokësore, projektuesi duhet të ofroj zgjidhje teknike për dislokimin eventual si dhe paramasat me parallogaritë.

Rënia tërthore e rrugës nëdrejtim, duhet të jetë në të dy anët e rrugës, min. 2.5 %, ndërsa në kthesa horizontale në njërenanë të rrugës (varësisht nga rrezja ekthesës).

Zgjidhja e largimit të ujërave nga rruga duhet të jetë kryesisht tipi i mbyllur (kanalizim atmosferik) për pjesën urbane dhe pjesërisht tipi i hapur (kanale atmosferike) për pjesën rurale.

Dimensionimi i konstruksionit të rrugës të bëhet duke u bazuar në kategorinë e tokës, kategorinë e rrugës, numrit të parashikuar të automjeteve dhe ngarkesave boshtore prej 115KN.

Strukturat (ura dhe objekte tjera inxhinierike) duhet të projektohen sipas normave Evropiane EURO COD.

Në segmente të caktuara hapësira e lirë nga niveleta e re e përvetësuar e rrugës deri te pika më e ultë e strukturave duhet të jetë min. 4.80m.

Projektimi i vend-ndaljeve për autobus, të bëhet në përputhje me standardet e projektimit, duke marrë parasysh karakterin e rrugës;

Kualiteti i të gjitha materijaleve të cilat përdoren për ndërtim, si dhe dimensionet e shtresave të konstruksionit të rrugës, duhet të jenë në përputhje me standardet dhe normat bashkëkohore për ndërtimin e rrugëve. Projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD, EN), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim;

Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore të jenë në përputhje të plotë me UA 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Brezi mbrojtës rrugor

Në qendrat e banuara, për ndërtimet ekzistuese dhe të reja, riparimet, rikonstruksionet dhe zgjerimet, janë vendosur kriteret për mbrojtjen e rrugës, të matura nga kufiri rrugor.

Sipas normave teknike të planifikimit hapësinor, brezi mbrojtës rrugor është një hapësirë e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e rrugës, distanca e të cilit kalkulohet nga cepi përfundimtar i brezit mbrojtës rrugor, dhe shërben përveç për mbrojtjen e rrugës dhe trafikut që realizohet nëpër të, gjithashtu edhe për kufizimin e llojit dhe shtrirjes së zhvillimit në të (Fig.37).

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026




Figura 2 Brezi mbrojtës rrugor⁶

Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore, janë sipas tabelës 57.

Tabela 14 Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore.

Kategoria e rrugës		Brezi i gjelbër ¹	Brezi mbrojtës	Brezi mbrojtës rrugor ⁵		Ngarkesa boshtore
				Distanca 12	Distanca 23	
Autoudhë		35 m	2 m	100 m	40 m	11.5 t
Rrugë nacionale		35 m	2 m	60 m	20 m	
Rrugë regjionale		22 m	2 m	40 m	10 m	
Rrugë të rrjetit primar	Rrugë tranzite urban	10 m	1 m	30 m	10 m	6 t
	Rrugë tranzite rurale					
	Rrugë përmbledhëse					
Rrugë sekundare	Rrugë servimore	8 m	1 m	/	/	
	Rrugë industriale					
	Rrugë banesore	/				

⁶ UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH-NR.08/2017 MBI NORMAT TEKNIKE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

	Rrugë qasëshe	/	1 m	/	/	
Shtigjeve për çiklist		3 m				
Vendparkimet		2.5 m				
Shtigje për këmbësorë				0.75 m4		

Përrjashtimisht, për shkak të mungesës së hapësirës për planifikim të një brezi të gjelbër, ky kusht nuk është obligues.

Distanca 1: ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme.

Distanca 2: ndalon ndërtimin e ndërtesave të banimit, administrative, hapjen e puseve të ujit dhe hapjen e gropave septike, ngritjen e instalimeve të transmetuesve elektrikë dhe të ngjashme.

Përgjatë shtigjeve për këmbësorë, korsive të rrugëve, dhe vend parkimeve jashtë rrugore.

Brezi mbrojtës rrugor nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimeve.

Rrugët lokale – përmirësimi i elementeve gjeometrike

Rrjeti rrugor në Komunën e Gjakovës përbëhet nga rrugë me gjerësi të ndryshme. Në kuadër të PZHK-së përpos ndërtimit të rrugëve të reja është paraparë edhe përmirësimi i rrugëve ekzistuese.

Sipas normave teknike të Planifikimit Hapsinor, rrugët lokale janë rrugët që lidhin vendbanimet rurale apo fshatrat, me përjashtim të atyre që zyrtarisht janë kategorizuar si rrugë nacionale apo regjionale.

Në përputhje me Normat e Planifikimit Hapsinor, me rastin e përmirësimit të rrugëve ekzistuese, rrjeti i infrastruktures rrugore duhet të plotësojë normat e planifikimit si në vijim:

- $\leq 40\text{km/h}$, gjerësiaekorsisështë: 2.75 m;
- $\leq 60\text{km/h}$, gjerësiaekorsisështë: 3.00 m;

Numri i korsive përcaktohet në baze të intensitetit të rrjetit.

Minimumi i gjerësisë së profilit për infrastrukturën e rrugëve publike urbane që do të shërbejnë gjatë përcaktimit të vijave rregulluese që përcaktojnë profilin e infrastrukturës rrugore publike janë:

- Rrugëtransitenëpërmjetvendbanimeve-fshatrave- 9, 50 m;
- Rrugëpërmbledhëse/shpërndarëse-10,50m;

- Rrugëservisore-9,00 m;
- Rrugëbanesore-8, 50m;
- Rrugëindustriale-10,00 m;
- Rrugëqasëshe/dykahëshe-5, 50 m; dhe
- Rrugëqasëshe/njëkahëshe - 3.5 m.

Kriteret për vendosjen e udhëkryqeve sipërfaqësore dhe udhëkryqeve në disnivel

Për funksionimin e mirë dhe funksional të udhëkryqeve sipërfaqësore, është e nevojshme ndarja e fluksit të trafikut në hyrje të udhëkryqeve (drejt, majtas, djathtas). Në hyrje të udhëkryqeve me sipërfaqe të mjaftueshme dhe me qarkullim më të madh të automjeteve, rrjedha e qarkullimit të trafikut mund të ndahet fizikisht (përmes ishujve kahëzues) me qëllim të zvogëlimit të pikave të konfliktit. Pjesa funksionale e udhëkryqeve sipërfaqësore duhet të përmbajë: zonat e perceptimit, rrjeshtimit, konfliktit dhe nxitimit.

Rrezja e rrumbullakësimit (harku) në udhëkryqe sipërfaqësore

Me qëllim të akomodimit të të gjitha automjeteve (varësisht nga struktura e automjeteve) dhe plotësimit të kriterëve të sigurisë gjatë lëvizjes nëpër udhëkryqe sipërfaqësore, në udhëkryqe duhet të plotësohen kriteret minimale teknike për rrezet e rrumbullakësimit.

Tabela 15 Vlerat minimale të rrezes së rrumbullakësimit (harkut) në udhëkryqe

Lloji i automjeteve	Rrezja e rrumbullakësimit (R) (m)		
	Kthimi majtas	Kthimi djathtas	
		Me ishull ndarës	Pa ishull ndarës
Automjetet	6	10	6
Kamiona dhe BUS	10	12	10
Kamionat me rimor.	12	15	12
Autobusët e mëdhenj	15	25	15

Kriteret për ndriçim

Ndriçimi i rrugëve duhet të projektohet në atë mënyrë që të siguroj:

Dukshmëritë mirëdhe ngasjetësigurt nëkushtet enatës,

Vërejtjenmekohëtë rrezikutpotencial,orientimtëmirëdhe siguritëpërgjithshmeperkëmbësorë,

Të gjithë pjesëmarrësve në trafik, vërejtje të sipërfaqeve të nevojshme dhe detale të rëndësishme të mjedisit gjatëlëvizjes.

Niveli i ndriçimit të rrugëve duhet të jetë në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit, Ligjin për rrugët dhe aktet nënligjore për ndriçimin e rrugëve. Projektuesimund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin menormat e BE-se (EN -The European Norm for Road Lighting), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Kushtet për kufizimin e shpejtësisë në rrugët lokale

Është e rëndësishme që të menaxhohet rrjedha e trafikut duke përdorur kontrollin e menaxhimit të shpejtësisë së trafikut për të përmirësuar sigurinë e trafikut për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Duke marrë parasysh, gjerësitë e ndryshme të rrugëve në Komunën e Gjakovës, për rrugët lokale rekomandohet kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes duhet në varësi të gjerësisë së rrugëve dhe strukturës së qarkullimit (Figura 38).




Figura 3 Kushtet për kufizimin e shpejtësisë në rrugët lokale

Klasifikimi funksional i rrjetit rrugor

Aktualisht, infrastruktura e transportit në Gjakovë është e përbërë nga një strukturë dhe klasifikimi jo funksional të rrjetit rrugor. Kyçjet e shpeshta dhe të pakontrolluara në aspektin hierarkik të rrugëve, me ç'rast rrugët e rangut më të ulët kyçen direkt në rrugët e rangut më të lartë, kanë ndikuar direkt në zvogëlimin e kapacitetit të lëvizjes dhe uljen e nivelit të shërbimit të infrastrukturës rrugore.

Nevoja për përmirësimin e strukturës dhe klasifikimin hierarkik të rrjetit rrugor mbetet opioni i vetëm për përmirësimin e kapacitetit, sigurisë në trafik dhe nivelit të shërbimit të rrjetit rrugor.

Me rastin e klasifikimit funksional të rrjetit rrugor në nivel lokal, duhet pasur parasysh kyçjet e rrugëve varësisht hierarkisë dhe funksionit të tyre. Më rastin e kyçjes në rrjetin rrugor, të merren në konsideratë kriteret e sigurisë, si :

Për rrjetin rrugor primar:

- Rrugët mbledhëse (nga rrjeti rrugor sekundar) të kçjet në rrugët kryesore urbane (rrjetin rrugor primar).
- Për rrjetin rrugor sekundar:
- Rrugët për çasje të kyçen në rrugë lokale,
- Rrugët lokale të kyçen në rrugët mbledhëse.




Figura 4 Klasifikimi funksional i rrjetit rrugor

Rrugët publike jo të motorizuara

Në PZHK, është paraparë ndërtimi i shtigjeve të reja, përmirësimi i atyre ekzistuese dhe ndërlidhja funksionale e shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë.

Sipërfaqet për lëvizje të këmbësorëve

Për përmirësimin e nivelit të shërbimit dhe shkallës së sigurisë për këmbësorë, duhet respektuar këto kriteret:

Shtegu i këmbësorëve nënkupton sipërfaqen e rregulluar për lëvizjen e këmbësorëve dhe duhet të jetë i ndarë nga korsitë e mjeteve motorike;

Koncepti i rrjetit të shtigjeve për këmbësorë duhet të formojë një rrjet funksional të rrugëve pa pengesa;

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Korsitë e bicikletave të planifikohen vetëm në rrugët ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve nuk kalon 50km/h;

Shtegu i bicikletave mund të jetë i përbashkët me atë të këmbësorëve;

Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për një kahe (varg) të këmbësorëve duhet të jetë min. 0.80 m,

Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për lëvizje në dykahe duhet të jetë min. 1.60 m,

Për të siguruar lëvizjen e papenguar të personave me aftësi të kufizuara, gjerësia e shtigjeve për këmbësorë duhet të jetë të paktën 1.80 m, përjashtimisht 1.50 m, ndërsa gjerësia e kalimeve ndërmjet pengesave fikse duhet të jetë të paktën 0.90 m.

Rampat për qasje të personave me aftësi të kufizuara në hapësire janë të ndërlydhura dhe të përshtatura për orientimin, dhe me pjerrësi të cilat nuk mund të jenë me të mëdha se 5%, përjashtimisht 8%.

Vendkalimet për këmbësorë

Vendkalimet për këmbësorë janë vende kritike në të cilat kryqëzohen lëvizjet e këmbësorëve dhe qarkullimi i automjeteve. Prandaj, në procesin e vendosjes së vendkalimeve për këmbësorë, nga projektuesi duhet të verifikohen:

Arsyeshmëria e vendkalimit për këmbësorë;

Përshatshmëria e lokacionit;

Sinjalizimi adekuat për vendkalimin e këmbësorëve.

Kushtet për vendosjen e lokacioneve për vendkalim të këmbësorëve

Për shënimin e vendkalimeve për këmbësorë, duhet të plotësohen kushtet si në vijim:

Sigurimi adekuat i dukshmërisë;

Gjerësia minimale e vendkalimit për këmbësorë duhet të jetë 3.0 m, ndërsa në pjesët e rrugëve në të cilat kërkesa për kalimin e rrugës është e madhe (lëvizjet grupore), atëherë gjerësia duhet të jetë 5.0 m.

Nëse në afërsi të vendkalimeve për këmbësorë janë të vendosura parkingjet gjatësore në rrugë, atëherë me qëllim të sigurimit të dukshmërisë, në vendkalim të këmbësorëve duhet të ngushtohet rruga për gjerësinë e parkingut gjatësor (Fig.8);

Disatnaca nga vendkalimi tjetër të jetë më e madhe se 100 m;

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Në pjesët e rrugës në të cilat ka frekuentim të më të madh të këmbësorëve, vendkalimet për këmbësorë të projektohen me ndriçim të vendkalimit dhe të përdoret sinjlaizimi me dritë vezulluese në gjysmëportal, i cili paralajmëron ngasësit për ngritje të vemendjes në afërsi të vendkalimit për këmbësorë.

Vendkalimet për këmbësorë duhet të sigurojnë çasje të lehtë dhe të sigurt personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e projektimit për këtë kategori.

Kriteret teknike dhe të sigurisë për vendndodhjen e vendkalimeve për këmbësorë janë dhënë në Tabelen.

Tabela 16 Distanca dhe vendndodhja e vendkalimeve për këmbësorë

Emërtimi	Lloji i udhëkryqit	Distanca min. (m) ndërmjet udhëkryqeve	Rregullimi i kthimit majtas	Tipi i kalimit të këmbësorëve	Kalimi i këmbësorëve
Rrugë urbane-Arterie	Mundësisht jo në disnivel	300	E ndaluar në rrafsh	Në disnivele ose me semafor	Në kryqëzim
Rrugë kryesore urbane-përmbledhëse	Të organizuara në rrafsh	100	E kontrolluar	Me semafor ose me zebra	Në kryqëzim ose në pjesë të rrugës
Rrugë servitore-banesore	Të organizuara në rrafsh	100	E kontrolluar ose me rregulla të qarkullimit	Me zebra	Në kryqëzim ose në pjesë të rrugës
Rrugë lokale-qasëshe	Të paorganizuar	-	E lejuar	Me zebra	-

Projektimi, ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e cilësisë së infrastrukturës për këmbësorë është një element thelbësor në krijimin e një ambienti miqësor për këmbësorët. Një pjesë e rëndësishme e planifikimit të paraqitjes së ardhshme të rrugëve është parashikimi i gjerësisë dhe numrit të korsive dhe vëllimi i përgjithshëm i trafikut që mund të ndikojë në nivelin e lëvizshmërisë së këmbësorëve.

Rregullimi dhe projektimi i vendkalimeve për këmbësorë me nevojat e përdoruesve të ndryshëm, të rrugës, mbështetet në kriteret teknike të sigurisë, të cilat janë në varësi të: madhësisë së qarkullimit të trafikut të automjeteve motorike (trafikun mesatar ditor vjetor – TMDV), numri i korsive të trafikut, shpejtësisë maksimale, shkallës së sigurisë së trafikut etj. (Figura 40).

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Nr. i korsive dhe lloji i ishullit ndarës	TMDV (AADT) < 9000 automjete			TMDV (AADT) > 9000-12000 automjete			TMDV (AADT) > 12000-15000 automjete			TMDV (AADT) > 15000 automjete		
	Kufizimi i shpejtësisë											
	≤50 km/h	<60 km/h	≥65 km/h	≤50 km/h	60 km/h	≥65 km/h	≤50 km/h	60 km/h	≥65 km/h	≤50 km/h	60 km/h	≥65 km/h
2 korsi të trafikut												
3 korsi të trafikut												
Më tepër korsi (4 ose më shumë) ishulli ndarës i ngritur												
Më tepër korsi (4 ose më shumë) pa ishulli ndarës të ngritur												




TMDV	Trafiku mesatar ditor vjetor (automjete/ditë)
	Para shënimit të vendkalimit për këmbësorë është e nevojshme të vlerësohet nevoja për vendkalimit të këmbësorëve. Me studime inxhinierike duhet caktuar jo vetëm kriteret e lokacionit por edhe vëllimin e qarkullimit të këmbësorëve, shpejtësinë e automjeteve dhe kushtet tjera të sigurisë.
	Vendkalim i shënuar për këmbësorë në nivel të njëjtë me rrugën. Duhet vlerësuar se a mjafton vetëm shënimi i vendkalimit për këmbësorë apo janë të nevojshme edhe masat shtesë.
	Nuk mjafton vetëm vendkalim i shënuar për këmbësorë në nivel të njëjtë me rrugën. Duhet analizuar variante tjera të trupimit të rrugës që mund të përirësojnë sigurinë e këmbësorëve si masat e qetësimit të trafikut, rregullimi i vendkalimeve me semafor, përdorimi i teknologjisë bashkëkohore SIT, nënkalime ose mbikalime për këmbësorë.

Figura 5 Kriteret për përzgjedhjen e vendkalimit optimal për këmbësorë⁷

Korsitë dhe shtigjet për biçikleta

Në kuadër të Udhëzimit administrativ të MMPH për normat teknike të planifikimit hapsinor, sipërfaqet e dedikuara për lëvizje të biçikletave, ndahen në korsi dhe shtigje për biçikleta (Figura 41).

Korsitë për biçikleta janë pjesë e rrugës, e destinuar për qarkullimin e biçikletave, e shënuar me shenja përkatëse të komunikacionit. Korsitë për biçikleta planifikohen në rrugë ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve nuk kalon 50 km/h.

Shtigjet për biçikleta janë hapësire qarkulluese e destinuar për qarkullimin e biçikletave, e zbatuar ndaras nga profili tërthor i rrugës i shënuar me shenjat e dhura të komunikacionit. Shtegu mund të jetë i përbashkët për biçikleta dhe këmbësor.

⁷ Nemotorizirani promet, Zagreb 2015




Figura 6 Shtegu dhe korsi për biçikleta

Sipas standardeve të projektimit dhe normave të planifikimit (Udhëzimit administrativ të MMPH) për përmirësimin e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave në rrugët ekzistuese dhe për rrugët e reja të planifikuara, duhet që:

Shtigjet për biçikleta jashtë vendbanimeve duhet të planifikohen si të ndara, me një brez të gjelbër të gjerësisë adekuate dhe pa pengese mbrojtëse, nga profili i tërthor i rrugës. Përgjatë, për shkak të mungesës së hapësirës për planifikim të një brezi të gjelbër, shtegu për biçikleta duhet të sigurohet me një pengesë mbrojtëse ngacëliku.

Gjerësia optimale/minimale dhe lartësia e shtegut për biçikleta jashtë vendbanimit: shteg njëdrejtimësh, në të dyja anët e rrugës:

me gjerësi: 1.50/1.00 m,

me lartësi: 2.50 m.

Për arsye të sigurisë nuk rekomandohet zbatimi i korsive për biçikleta jashtë vendbanimeve.

Në pjesët e rrugëve në të cilat shpejtësia e lëvizjes planifikohet të jetë më e madhe se 50 km/h, atëherë duhet të planifikohet edhe brezi mbrojtës.

Gjerësia minimale e brezit mbrojtës të korsive dhe shtigjeve për biçikleta duhet të jetë: ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me korsi të rrugës, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe të ngritur dhe ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me shtigje për këmbësor apo vend-parkingje gjatësore, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe të ngritur, të gjelbër apo me elemente standarde ose të ngjashme.

Parkimi i biçikletave duhet të vendoset ashtu që të mos pengojë qarkullimin e këmbësorëve si dhe aty ku mund të sigurohet kontrolli,

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Kriteret teknike për vendosjen e sipërfaqeve për parkim të biçikletave të jenë në përputhje me normat teknike të planifikimit dhe standardet teknike,

Vend-parkimet për biçikleta duhet të përbehen nga: hapësira e vend-parkimit prej 1.20 m²/ biçiklete dhe hapësira qasëshe në vend-parkim, me gjerësi: 1.50/ 1.80 m.

Në vendet ku ka mundësi të vendosjes së parkingjeve për biçikleta, të respektohen normat dhe standardet teknike për parkingje të biçikletave.

Tabela 17 Numri i vend-parkingjeve për biçikleta

Përshkrimi i përmbajtjes së ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve për biçikleta (VPB)
Përmbajtjet tregtare dhe komunale	5 VPB/100 m ² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN) për vizitor
Përmbajtjet e bizneseve dhe publike	1 VPB/100 m ² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN) për të punësuar
Përmbajtjet arsimore	1 VPB/ 5 nxënës, për vizitor + 1 VPB/10 të punësuar
Përmbajtjet kulturore- teatro dhe muze	10 VPB/100 ulëse, për vizitor
Përmbajtjet shëndetësore- spitale	10 VPB/100 shtretër, për vizitor
Përmbajtjet sportive dhe rekreative	10 VPB/100 ulëse, për vizitor

Kriteret për planifikimin e infrastrukturës për biçikleta

Me rastin e planifikimit ose përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese për biçikleta në kushte urbane, duhet të merren parasysh kriteret teknik dhe të sigurisë për infrastrukturën për biçikleta. Kriteret teknike për përdorimin, respektivisht mospërdorimin e sipërfaqes së përbashkët nga këmbësorët dhe çiklistët.

Tabela 18 Kriteret për shfrytëzimin e infrastrukturës së përbashkët nga çiklistët dhe këmbësorët

Këmbësorë/h nëse gjerësia e shtegut	Planifikimi i shtegut
< 100	Sipërfaqe e përbashkët
100-160	Vetëm ndarje vizuale
160 – 200	Ndarje vizuale dhe ndarje në nivel
>200	Nuk mund të shfrytëzohet sipërfaqja e njëjtë

Tabela 19 Gjerësia e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave

Lloji i sipërfaqes për biçikleta	Optimale	Minimale
Korsia për biçikleta	1, 50	1, 00
Shtegu njëkahorë për biçikleta	2, 00	1, 50
Shtegu dykahorë për biçikleta	2, 50	2, 00

Rruga për biçikleta	3, 50	2, 50
---------------------	-------	-------

Rrjeti hekurudhor i lehtë dhe i rëndë

Aktualisht, Komuna e Gjakovës nuk është e kyçur në rrjetin hekurudhor. Ekziston një linjë hekurudhore që kalon përmes Dukagjinit- deri ne qytetin e Pejës, por kjo linjë nuk kalon nëpër qytetin e Gjakovës. Stacioni më i afërt hekurudhorë gjendet në Xërxë, në komunën e Rahovecit, rreth 10 km nga qyteti i Gjakovës. Megjithatë ka pasur plane të ndryshme për linjat hekurudhore. Plani Gjeneral Urban i viti 1980 ka paraparë një linjë në pjesën jugore të qytetit. Kjo linje do ti lidhte zonat më të mëdha industriale këtu, dhe do ta shkarkonte trafikun në këtë drejtim. Gjithashtu ka pasur plane që të zgjerohet kjo linjë deri në Shqipëri. Plani Hapësinor i Kosovës i vitit 2010 ka paraparë një lidhje ndërmjet pjesës veriore të qytetit të Gjakovës dhe Kromovikut në linjën Prizren-Klinë. Gjatë projektimit dhe ndërtimit në zonat e parapara me këtë hartë zonale duhet të respektohen distancat e brezit mbrojtës të hekurudhës në bazë të legjislacionit dhe rregullativës përkatëse në fuqi. UA. 08/2017 përcakton kërkesat për planifikim të infrastrukturës hekurudhore:

gjerësia e binareve është 1435 mm, me atë që nuk mund të jetë më e vogël se 1430 mm dhe as më e madhe se 1470 mm, duke përfshirë zgjerimin e binareve në një kurbë;

rrezja e lakimit në korsisë së hapur është të paktën 300 m, ndërsa në binarin kryesor kalimtar në stacionin hekurudhor është të paktën 500 m; profili i jashtëm hekurudhor, në varësi të madhësisë së rrezes së lakimit dhe kufirit të shpejtësisë, duhet të jetë më i ngritur, por jo më shumë se 150 mm;

pjerrësia maksimale e niveletës/ shtrirjes vertikale në hekurudhë të hapur është jo më shumë se 25 ‰;

pjerrësia maksimale e niveletës/ shtrirjes vertikale në stacionin hekurudhor është: për stacion të trenit në drejtim deri në 1 ‰, ndërsa për stacion të trenit në kurbë deri në 2.5 ‰, në varësi të rrezes së lakimit;

distancat ndërmjet hekurudhave në stacionin hekurudhor duhet të jenë të tilla që ndërmjet profileve të lira të këtyre hekurudhave të ketë hapësirë të nevojshme për lëvizje të sigurt të udhëtarëve dhe personave të tjerë dhe për vendosje të ndërtesat ndihmëse, pajisjeve mbështetëse dhe shtyllave sinjalizuese, të rrjetit elektrik, ndriçimit, etj;

distancat ndërmjet hekurudhave në stacion hekurudhor duhet të jenë të paktën 4.75 m, ndërsa distancat e hekurudhave ndërmjet të cilave bëhet ngritja e platformave me lartësi 0.55 m, mbi skajin e sipërm të hekurudhës është të paktën 6.00 m;

distancat e hekurudhave në linjë të hapur tek binaret e dyfishtë dhe linjat paralele është të paktën 4 m;

pesha e lejuar në linjat primare është të paktën 22.5 t në bosht dhe 8.0 t për metër gjatësi, ndërsa në linjat sekondare dhe terciare 18.0 t në bosht dhe 6.4 t për metër gjatësi.

Brezi mbrojtës hekurudhor

Brezi mbrojtës hekurudhor është një hapësirë e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e hekurudhës, gjerësia e të cilit kalkulohet nga boshti i binarit përfundimtar dhe shërben për mbrojtjen e hekurudhës dhe trafikut që realizohet nëpër të:

brezi mbrojtës hekurudhor i përgjithshëm është me gjerësi 8.00 m;

brezi mbrojtës hekurudhor në hapësira të populluara është me gjerësi 6.00 m.

Brezi mbrojtës hekurudhor përfshin tokën nën hekurudhë dhe hapësirën ajrore në një lartësi prej 14 m. Brezi mbrojtës hekurudhor, gjithashtu përfshin edhe hapësirën tokësore të vendeve zyrtare (stacioneve, ndalesave, kryqëzimeve, „nivelatave“, etj) që përfshin gjithçka që është teknike- ndërtesat teknologjike, instalimet dhe qasjet deri në rrugën publike më të afërt në rast të zjarrit.

Brezi rregullues hekurudhor

Brezi rregullues hekurudhor është një hapësirë e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e hekurudhës, gjerësia e të cilit llogaritet nga cepi përfundimtar i brezit mbrojtës hekurudhor; dhe shërben përveç për mbrojtjen e hekurudhës dhe trafikut që realizohet nëpër të, gjithashtu edhe për kufizimin e llojit dhe shtrirjes së zhvillimit në të.

Brezi rregullues hekurudhor (1) ka gjerësi prej 25 m. Në këtë brez lejohet vetëm mirëmbajtja dhe zhvillim teknologjik të kapaciteteve të infrastrukturës.

Brezi rregullues hekurudhor (2) ka gjerësi prej 100 m. Në këtë brez ndalohet ndërtimi i ndërtesave të tilla si: miniera, gurë-thyes që aplikon materiale eksplozive, ndërtesa industriale-kimike dhe të produkteve eksplozive, fabrika dhe ndërtesa tjera të ngjashme, në një gjerësi prej 50 m.




Figura 7 Brezi mbrojtës dhe rregullues hekurudhor⁸

Ndërtesat dhe sipërfaqet për transport ajror

Aeroporti i vetëm në Kosovë dhe i vetmi për përdorim civil është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Ndërsa, një aeroport i vogël ushtarak i cili për momentin është jashtë funksionit, gjendet afër Gjakovës.

Aeroporti i Gjakovës ndodhet rreth 3 km në pjesën veri-lindore të Gjakovës. Deri në vitin 1999, kur është marrë nën mbikqyrje të KFOR-it, ky aeroport ka shërbyer si aeroport bujqësor.

Deri sa ky aeroport ka qenë nën mbikqyrje të KFOR-it janë zhvilluar vetëm fluturime për nevoja ushtarake apo humanitare me kryesisht avion dhe helikopter transportues ushtarak. Pista e vetme është e asfaltuar në gjatësi prej 1800 m, e gjerësi 30 metra, si dhe heliodromi i ri, në tërësi sipas standardeve ndërkombëtare të aviacionit, ndërsa lartësitë përreth aeroportit janë kodra që nuk kalojnë 1000 m.

Në të ardhmen, aeroporti i Gjakovës mundet me qenë i hapur edhe për qëllime tjera, për përdorim civil si plotësim – alternativë e aeroportit të Prishtinës. Avancimi i aeroportit të Gjakovës në aeroport civil është paraparë edhe me Planin Hapësinor të Kosovës⁹.

Gjithashtu, edhe në Harten Zonale të Kosovës¹⁰, në kuadër të veprimeve për përmirësimin e gjendjes së infrastrukturës së transporti, është paraparë funksionalizimi dhe shndërrimi i Aeroportit të Gjakovës në aeroport civil.

Sipas Udhëzimit Administrativ MMPH-NR.08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, kushtet e përzgjedhjes së lokacionit varen nga kushtet topografike, gjeologjike dhe meteorologjike si dhe pozita në raport me hapësirat e ndërtuara përreth. Hapësire e mjaftueshme tokësore duhet të jetë në dispozicion për rrugën e ngritjes/ aterrimin (në rastin e

⁸ Udhëzimit administrativ mmph-nr.08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor

⁹ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS, 2010.

¹⁰ Harta Zonale e Kosovës 2020 – 2028+

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

aeroporteve) dhe platformat (në rastin e ‘heliporteve’), ndërtesat e terminaleve (të udhëtareve dhe të mallrave) dhe të mirëmbajtjes, depozitimit të karburanteve, dhe në mënyre ideale, për zhvillim në të ardhmen. Një tjetër faktor i rëndësishëm që duhet konsiderohet gjatë përzgjedhjes së lokacionit është edhe afërsia e rrjeteve transportuese, ekzistuese dhe potenciale, në afërsi

Funksionalizimi dhe shndërrimi i Aeroportit të Gjakovës në aeroport civil, duhet të jetë në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e tjera që bazohen në standardet dhe praktikrat e rekomanduara të përcaktuara nga Organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil.

Ndërtesat dhe sipërfaqet për transport publik urban dhe rural

Transporti i udhëtarëve në komunën e Gjakovës realizohet në tri nivele:

Transporti ndërurban dhe ndërkombëtar (i cili lidhë Gjakovën me qytetet tjera të Kosovës dhe jashtë Kosovës),

Transporti urbano-periferik (i cili lidhë qytetin e Gjakovës me fshatrat brenda Komunës) dhe

Transporti urban (i cili lidhë zonat e ndryshme brenda qytetit të Gjakovës).

Aktualisht në qytetin e Gjakovës funksionon një linjë e transportit urban të udhëtarëve. Kjo linjë itinerarin e udhëtimit e fillon nga Piskota (në veri) kalon pranë objekteve kryesore të qytetit të cilat ndodhen në qendër të qytetit dhe si pikë të fundit ka stacionin pranë Spitalit Rajonal ‘Isa Grezda’. Ndërsa, në kthim kalon pranë shkollave të mesme dhe përfundon në stacionin fillestar të itinerarit. Kjo linjë në dy drejtime ka gjatësi rreth 17 km.

Në kudër të PZHK-së është paraparë fuqizimi dhe rivitalizimi i transportit publik. Me qëllim të përmirësimit dhe funksionalizimit të transportit urban masat prioritare për autobusë dhe vendndaljet e përmirësuara të autobusëve janë si në vijim:

Vendosja e masave prioritare për autobusë aty ku është e mundshme, kryesisht në rrugët kryesore në afërsi të qendrës së qytetit.

Përmirësimet e sistemeve të informacionit për shërbimet e autobusëve në vendndalje për autobus/kabinat e autobusëve dhe destinacionet kyçe (p.sh. zonat tregtare / qendrat kryesore të punësimit).

Futja e informacioneve në kohë reale për pasagjerë dhe futja e njoftimeve dhe ekraneve brenda në automjete do të rrisë cilësinë e udhëtimit për përdoruesit.

Zhvillimi i vendndaljeve për autobusë, duke përfshirë përmirësimin e qasjes në vendndalje për autobusë, shtigje të gjera për këmbësorë dhe elemente të reja si streha, ulëset, ndriçimit dhe informacioni.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Komuna do të caktoj pikat e ndaljes së transportit publik, kryesisht në vendet më të frekuentuar duke pasur parasysh kritetret e vendosjes së stacioneve dhe të sigurojë për to infrastrukturën e nevojshme.

Ndërtimi i vend ndaljeve për autobusë komunal

Elementet teknike minimale për ndërtimin e vendndaljeve për autobusë janë dhënë në Tabelat 63 dhe 64.

Tabela 20 Elementet teknike minimale horizontale në varësi të shpejtësisë së hyrjes

Shpejtësia hyrëse (km/h)	a (m)	b (m)	a' (m)	b' (m)	l (m)	R1 (m)	R2 (m)	R3 (m)	R4 (m)
30	16,00	15,00	3,80	4,00	3,10	40,00	30,00	20,00	40,00
40	17,00	15,00	5,30	4,00	3,10	60,00	40,00	20,00	40,00
60	25,00	15,00	4,80	4,00	3,60	80,00	60,00	20,00	40,00

Tabela 21 Gjatësia e vendndaljes dhe zona e pritjes së autobusit në varësi të shpejtësisë së hyrjes, llojit të autobusit dhe numrit të autobusëve që ndalojnë në ndalesë në të njëjtën kohë.

Shpejtësia hyrëse (km/h)	30, 40, 50, 60	30		40		60	
Gjatësia (m)	L_a	L	L'	L	L_a	L	L'
një autobus	13,00	44,00	51,80	45,00	13,00	44,00	51,80
dy autobus	26,00 *	57,00	64,80	58,00	26,00 *	57,00	64,80

Shënim: * Është marrur parasysh distanca 1.0 m ndërmjet dy autobusëve të cilët qëndrojnë në vendndalje të autobusëve




Figura 8 Elementet teknike minimale horizontale të vendndaljes së autobusit

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Stacioni multimodal - Në kuadër të PZHK-së, propozohet ndërtimi i një stacioni multimodal- Ndërtimi i stacionit hekurudhor në zonën në afërsi të stacionit të autobusëve.

Për përzgjedhjen e lokacionit adekuat dhe lidhjeve funksionale të stacionit multimodal, duhet të bëhet një studim i fizibilitetit.

Në përzgjedhjen e lokacionit duhet të merren parasysh kriteret si në vijim:

Teknologjike (qasja në/nga terminali, lidhja me forma të ndryshme të transportit, etj.);

Ekonomike (shpenzimet logjistike, investimet për ndërtimin e infrastrukturës së transportit dhe infrastrukturës tjetër etj.);

Organizative (shërbimet e logjistikës, organizimi i formave të ndryshme të transportit etj.);

Teknike (karakteristikat gjeologjike të lokacionit, infrastruktura e nevojshme teknike, krijimi i mundësive teknike për lidhje funksionale të të gjitha formave të transportit etj.);

Ekologjike (ndikimi I ndërtimit të terminalit në mjedisin dhe anasjelltas, ndotja e ajrit, zhurma etj.).

Sipërfaqet publike për vendparkim

Hapësirat për parkingje publike në qytetin e Gjakovës janë të ndara në tri zona. Varësisht nga zona është i caktuar edhe çmimi i vendeve për parkim. Çmimi i pagesës për parking është i përcaktuar në bazë të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha Komunale, e miratuar nga Asambleja e Kuvendit Komunal Gjakovë.

Sipas normave të planifikimit hapsinor, janë katër llojet themelore të parkimit:

Vendparkim rrugor, nënkupton vend-parkimin në rrugë dhe mund të jetë vend-parkim në formë gjatësore, të pjerrëtdhetërthore;

Vendparkim jashtërrugor publik, nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor, por të qasshëm si edhe rrugët publike;

Vendparkim jashtërrugor privat, nënkupton vend-parkimin si pjesë përbërëse e një ndërtese, të një qendre biznesiosekomerciale;

Vendparkim jashtërrugor privat për banor, nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor të ndërlidhur me ndërtesat e banimit individual dhe nëbashkëpronësi.

Vendparkimi rrugor për automjete, vendparkimi rrugor është pjesë e profilit tërthor rrugor të vendbanimeve. Vend-parkimet rrugore mund të planifikohen në format në vijim:

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Parkimi i automjeteve për nevoja të ndërtesës së banimit projektohet me dokumentet e planifikimit hapësinor si hapësirë nën tokësore, mbi tokësore i hapur ose i mbuluar, në kuadër të objektit garazhe ose i kombinuar.

Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë e banimit duhet të jetë minimum një vend parkim për një banesë.

Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë afariste, në kuadër të ndërtesës, duhet të jetë minimum një vend parkim për 30 m² neto sipërfaqe afariste, nëse me dokumente të planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe.

Largësia nga vend parkimi i fundit deri te hyrja e ndërtesës duhet të jetë jo me shume se 100 m nëse me dokumentet e planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe.

Dimensionet minimale për hapësirat e parkimit në varg për automjete motorike standarde do të jenë si më poshtë:

- Vendparkiminë 90° - 250 cm x 455cm;
- Vendparkiminë 60° - 250 cm x 485 cm;
- Vendparkiminë 45° - 250 cm x 485 cm ;
- Vendparkiminë 30° - 250 cm x 425 cm;
- Vendparkimiparalel - 215cm x 640 cm;
- Vendparkimii rrethuar - 270 x 550cm.

Sipërfaqet publike për vendparkim

Vend-parkimet për qëllime të veçanta iu përkasin vend-parkimeve të rezervuara për qasje të personave me aftësi të kufizuara:

Vendparkimet për qasje të personave me aftësi të kufizuara, përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, përmbajnë edhe hapësirështesë për hyrje/dalje nga automjeti;

Së paku 5% e numrit të gjithmbarshëm të parkingjeve duhet të jenë për qasje të personave me aftësi të kufizuara;

Vendparkimi duhet të jetë i vendosur me afër hyrjes në ndërtesë dhe duhet të plotësojë këto kushte:
Dimensionet bazë të vendparkimit, gjatësor, në pjerrësi dhe pingul, për një automjet janë: 3.70 x 5.00 m;

Dimensionet bazë të vendparkimeve, gjatësore, në pjerrësi dhe pingul, për dy automjete janë: 5.90 x 5.00 m, me një distancë vend-kalimshtesë për hyrje-dalje të automjetit prej 1.50 m;

Vendkalimi shtesë për hyrje-dalje nga vendparkimi në shtigjet e këmbësorëve të siguar me gurin skajor nuk lejohet të ketë pjerrtësim të madhetë se 10% dhe gjerësim të vogël se 1.20 m.

Vendparkimet për qasje të fëmijëve në automjetet transportuese të veçanta:

Vendparkimet për qasje të fëmijëve të vegjël deri në 6 vjeç në automjete transportuese të veçanta, shënohen në mënyrë që të ju lehtësojnë prindërve marrjen e fëmijëve dhe të pajisjes së

tyre. Përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, këto vend-parkime për mbajnë edhe hapësirë është së për hyrje/dalje nga automjeti;

Gjerësishtesën të dyjaanët evend-parkimit është nga 1.00 m, apo 2.00/2.30 m në tërësi.

Standardet numrin e vendparkimeve, varësisht nga përmbajtja, janë dhënë në tabelën vijuese:

Infrastruktura e energjisë elektrike

Rrjeti i shpërndarjes lokale i energjisë elektrike

Furnizimi i konsumatorëve të qytetit të Gjakovës dhe vendbanimeve të kësaj komune bëhet nëpërmjet nënstacioneve elektrike egzistuese të nivelit të tensionit 110/35/10(20) kV nënstacioni Gjakova 1. nënstacionit Gjakova 2.




Figura 9 Rrjeti nga furnizohet me energji elektrike komuna dhe rrethi i Gjakovës

Këta dy nënstacione pastaj furnizojnë nëpërmjet lidhjeve unazore nga nënstacionet përkatëse - NS 220/110 Prizreni 2 dhe NS 400/110 kV Peja 3 dhe kufiri ndarës ndërmjet kompanive energjetike KOSTT dhe KEDS është pikërisht në NS e nivelit 110/XX kV.

Duhet theksuar se në nivelin e transmetimit ku përgjegjësia është e KOSTT-it ky konsum mbështet nga nënstacionet si më poshtë.

Rrjeti i nivelit të tensionit 110kV.

Plotësimin e nevojave për furnizim të konsumatorëve me energji elektrike në komunën e Gjakovës me rrethinë siç u cekë më lartë bëhet në nivelin e tensionit 110 kV siç u cekë më lartë janë të instaluar dy nënstacione:

NS 110/35/10(20) kV Gjakova 1 me fuqi të instaluar prej 40 MVA.

NS 110/35/10(20) kV Gjakova 2 me fuqi të instaluar prej 63 MVA

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Në total fuqia e instaluar në këto nënstacione është 103 MVA dhe këta nënstacione janë të lokalizuar në qytetin e Gjakoves.

Këta nënstacione furnizohet nga linjat energjetike të niveleve të ndryshme të tensionit si 220/110 kV dhe në nivelin e tensionit të mesëm 35/10(20) kV.

Duhet theksuar se në nivelin e tensionit 400 dhe 220 kV nuk ka furnizim të drejtëpërdrejtë të konsumatorëve, por linjat e ketijë niveli vetëm kalojnë nëpër teritorin e komunes së Gjakovës, ndërsa që në nivelin 110kV janë këto linja :

Linja transmetuese

Tabela 22 Linjat transmetuese te energjisë elektrike me karakteristikat teknike

Linjat transmetuese 400/220/110kV	Perqesit AL/Çe	Gjatsia	
		Terr. të komunës	Totali
Linjat transmnetuese ajrore 400 kV.			
Linja nr L408 NS Kosova B-NS Koman.	2x3x490/65mm2	29.145	91.2
Linjat transmnetuese ajrore 220 kV.			
Linja nr 2303 NS Prizreni 2-NS Fierza	3x360/57mm2	33.02	45.05
Linjat 110 kV që kalojnë nëpër komunën e Gjakovës janë :			
Linja nr. 164/2 NS Prizreni 2 - NS Gjakova 1.	3x150/25mm2	9.1	29.04
Linja nr. 1805 NS Prizreni 2 - NS Gjakova 1.	3x240/40mm2	8.6	24.30
Linja nr. 164/1 NS Gjakova 1 - NS Gjakova 2.		4.98	4.98
Linja nr. 126/1 NS Gjakova 1 - NS Deçani.		8.5	20.24
Linja nr. 1806/1 NS Gjakova 1 - NS Gjakova 2		8.95	8.95
Linja kV nr. 1806/2 NS Gjakova 1 - NS Klina.		10.35	33.93

Me qellim të garantimit të sigurte të furnizimit për konsumin të Gjakovës dhe rrethinës, linjat furnizuese nga këta nënstacione janë realizuar si lidhje unazore ndërmjet nënstacioneve si Peja 3-Kline –Gjakova2-Gjalkova1 dhe Prizreni2, si dhe rrjeti unazor nga nënstacionet 110kV si në hartë.




Figura 10 Shtrirja e rrjetit 110 kV në qytetin e Gjakovës (linjat dhe nënstacionet)

Rrjeti distributiv KEDS-it.

Rrjeti distributiv i shtrirë në kuadër të komunës së Gjakovës është në pronësi të ndërmarjes për distributim KEDS dhe këto asete janë në nivelet e tensionit 35/10kV, 10/04 kV si dhe rrjeta e shpërndajës deri te konsumatorët shtëpiak në nivelin 0.4 kV .

Nenstacionet 35/10 kV.

NS 35/10 kV Gjakova I, ku janë të instaluar 3 transformator me $3 \times 8 = 24$ MVA.

NS 35/10 kV Gjakova III, ku janë të instaluar 2 transformatorë me $2 \times 4 = 8$ MVA.

Stabilimenti Shpërndarës Gjakova II 10(20)kV.

Në nivelin e shpërndarjes në tensionin 35 kV janë tri nënstacione. Në këto nënstacione janë të instaluar 5 transformatorë me kapacitet prej 32 MVA.

Këto nënstacione janë të ndërlidhura ndërmjet veti me linja 35 kV, të cilat janë paraqitur si me poshtë në figurën numër 33.

Linjat distributive 35 kV

Linja 35kV NS Gjakova I- NS Gjakova I.

Linja 35kV NS Gjakova I- NS Gjakova III.

Linja 35 kV NS Gjakova I- NS Rahoveci .

Linja 35 kV NS Gjakova1- NS Malisheva.

Linja 35 kV NS Gjakova 1-NS Radoniqi.



Figura 11 Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 35 kV (linjat dhe nënstacionet)

Rrjeti i shpërndarjes 10 kV

Furnizimi i rreth 94556 banorëve apo rreth 34904 konsumatorëve me energji elektrike bëhet nëpërmjet rrjetës distributive e cila menaxhohet nga KEDS-i, dhe në këtë kuadër janë të angazhuar 498 njësi transformatorike të cilët janë të vendosur nëpër lagjet dhe vendbanimet e qytetit të Gjakovës dhe fshatrave të kësaj komune.

Në vazhdim është paraqitur harta e shpërndarjes së rrjetit 10 kV fillimisht në figurën numër 34, rrjeti në tërësi, ndërsa në figurën numër 35 është paraqitur rrjeti 10 kV në qytetin e Gjakovës.




Figura 12 Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 10 kV (linjat)




Figura 13 Paraqitja e shtrirjes së rrjetit 10 kV ne qytetin e Gjakovës (linjat)

Fshatrat dhe qyteti i Gjakovës furnizohen nga dy nënstacione energjetike 35/10 kV, Gjakova I dhe nga nënstacioni 110/10(20) kV Gjakova 2, ndërsa që si nyje shërbejnë edhe nënstacionet Gjakova II, dhe Gjakova III të cilat shërbejnë si stabilimente shpërndarëse që operojnë me tension 10 kV.

Në vazhdim në tabelën numër 53 janë paraqitur të gjitha asetet energjetike –linjat energjetike transmetuese dhe ato distributive, ndërsa në tabelën 54 janë paraqitur transformatorët energjetik sipas nivelit të tensionit, numri i tyre, fuqitë, sipërfaqja e nënstacioneve, si dhe zona mbrojtëse rreth nënstacioneve.

Tabela 23 Linjat transmetuese të tensionit të lartë dhe të mesëm në komunën e Gjakovës

Linjat e tensionit të lartë	Gjatësia e linjave (km)	
Linjat energjetike transmetuese	Totale	Komuna e Gjakovës
400 kV	91.15	29.145
220 kV	45.049	33.025
110 kV	99.98	64.166
Linjat e tensionit të mesëm	Gjatësia e linjave (km)	
Linja energjetike distributive	Linjave nëntokësorë	Linjave ajrore
35 kV	6.45	9.5
10(20) kV	0.15	0.31
10 kV	53.745	322.4691
6 kV	-	6.81

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Tabela 24 Te dhënat e transformatorëve energjetik te të gjitha niveleve te tensionit ne distriktin e Gjakovës

Transformatorët energjetik				
Nënstacioni (kV/kV)	Transformator (nr.)	Fuqia (MVA)	Sipërfaqja (ha)	Zona mbrojtëse- gjerësia (m)
110/35	2	20	0.582	20
110/10(20)	2	31.5	0.975	20
35/10	5	8,4	1.16	5
10(20)/04	107	/	/	3
10/0.4	391	/	/	3
6/0.4	2	/	/	3

Në vazhdim në tabelën numër 55 janë paraqitur të dhënat për kategoritë e shpenzueseve ne amvisëri, publik dhe komercial, pastaj numerik i tyre, pjesëmarrja e tyre në konsumin e përgjithshëm, shpenzimi i energjisë se tyre, si dhe të dhënat për konsum mesatar dhe ngarkesë maksimale verore dhe dimërore.

Tabela 25 Te dhënat mbi kategoritë e shpenzueseve dhe shpenzimi dhe ngarkesa ne rrejet.

Numri i konsumatorëve / Shpenzimi sipas kategorive / Konsumi mesatar / Ngarkesa maksimale			
Kategoria e Shpenzueseve	Klient amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
Vendbanimi & Gjakovë # Total	28,616	427	5,861
Pjesëmarrja ne %	81.98	1.22	16.79
Shpenzimet sipas kategorive	Klient amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
Vendbanimi & Gjakovë # Total	11,844,397.94	127,032.96	4,732,057.67
Pjesëmarrja ne %	70.91	0.76	28.33
Sezone		Verore	Dimërore
Konsumi mesatar (MSh)		105,771.37	144,505.67
Ngarkesa (piku) maksimale (MW)		41.538	52.626

II. Shiritat mbrojtës rreth linjave elektroenergjetike

Shfrytëzimi i këtyre shiritave rregullohet me norma teknike dhe ligje, përkatësisht me ligjin Ligji Nr. 05/L-081 dhe se më tutje këto konsiderohen si zona të sigurisë dhe shërbejnë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirmbajtjen e stabilimenteve energjetike dhe pjesëve të tyre në vazhdimësi.

Qasja, aktivitet e punes, pergjegjesite dhe detyrat në keto zona jane të rregulluara dhe ndermarrja për energji konsiderohet si me qenë pronar në zonat nen dhe rreth stabilimenteve energjetike.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Bazuar nga normat që u cekën më lartlartë për këtë qëllim për linja energjetike kabllorike nëntoksore duhet të sigurohen koridore si ne vazhdim ne tabelen 74.

Tabela 26 Koridoret qe duhet te sigurohen per stabilimente energjetike –linja kabllore egzistuese dhe ndertime te reja.

Nr	Tensioni i Linjavekabllorike nëntoksore në kV	Ekzistuese (m)	Planifikuara (m)
1	2x110	16	20
2	110	12	16
3	35	8	10
4	20	5	5
5	10	5	5

Largpërquesi kur ndërtohet si linjë ajrore është e nevojshme që t'i sigurohet një shirit mbrojtës me dimensione të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela 27 Koridoret qe duhet te sigurohen per stabilimente energjetike –linjaajrore egzistuese dhe ndertime te reja.

Nr	Tensioni i Linjave Energjetike Ajrore në kV	Ekzistuese (m)	Planifikuara (m)
1	400	40	60
2	220	30	50
3	2x110	25	40
4	110	20	30
5	35	15	20
6	20	10	12
7	10	8	10

Kushtet e përgjithëshme për ndërtimin e rrjetit elektroenergjetik.

Kushtete themelore të ndërtimit dhe rindërimit të infrastruktures elektroenergjetike

Kushtet e mëposhtme janë bazë për ndërtimin e objekteve elektroenergjetike që duhet të respektohen me rastin e ndërtimit, rindërimit dhe mirembajtjes së infrastrukturës energjetike, që përshkruhen në vijim:

Para së gjithash e tërë infrastruktura energjetike e cila do të ndërtohet duhet që pa përjashtim të plotësojë parimet themelore si në vijim :

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Rrjeti, objektet dhe nënstacionet elektroenergjetike në tërësi duhet të ndërtohen në pajtim me normat dhe standarde teknike aktuale.

Asnjë nga objektet energjetike ekzistuese apo të reja të mos jetë në grupin e objekteve që shkaktojnë ndotjen dhe ndikime aktive në ambient.

Dizajnimi i stabilimenteve të reja duhet të përfshijë edhe forma të përshtatshme arkitektonike, dhe estetike ashtu që të përshtaten në ambient dhe të mos shkaktojnë efekte negative si (rrezatim elektromagnetik, zhurmë, ngrohje, zjarre, vibrime, etj).

Të gjitha pjesët metalike konstruktive të këtyre stabilimenteve të vendosura brenda objekteve dhe jashtë tyre në hapësira publike dhe tjera duhet të përtokzohen ashtu që të mos paraqesin rrezik për njerëzit, shtazët, pronën dhe të tjera, nëse këta të fundit jetojnë gjithnjë ose herë pas here në afërsi të këtyre stabilimenteve. Aplikimi i kabllave nëntokësore të linjave në nivelet 110; 20; 10; 0.4 kV do ta rrisë disa herë sigurinë e furnizimit dhe eliminon rrezikun e kontaktit me këtë tension dhe ndikimet vizuale në ambient, si dhe zvogëlimin e ndikimit të rrezatimit FEM (fushës elektromagnetike në ambient).

Që paisjet ekzistuese dhe ato të reja të garantojnë furnizim të rregullt dhe kualitativ të kënaqësor kapacitete të mjaftueshme për të furnizuar të gjithë konsumatorët pa kufizime dhe me tension 230/400 V(5±10%).

Vendosja e rrjetit të ri të infrastrukturës energjetike në traset e reja duhet të jetë aktivitet i koordinuar dhe në pajtim me planet e ndryshme komunale, gjithashtu në traset (koridoret) ekzistuese aktuale duhet të bëhet në pajtim me gjendjen e tanishme në varshmeri të kushteve aktuale dhe normave të tanishme dhe në bashkpunim me organet kompetente komunale.

Rikonstruktimi i rrjetit ekzistues duhet të bëhet në pajtim me kushtet e reja të shfrytëzimit të hapsirës dhe në bashkpunim me organet kompetente komunale, duke siguruar zgjidhje bashkëkohore dhe funksionalitet të plot të paisjeve.

Zhvillimi i rrjetit dhe objekteve elektroenergjetike duhet të realizohet në pajtim me kushtet e përgjithshme të planeve komunale dhe planeve për shfrytëzimin e hapsirës. Dhe duke pasur parasysh ndikimet e tyre reciproke, duke zbatuar norma dhe rregullore sipas standardeve për infrastrukturen përkatëse dhe rregullim të hapsirës dhe ndertimit.

Secili objekt ndërtimor i destinuar për banim apo për shërbime të përgjithshme, duhet të kenë të siguruar qasje për furnizim me energji elektrike nga rrjeti publik energjetik dhe kyqje individuale në secilin rast pa përjashtim.

Rreth objekteve energjetike të sigurohet një shirit me gjerësi të paktën 5 m për qasje me makina, për arsye të montimit, mirëmbajtjes dhe qasjes për shërbimet e zjarrfikjes, si dhe rrugët për kalim të këmbësorëve dhe mjeteve.

Nënstacionet 110/kV

Për ndërtimin e nënstacionit të këtij lloji duhet të sigurohet një parcele me dimensione të përafërta 100 x 60 m, dhe rreth se ciles duhet të sigurohet shiriti mbrojtës rreth e për qark, në mënyrë që të sigurohet qasje e pa penguar për transport dhe emergjenca eventuale. Përmasat definitive të parcelës duke përfshirë edhe shiritin mbrojtës rrethues, do të përcaktohet nga kërkesat e ndërmarrjes përkatëse energjetike, llojit të stabilimenteve, kërkesave për shfrytzim etj, dhe në koordinim me organet komunale përkatëse.

Objekti i nënstacioneve duhet të jetë i ndërtuar nga materialet e forta ndërtimore si panele sendviqe, tjegullat dhe blloqet nga armir-betonet, si dhe struktura metalike horizontale dhe vertikale me fundamente betoni, si dhe nga materialet termo dhe hidroizoluese(objektet).

Objekteve ndërtimore energjetike përkatëse (ndërtesave) duhet të ju sigurohet kyqja në rrjetin e ujësjellesit, ngrohjes dhe kanalizimit.

Te gjitha ruget për qasje nga dhe deri te objektet(ndërtesa) energjetik, qofshin për kembësor apo makinave të ndërtohen prej betonit, asfaltit etj.

Rethojat e objekteve energjetike-nënstacioneve duhet të rrethohen me rrethoja standarde estetike të destinuar për këto objekte, dyert dhe portat hyrëse me qasje nga rrugët publike. Nuk guxojn të hapen jashtë vijës rregulluese, dhe lartësia e tyre minimale është 2m.

Te gjitha hapësirat e pa shfrytzuara dhe te pa ndërtuara në dhe rreth nënstacioneve duhet të gjelbrohen me kultura bimore, me gjelbërim i cili nuk lejohet të rritet me shumë se sa e lejojnë normat.

Nënstacionet 10(20)/0.4 kV

Me rastin e ndërtimit të nënstacioneve të tensionit 10(20)/0.4kV, dhe gjatë përcaktimit të lokacionit për NS duhet të merren në konsiderat rekomandimet si në vijim :

Lokacioni i përcaktuar të jetë sa më afër ose edhe në qender të konsumit (shpenzuesëve), dhe aty ku është e mundur ndërtimi dhe qasja të jetë në hapsirë publike.

Që linjat kyçëse të jenë sa më të shkurtra, dhe shpërndarja e linjave të jetë sa më e thjeshtë dhe pa komplikime (improvizime) pa gërshtime të pa nevojshme.

Të këtë mundsi të qasjes sa më të lehtë për montim, riparim dhe mirëmbajtje të paisjeve,të instaluar.

Ti kushtohet kujdes rreziqeve eventuale të mundshme, cilësit gjeologjike të tokës si dhe kujdesi që të mos shkaktohet ndotja e ujrave nëntoksore dhe sipërfaqësore.

Vëndosja e nënstacioneve të bëhet duke marrë parasysh pozicionin e instalimeve tjera sipërfaqësore dhe nëntoksore në vendin dhe rrethin ku montohet.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Që të akomodohet edhe në aspektin estetik në piesazhin e zonës, dhe të këtë ndikim minimal në ambient.

Largësia e nënstacionit nga objekti fqinje duhet të jetë minimalisht 3m nëse nuk ka kufizime tjera nga rregullat urbanistike.

Nëse nënstacioni ndërtohet në brendi të objekteve për banim kolektiv, atëherë i njëjti duhet ti plotësoj të gjitha kushtet e rregullores për vendosje të nënstacioneve mbrenda objekteve.

Nënstacionet ekzistuese mbesin, por edhe mund të zëvendësohen me nënstacione të ri tipike që vendosen në të njëjtin vend ose në afërsi të atyre ekzistues, në objektet banesore dhe veprimtari shoqërore, duhet të jenë në objekte të veqanta të vendosura në afërsi të atyre objekteve, ndersa në veprimtarit punuese mund të vendosen edhe në kuadër të objektit.

Linjat Energjetike Ajrore –Largëperqesit.

Gjatë ndërtimit të infrastrukturës-linjave energjetike duhet të merren parasysh kushtet e mëposhtme :

Për ndërtimin e linjave energjetike, ndërmarrjet energjetike duhet t'u përmbahen rekomandimeve dhe rregulloreve teknike, edhe kur ato kalojnë nëpër territore të komunave, ato duhet ti njoftojnë, dhe të kërkojnë pëlqime nga organet kompetente komunale, ashtu që shiritat mbrojtës për linja të mos bien ndesh me infrastrukturën ekzistuese si dhe harmonizimin me planet komunale të asaj komune.

Rikonstruktimi i infrastrukturës energjetike duhet te bëhet duke shfrytëzuar korridoret ekzistuese dhe ne pajtim me rregulloren teknike, gjithnjë ku kjo është e mundur.

Shfrytëzimi dhe rregullimi i hapësirës mbrenda shiritave (korridoreve) të mbrojtura të linjave duhet të jetë në pajtim me udhëzimet e posaçme teknike, dhe kushteve të organeve përgjegjëse ose personave juridik të autorizuar.

Përcaktimi i traseve për linjat elektroenergjetike duhet te mos rrezikojn objektet aktuale dhe ato te planifikuara, dhe përmbajtjeve tjera te shfrytëzimit te tokës dhe hapsires urbane.

Sipërfaqja toksore dhe hapësira e ndërtimit duhet te shfrytëzohet racionalisht, duke respektuar normat, dhe duke mos penguar objektet e infrastruktures tjeter.

Hapësira nën largpërçues në parim nuk është e dedikuar për ndërtim të objekteve ndërtimore për banim, rekonstruktim të objekteve banesore, rritje të bimëve të larta etj.

Në rast e rindërtimit të objekteve ndërtimore banesore – kur rritet lartësia e këtyre objekteve kjo duhet te bëhet ne pajtim me normat dhe standardet teknike ashtu qe te mos cenohet korridori i linjave.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Distanca minimale e shtyllës elektrike nga lumenjtë lundruese apo kanaleve në kryqezim ose paralel duhet të jetë 14m, apo sipas kushteve të caktuara nga ndërmarrja kompetente e ujërave.

Kyçja e linjave 110 kV në nënstationin përkatës, duhet të jetë minimalishe e dyanshme, kjo për arsye të sigurisë së furnizimit. Traset e këtyre linjave duhet të jenë në pajtim me planet përkatëse komunale (rregullues, urbanistike, etj.), ndërsa traseja përfundimtare do të përcaktohet me projektin detal rregullativ të saj.

Linjat Energjetike Nëntoksore –Kabllovike.

Rrjeti ekzistues kabllovik mbetet, ndërsa rrjeti i ri duhet të ndërtohet kryesisht si rrjet kabllovik me vendosjen e tipeve të reja të kabllove XHP dhe rrjeti i rindërtuar duhet të jetë unazor me mundësi të plotësimit të kriterit (n-1).

Kabllo të tensionit të lartë 110 kV e më lart, duhet të ndërtohen në trase përgjatë rrugëve në pjesët e tyre ku frekuenca e transportit është më e vogël dhe duke shmangur këmbët e urave, trotuarët etj .

Rrjeti kabllovik 10(20) kV duhet të ndërtohet unazor, me unaza të hapura, ashtu që në rast të dështimit të mund të bëhet kompenzimi nga një linjë tjetër. Gjatë ndërtimit të një linje energjetike kabllore nëse kryqëzohet apo edhe ndërtohet në afërsi të infrastrukturës tjetër, atëherë duhet të respektohen normat mbi distancat përkatëse, ashtu që të mos manifestohen ndikime tjera negative.

Linjat kabllovike mund të shtrihen si të lire direkt në kanale nëntoksore apo edhe në gypa dhe në kanale ndërsa numri dhe dimensionet e gypave fleksibil të vendosur në kanalizim kabllovik përcaktohet në varësi nga nevoja dhe definohet në projektin detal – zbatues.

Në të gjitha rrugët e asfaltuara, e posaçërisht në zona urbane në njërin anë të trotuarit, duhet rezervuar për ndërtimin e kanalit kabllovik për shtrirjen e linjave dhe instalimeve tjera.

Ndërtimi mbi kanalet kabllovike të linjave është i ndaluar, përjashtimisht është i lejuar ndërtimi i parkingjeve, terreneve sportive, infrastrukturës së ulët por duke siguruar qasje të lirë për hapjen e kanaleve të njëjtëve.

Në vendet ku linja ajrore kalon në kabllovike, duhet të sigurohet hapësira për rreth shtyllës për vendosje të pajisjeve të TL me qasje të pa penguar në pajtim me rregulloret teknike.

Thellsia e shtrirje së kabllove duhet të jetë jo më e vogël se 1.1m për linjat e tensioni 20 kV ndërsa 0.7 m për rrjetin e TU.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Linjat energjetike kabllore nuk lejohet të vendosen më se paku 1m nga themeli i objektit, 1m nga auto rrugët etj, aty ku është e mundur të shtrihen në hapsra të gjelberta dhe në distancë 2m nga rrendi i drunjeve.

Linjat nëntoksore mund të shtrihen nën trotuar në thellesin prej 1.1m në distance 0.5 m nga vija rregulluese, në hapsirën për gjelbrim apo në pjesen trotuareve rrugore në thellesi prej 0.8m apo edhe profilet rrugore në thellesi deri në 1m.

Në koridoret e rrugëve shtetërore, kabllo të shtrihen paralel me këto rrugë duhet të shtrihen minimalisht 3m nga pika e skajshme e profilit rrugor sipas rregullores së ndërmarrjes për menaxhimin e rrugëve.

Thellësia minimale e shtrirjes së kabllove në tuba mbrojtës (kryqzime me rrugen) duhet të jetë 1m e matur nga pika më e lartë e rrugës, dhe pikës më të lartë të tubit.

Nëse në të njëjtin kanal vendosen instalime publike të llojeve të ndryshme, duhet të respektohen distancat teknike ndërmjet instalimeve të ndryshme.

Nuk lejohet shtrirja e kabllove energjetike mbi gypat e ujësjellësit dhe në gypat e kanalizimit.

Rrjeti i Shpërndarës i Tensionit të Lartë 400/220V

Gjatësia më e madhe e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike është në këtë nivel, pasi që rrjeti është i shpërndarë deri të secili konsumatorë.

Në varësi nga numri dhe shpërndarja e konsumatorëve, këto rrjeta ndërtohen si ajrore, kabllovike (nëntokësore) apo edhe kombinim i këtyre dy formave.

Rrjeti i tensionit të ulët ndërtohet duke marr në konsideratë kushte si më poshtë:

Kyçje në rrjetin e shpërndarjes duhet ti mundësohet secilit konsumator pa përjashtim, dhe secili duhet ti plotësoj kushtet për kyçje në bazë të rregullave të percaktuara nga operatori i shpërndarjes.

Për ndërtimin e rrjetit kabllor të tensionit të ulët aplikohen kriteret e njëjta si për rrjetin e TM të cilin e trajtuam më lartë, por në pjesët periferike të përfshira në zonën e planifikimit urban rrjeti mund të jetë edhe ajrore –në pjesët ku shtëpitë janë të shpërndara.

Ndërtimi i rrjetit të tensionit të ulët 0.4kV në pjesën e planifikuar urbane dhe rurale, duhet të realizohet duke përdorur kabllo standarde XHP varësisht nga vendi dhe mënyra e shtrirjes kabllovike/ajrore.

Rrjeti duhet të planifikohet si rrjetë trefazore radiale për arsye të shpërndarjes së shpenzuesëve sipas trafo regjioneve dhe duhet që secili grup i shpenzuesëve të analizohet se si ndikon në shpërndarjen e tërësishme brenda atij trafo regjioni dhe më gjerë.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Rrjeti i TU i ndërtuar me kablllo ajrore të tipit bistek (tufe) vendoset në shtylla nga betoni i armiruar, por kjo duhet të realizohet duke aprovuar projekte sipas një plani strategjik dhe jo si rrjet ad-hock, sepse shkakton degradimin e hapësirave dhe pamundëson realizimin e këtij plani, gjithashtu edhe vendosja e paisjeve duhet të implemntohet duke shikuar edhe anët estetike dhe ndikimeve në ambientin e zonës.

Furnizimi bëhet në mënyrë të drejtpërdrejte nga NS deri në kuadrin e banesave, ndërsa për dalje ajrore duhet të nxjerrën dalje deri në shtyllën e parë nga NS.

Daljeve ajrore duhet të ju sigurohen nga një fije rezerve për raste avarie.

Të gjitha kabllot në fillim dhe mbarim të tyre duhet të kenë lëshuese katodik përkatës për secilin nivel të tensionit.

Nga NS që do të ndërtohen duhet ti kenë dalje të mjaftueshme (varësisht nga fuqia) në anën e tensionit të ulët.

Mbrojtja nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra sigurohet duke vendosur siguresa në fillim të rrjetit në pajtim me kërkesat teknike.

Mbrojtja nga tensioni i rrezikshëm i prekjes duhet të bëhet sipas sistemit TN-C deri te vendi i kyçje së kabllit të TU në objekt. Duhet ti kushtohet kujdes mbrojtjes nga zjarri gjatë montimit të rrjetit, kjo sidomos në hapësirat e destinimeve të veçanta dhe atyre publike. Në objekte të banimit kolektiv të sigurohen mjete për shuarjen e zjarrit

Investitori është i obliguar që ta siguroj dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit dhe të siguroj mbikëqyrjen profesionale të punimeve dhe paraqitjen e kërkesës për shfrytëzim te objektit.

Infrastruktura e ujësjellësit

Rrjeti i Ujësjellësit

▪ Kushtet zhvillimore për rritjen e resurseve të ujit

Kushtet zhvillimore të përcaktuara për rritjen e resurseve të ujit bazohen në Udhëzimin Administrativ për Hartën Zonale.

Më tej këto dokumente përcaktojnë kushte dhe sigurojnë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës dhe kornizën institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Në Planin Zhvillimor Komunal 2022 - 2030 janë përcaktuar sipërfaqet (Pikat) dhe hapat e nevojshëm për rritjen e resurseve të ujit për komunën e Gjakovës.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Kjo nënkupton që për përmbushjen e nevojave për furnizim me ujë të popullsisë dhe ekonomisë së komunës së Gjakovës do të nevojiten burime të reja dhe rritje të kapaciteteve të ujit dhe rezervuareve të konsiderueshme në zonat rurale.

Për mbulimin e këtyre nevojave janë planifikuar zhvillimi i resurseve të reja ujore si vijon:

- Ngritja e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm dhe rritja e vëllimit të rezervuareve;
- Hapja e puseve të reja në disa venbanime rurale;
- Ndërtimi i stacioneve të pompave;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në gjitha vendbanimet ku nuk ka rrjet por që ka banorë të mjaftueshëm rezident apo në zonat e planifikuara në 8 vitet e ardhshme;
- Zëvendësimi i rrjeteve të vjetra me rrjete të reja apo zgjerimi i zonave me rrjet në zonat urbane dhe rurale të planifikuara sipas PZHK;
- Instalimi i ujëmatësit digjital në tërë zonën e shërbimit, ashtu që do të kishte avantazhe të ndjeshme sa i përket rënies së humbjeve të ujit si dhe rritjes së faturimit në [m³] të ujit të shpenzuar;
- Mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Krijimin e zonave dhe nënzonave për vendosjen e matëseve të ujit (DMA) për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit.

▪ **Kapaciteti**

Në planet zhvillimore sektoriale dhe PZHK –së në Gjakovës, Komuna ka bërë llogaritjen dhe analizën e shpenzimeve dhe kapacitetit të nevojshëm të ujit të pijes për banorët e zonës e cila do të jetë në harmoni me kërkesat për furnizim me ujë të pijes për të gjitha vendbanimet e Gjakovës për vitin 2022-2030.

Bazuar në kapacitetet ekzistuese të burimeve të ujit me **Q=1050 l/s** kapaciteteve të konservimit të rezervuarëve, kapacitetet e stacioneve të pompimit, numrit të prognozuar të banorëve prej për vitin **2030** të Skenari-a i PZHK, përfshirë edhe banorët jo rezident, analizës së shpenzimeve me kërkesën mesatare prej **q=250 l/për banor** Komuna nuk ka nevojë për rritje të kapaciteteve të konservimit të ujit prej së paku 8-10 vitete e ardhshme, me prejashtim të zonave rurale të pa mbuluara nga këto burime.

Mirëpo kapacitetet e projektuara të shpenzimeve (analiza e shpenzimeve) në të ardhmen duhet reflektuar edhe në ndryshimet eventuale nga propozimi i shfrytëzimit të tokës të paraqitura në Hartën Zonale të Komunës (HZK), dhe definimi i kushteve zhvillimore, duke saktësuar koeficientet dhe indekset e zonave dhe zonave mbishtrësore, për komplet territorin e komunës dhe duke prezantuar në hartën e kapaciteteve.

Komuna në HZK sipas **Planit të Veprimit** në planifikimet e reja gjate përcaktimit të prurjeve llogaritëse të ujit për shtimin e kapacitetit të ujit (në pjesën urbane, rurale dhe industriale) duhet të merret baze përdoruesit e ujit për të gjitha kategoritë e përdorimit të ujit sipas normave teknike të planifikimit hapësinor.

Me qëllim të ruajtjes së ujit të pijes dhe rritjes së kapaciteteve të ujit brenda zonës - Komunës.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Komuna e Gjakovës në planifikimet e reja (toka e shfrytëzuara për ndërtim) do të caktoj kushtet e reja zhvillimore të ndërtimit të rezervuarët grumbullues për ujë atmosferik (Ujë teknik).

Uji i grumbulluar përmes pullazeve (çatime) të ndërtesave do të dërgohet në rezervuarin e ndërtuar brenda parcelës ndërtuese i cili pastaj do shfrytëzohet për nevoja të ndryshme të qytetit dhe zones përreth si: ujitjen e parqeve, larjen e rrugëve, trotuareve, shuarjen e zjarreve apo nevojave tjera.

Poashtu bazuar në **skenarin-b** të PZHK-së nënkupton që për përmbushjen e nevojave për furnizim me ujë të popullsisë dhe ekonomisë së territorin e Gjakovë nevojitet që KRUGJ dhe Komuna duhet të orjentohej në **eliminimi e humbjeve teknike dhe komerciale** dhe mbulimin e fshatrave me furnizim me ujë në 8 vitet e ardhshme.

▪ Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit

Sa i përket rehabilitimit të sistemit të ujësjellësit, Në Planit zhvillimor Komunal (PZHK), Komuna në bashkpunim me Kompanin KRU Hidromoravën ka vlerësuar nevojat për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit dhe bazuar në këtë vlerësim ka planifikuar projektet si vijon:

Infrastruktura e dobët e ujësjellësit dhe që ka nevojë për investime të reja kryesisht në zonën Urbane:

- Zëvendësimi i të gjithë gypave kryesor (transportues) të ujësjellësit nga materiali i Azbest Cement në PE-100 RC apo HDPE-100;
- Zëvendësimi i të gjithë gypave sekondar (rrjetave) të ujësjellësit nga materiali i Azbest Cement në PE-100 RC apo HDPE-100;
- Krijimi i Zonave Matëse të reja në zonën urbane dhe në zonat rurale (Montimi i Ujëmatësve zonal);
- Hapje e puseve të reja për rritje të kapaciteti të ujit.
- Riparimi dhe ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit në zonat rurale
- Zgjerimi i rrjetit në zonat e reja të shërbimit
- Mbrojtja e zonave të burimeve të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.
- Hidrosistemi i Ibër Lepencit.

Për ndërtimin dhe zëvendësimin e rrjeteve të ujësjellësve për vendbanimin urbane (zonat) dhe rurale do të përdoren gjitha kushtet e përcaktuar në dokument si për gypa, fazoneri dhe objekte tjera përcjellëse të infrastrukturës së ujësjellësit, në mënyrë që zbatimi, implementimi apo zhvillimi i tyre të jetë me i lehtë, më i qëndrueshëm dhe më cilësor.

Gjithashtu projektet e tilla duhet të implementohen, zbatohen apo zhvillohen në përputhje me ligjet aktuale në fuqi në Republikën e Kosovës si:

- Ligji në fuqi i ndërtimit.
- Ligji në fuqi i Ujërave të Kosovës.
- Udhëzimi administrativ për mbrojtjen e zonave sanitare i cili është në fuqi dhe

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- Gjitha normat dhe standartet të cilat janë në fuqi në R. e Kosovës

Te gjitha këto do të realizohen në të ardhmen sipas kushteve të zhvillimit të projekteve dhe ndërtimit për infrastrukturën teknik të ujësjellësit.

-Në koordinim me kompaninë rajonale të ujësjellësit Komuna do të bëjë planin për shtimin e kapaciteteve prodhuese të ujit duke shfrytëzuar burimet lokale por edhe në kontekst rajonal.

Pas hartimit të Hartës Zonale të komunës së Gjakovës çdo shtrirje e rrjetit qoftë në funksion të përmbushjes së **Nevojave zhvillimore për të ardhmen të paraparë në PZHK** – ku theksohet qëllimi i plotësimit (përmirësimit) të sistemit të furnizimit me ujë për gjithë zonën, shtimit të kapaciteteve prodhuese të ujit qoftë për furnizimin me ujë të hapësirave të reja, qoftë në planifikimin e rezervuarëve të rinj, mbrojtjen e burimeve, hapjen e puseve dhe montimin e ujëmatësive zonal, duhet bëhen duke u bazuar në një **projekt ideor** dhe **projekt kryesor** dhe duhet të përgatiten nga komuna, Kompania Rajonale e Ujit “Hidroregjioni Jugor” dhe akterët tjerë të rëndësishëm si ministria përkatëse (qytetarët, bizneset, OJQ dhe hisetarët e tjerë të zonës për të cilën kryhet projekti) dhe gjitha detyrat projektuese apo kushtet e zhvillimit të projektit dhe zbatimit të tij do të jepen në dokument për kushtet e zhvillimore të projektit dhe zbatimit.

Shtrirja e rrjeteve të cilat do të planifikohen apo riparohen do të bëhet sipas normave të planifikimit hapësor, ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi dhe kodit të ndërtimit, vetëm në raste ku nuk lejohet mundësit në terren të aplikohet një rregull i tillë, apo bien ndesh me rregulla tjera të ndërtimit dhe në rastet kur zgjidhja inxhinierike ose edhe aspekti ekonomik, financiar e mjedisorë e favorizojnë një zgjidhje më të qëndrueshme në segmente të caktuara të zonës.

Shtrirja e rrjeteve brenda projektit duhet të bëhet në harmoni me kushtet për përzgjedhjen e lokacionit të cilat janë të specifikuar të kushtet zhvillimore për projektim.

- **Presioni i ujit në rrjetin e ujësjellësit**

Në kushtet e zakonshme të përdorimit të ujit, presioni hidraulik në gypin e lidhjes së konsumatorit duhet të projektohet dhe zbatohet që të jetë jo më pak se një e gjysëm (1.5) bar dhe jo më shumë se shtatë (7) bar.¹¹

- **Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit**

- Hartuesi rrjetin shpërndarës (projektuesi) duhet që gjatë hartimit dhe zbatimit të planifikojë në atë mënyrë që të shmang “mbarimet pa dalje” në gypin kryesor. Në rastet kur mbarimet pa dalje janë të pashmangshme, ofruesi i shërbimeve duhet të sigurojë hidrant për shpërlarjen me rrjedhë të vrullshme të gypit kryesor me qëllim që të mirëmbahet cilësia e duhur e ujit të pijshëm.

- Me qëllim që të mundësohet operim optimal i sistemit, valvulat në rrjetin shpërndarës duhet të planifikohen të vendosen në të gjitha degëzimet, ndërkaq në seksionet e drejta në distancë jo më të madhe se 250 metra.

¹¹ Rregullorja Nr 10-2019 ARRU

- Gjatë ndërtimeve të reja, rrjeti shpërndarës duhet hartohet që të shtrihet në një sistem rrjetë (Unazor apo grid), kështu që në rast të riparimeve në rrjet numri i konsumatorëve të cilët i nënshtrohen ndërprerjeve të ujit të mbahet në minimum.¹²

- **NDËRTESAT PËRCJELLËSE-UJËSJELLËS**

Objektet përcjellëse të ujësjellësit përfshijnë:

- **Rezervuarët,**
- **Stacioni i pompave,**
- **Stacioni i Klorifikimit,**
- **Fabrikat për përpunimin e ujit dhe**
- **Rezervuarët në formë kulle.**

- **Rezervuarët**

Janë objekte në të cilët akumulohet uji që të barazojë prurjen e ujit dhe shpenzueshmerin jo të njëtrajtshme të ujit të cilët gjatë ditës janë të ndryshueshme. Rezervuarët kanë rolin edhe ta ruajnë ujin për shuarjen e zjarrit dhe ta mirëmbajnë shtypjen në rrjetin e ujësjellësit.

- **Kushtet gjate përzgjedhjes së lokacionit të rezervuarve**

Gjate zgjidhjes së lokacionit për rezervuarin duhet të veprohet sipas kushteve si me poshtë:

- Rezervuari të gjendet me poshtë se kaptazhi që të mundësohet rrjedhja gravitacione e ujit;
- Kaptazhi dhe rezervuari sipas mundësisë duhet t'i lidh gypi prurës i shkurte;
- Në raport të konsumatorit, rezervuari duhet të ndërtohet mjaftueshëm lartë që të mundësojë rrjedhje të ujit edhe deri te vendet më të larta të konsumatorëve;
- Që të ketë ekonomizim, gypi prurës ndërmjet rezervuarit dhe konsumatorit duhet të jetë sa më i shkurtë.

Në varësi nga konfiguracioni i terrenit dhe vend pozitës së burimit të ujit në raport të vendit të shpenzimit (me shpesh vendbanim), rezervuari mundet të jetë i vendosur në vend pozita të ndryshme.

- **Vëllimi i rezervuarëve**

Vëllimi i rezervuarëve caktohet sipas mënyrës në të cilën uji derdhet në ta.

Te sistemet me gravitacione ku rezervuari ka rolin e rregulluesit të rrjedhjes, volumi është përafërsisht 1/3 nga shpenzueshmëria maksimale ditore e ujit.

Gjate krijimit artificial të shtypjes në rrjet, vëllimi i rezervuarit caktohet në varësi nga orët e punës të pompave gjate ditës dhe shpenzueshmeris maksimale ditore të ujit.

- **Rezervuarët, - Stacioni i pompave, -Stacioni i Klorifikimit, Fabrikat për përpunimin e ujit dhe Rezervuarët në formë kulle;**

Do të përcaktohen nga projektuesi dhe duhet të jete në Vendlokacionin me të përshtatshëm, materialet të cilat përdoren duhet të jenë sipas normave dhe standardeve në fuqi.

- **Kapatazhat**

¹² Rregullorja Nr 10-2019 ARRU

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Janë ndërtesa specifike për të cilat duhet kushtuar rëndësi gjatë projektimit e sidomos gjate implementimit te tyre, materialet të cilat përdoren duhet të jenë sipas normave dhe standardeve në fuqi.

▪ Objektet e kaptimit (Kapatazhat)

duhet të ndërtohen sipas kushteve teknike dhe hidroteknike të parapara me rregullore për objekte të tilla. Dimensionet e këtyre objekteve mundë të ndryshojnë nga ato të projektuara gjatë ekzekutimit varësisht prej kushteve në teren nën mbikëqyrje dhe aprovim të drejtpërdrejt të organit mbikëqyrës në konsultim me projektuesin:

Kushtet bazike të kaptimit janë:

- Vepra e marrjes duhet të bëhet sipas qendrës se banuar dhe rajoneve Industriale sipas rrjedhjes (Ku uji është me cilësi te mire).
- Lumi të ketë shtrat dhe brigje të qëndrueshme.
- Kushte Inxhiniero - Gjeologjike të përshtatshme.
- Thellësi të mjaftueshme në prani të rrymës kryesore.

▪ Paisjet përcjellese-ujësjellesi

Në pajisjet përcjellese përfshihen:

- a) Gypat;
- b) Pompat; dhe
- c) Hidrantët, Ujëmatësat Zonal dhe elemete tjera fazonerike.

▪ Gypat

Gypat e cilat duhet të instalohen në sisteme e ujësjellesit për ujë të pijshëm duhet të jenë në përputhje me standardet e cekura në tabelen e mëposhtme:

Gypat për ujë të pijës: HDPE 100 RC (9010) PAS 1075 typ 2 me SDR 17 variable (varsisht nga projektuesi dhe konfiguracioni i terrenit);

Materiali:	HDPE-100- RC
Standartet e produktit	EN 12201-1:2011 ose EN 12201-2:2011 dhe DIN 8074:2011-12 ose DIN 8075:2011-12
Standartet e instalimit	PAS 1075:2009-03- TIPI 2
Certifikatat ISO:	Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2004 per prodhimin e gypave PE dhe Sistemi i Menaxhimit Kualitativ ISO 9001:2008 apo 2015 per prodhimin e gypave PE-100
Miraturar nga:	DVGW, WRAS,SVGW apo ndonjë organ tjerë miratues i ngjashëm.

▪ Pompat

Vendlokacioni i pompave (stacioni i pompave) duhet të jene të projektuar ne vende me te pershtatshme dhe sipas normave dhe standarteve per paisje të tilla. Për llogaritje duhet shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi.

▪ Hidrantët

▪ **Pjesët Fazonerike**

Te gjitha pjeset fazonerike ,Valvolat, Flanqet, Kthesat, Redukuesit, Teleskopët, Montuesit Demontuesit etj luajn rolë të rëndësishëm në sistemet e furnizimit me ujë, secila nga to ka rolin dhe specifikime të tyre në vetë, shfrytëzohen për kalimin prej gypave në pjesë të veçantë, gjatë ndryshimit të diametrit të gypave, atje ku gypi mbaron, ku gypi degëzohet, gjatë ndryshimit të drejtimit, ndryshimit të mënyrës së lidhjes etj.

Andaj gjatë projektimit hartuesi i projektit duhet t'i kushtoj rëndësi të veçantë dhe duhet të jetë i kujdesëshëm gjatë specifikimit të elementeve fazonerike dhe nyjeve (pusetave) të madhësisë së nevojshme të cilat mundësojnë manipulim dhe mirembajtje të mjaftueshme me elementet fazonerike të instaluar në të.

-Te gjitha pjeset fazonerike para montimit duhet t'i kenë atestet ISO 9001:2015 të prodhuesit.

-Kualiteti duhet t'i pergjigjet cilësisë GGG40 apo GGG 50 -DIN1693 dhe gjitha fazonerit tjera duhet të jenë në përputhje me cilesin sipas standardit ISO apo DIN.

▪ **Kushtet e vendosjes së gypave dhe elementeve fazonerike në rrjet të ujë sjellësit**

Kushtet për hartimin dhe ndërtimin të projekteve të ujësjellësëve :

- Gypat e ujësjellësit duhet të trasohen në njërin nga skajet e rruges apo njerin nga trotuarët e rruges.
- Thellësia minimale e vendosjes së gypave duhet të jetë 1.0 m nga pjesa e sipërme e gypit;
- Gjersia e kanalit mirret nga normativa duke ju referuar normave teknike për gjerësinë të kanalit të ujësjellësit;
- Diametri i gypave përcaktohet me logari hidraulike, varësisht nga numri i banoreve të cilet jetojnë në atë zonë (Koeficienti i ndërtimit dhe destinimit të paraparë);
- Në pjesët urbane duhet të kemi në çdo 500 m nga një hidrant;
- Valvolat e ajrit duhet të vendosen edhe në terene të rrafshta (përveq në pikat e larta) dhe në distanca për diametra nga Ø50-315 mm në çdo 700-1000m dhe për diametra >315mm në çdo 700-1500m;
- Valvolat Kontrolluese për gypa transportues duhet të vendosen në çdo 500m;
- Në çdo hyrje të zonës duhet të parashihet ujëmatës zonal dhe të jetë sipas standartëve të përcaktuar në vizatimin më sipër.
- **Ndarja në mes të gypave të ujësjellësit dhe kanalizimit**
 - Kur rrjeti i ujësjellësit dhe rrjeti i kanalizimit janë afër njëri tjetrit, hartuesi dhe zbatuesi i projektit duhet të planifikoj gypat e kanalizimit më poshtë se gypat e ujësjellësit.
 - Distanca horizontale në mes të gypave të ujësjellësit dhe gypave të kanalizimit duhet të jetë së paku njëqind (100) centimetra, matur nga pikat më të afërta të mureve të jashtme ndërmjet këtyre dy gypave.
 - Nuk është e lejueshme që gypat e ujësjellësit të kalojnë nëpër puseta të kanalizimit. Gypat e ujësjellësit duhet të vendosen së paku njëqind (100) centimetra larg pusetave të kanalizimit, matur nga pikat më të afërta të mureve të jashtme ndërmjet gypave të ujësjellësit dhe pusetave të kanalizimit.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- Distanca vertikale në mes të gypave të ujës jellësit dhe kanalizimit duhet të jetë pesëdhjetë (50) centimetra, matur nga pikat më të afërta të mureve të jashtme ndërmjet këtyre dy gypave.¹³




Figura 15. Detali i vendosjes së gypave të ujit dhe kanalizimit në një kanal në zona urbane dhe rurale, në riparimin e infrastrukturës së vjetër dhe investime të reja.

▪ **Lokacioni i vendosjes së matësit**

- Në të gjitha burimet e ujit të cilat pas procesit të përpunimit shfrytëzohen për furnizimin me ujë të popullatës, duhet të instalohen matës të ujit të përpunuar, i cili duhet të vendoset **në dalje të impiantit të përpunimit të ujit**. Rekomandohet që impianti të këtë një dalje të ujit të përpunuar, por nëse për shkaqe teknike ka disa, atëherë në secilën dalje duhet të këtë nga një matës të ujit të përpunuar.
- Në rastet kur shfrytëzon edhe sisteme të veçanta të furnizimit me ujë, lokacioni i matësit duhet të vendoset si në vijim :
 - **Rasti I: Sistemi i furnizimit me ujë nga burimet malore**

¹³ Rregullorja NR 10-2019 ARRU

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Në rastet kur uji merret nga burimet malore, dhe aty pranë bëhet klorinimi, matësi vendoset menjëherë pas pikës dozuese të klorit.

- **Rasti II: Sistemi i furnizimit me ujë nga burimet malore përmes rezervuarit.**
Në rastet kur uji merret nga burimet malore dhe nga kjo pikë dërgohet në rezervuarin distributiv ku bëhet klorinimi i ujit, matësi vendoset në dalje të rezervuarit.
- **Rasti III: Sistemi i furnizimit me ujë nga pusët**
Në rastet kur uji merret nga pusët dhe përmes pompave shpërndahet në rrjetin distributiv, ndërsa dozimi i klorit bëhet në afërsi të pompave, ujëmatësi vendoset në dalje të pompave.
- **Rasti IV: Sistemi i furnizimit me ujë me puse përmes rezervuarit**
Në rastet kur uji merret nga pusët dhe përmes pompave dërgohet në rezervuarin distributiv ku edhe bëhet klorinimi, matësi vendoset në dalje të rezervuarit.¹⁴

Rrjeti i Kanalizimit

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimorë Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban të Gjakovës por edhe duke marr parasysh gjendjen ekzistuese të sistemit të kanalizimeve, HZK-së në udhezimin administrativ ka parashikuar planifikimin e infrastrukturës teknike si: Kapacitetin dhe shtrirjen e rrjetit, ndertesat percjellese, shiritat mbrojtës dhe paisjet për rrjetin e ujësjellesit, kanalizimit, impiantet për trajtimin e ujerave te zeza dhe drenazhimit. Sipas Ligjit të ujëra Nr 04/L-147 të gjithë shfrytëzuesit e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, janë të obliguar që gjatë shkarkimi të ujërave të shfrytëzuara, të mos shkaktojnë veprime të dëmshme në mjedisin rrethues dhe sferat tjera të mjedisit.

▪ **Kapaciteti**

Gjatësia totale e sistemit ekzistues të kanalizimeve në Gjakovë është rreth 56 km. Diametrat e gypave janë midis DN 200 dhe DN 600, dhe materiali kryesor i gypave është azbest çimentoja (> 80 %, kryesisht diametrat më të vegjël). Material tjetër i gypave është qeramika dhe gypat e plastikës. Moshë mesatare e rrjetit është rreth 40 vjet.

Vlen të theksohet se përafërsisht 80% e banorëve që jetojnë në qytet, ujërat fekale i derdhen në rrjetin e kanalizimit fekal publik.

Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha. Njohuria e sistemit të kanalizimeve në të kaluarën kryesisht u mbajt nga operatorët e sistemit shumica e të cilëve nuk janë më në dispozicion për të ndihmuar me detajet e vendndodhjes së sistemit apo funksionimit të tij. Prandaj, informacioni është jo i plotë dhe duhet bërë shumë punë për të rimarrë atë njohuri. Sistemi i kolektorëve lokal sekondar dhe kyçjeve të konsumatorëve nuk është planifikuar të rehabilitohet ose zëvendësohet në asnjë prej nismave të financuara nga donatorët aktualisht. Është planifikuar vetëm rehabilitimi dhe zëvendësimi i kolektorëve kryesor të ujërave sanitare I dhe II.

¹⁴ Rregullorja NR 10-2019 ARR.U

Në qytetin e Gjakovës ekziston rrjeti për largimin e ujërave të shiut në kuptimin e një sistemi të dizajnuar dhe të ndërtuar në parimet dhe normat inxhinierike, por i cili nuk mirëmbahet rregullisht dhe në mënyre ilegale në shumë pjesë janë kyçur kanalizimet e ujërave fekale. Përveç në qendrën e ngushtë të qytetit ku ekziston sistemi gypor i kanalizimit të shiut, në disa pjesët të qytetit ekzistojnë kanale të hapura, ose në rastet më të shpeshta ujërat e shiut vërshojnë rrugët dhe pronat e qytetarëve pas çdo reshje. Sistemi i kanalizimit është i tipit të ndarë, me gypa që janë me dimensione dhe materiale të ndryshme siç janë betoni, azbesti dhe PVC.

Ndërtimi i kanalizimit atmosferik, ka filluar më vonë se ndërtimi i kanalizimit fekale për arsye se qyteti i Gjakovës, ka pasur dhe ende ka shumë kanale të hapura të cilat janë shfrytëzuar për bartjen e ujërave atmosferik. Rrjeti i kanalizimit atmosferik i gjithi është i orientuar në drejtim të lumenjve dhe derdhet në shumë pika pa trajtim adekuat.

- Ujërat atmosferike në pjesën urbane të qytetit shkarkohen në të njëjtin kolektor me ujërat e zeza ; dhe
- Ujërat Industriale shkarkohen pa trajtim paraprak në kolektorin e ujëra ve të zeza apo atmosferike.
- **Shtrirja e rrjetit të kanalizimit**

Në planet zhvillimore Sektoriale dhe në Planit Zhvillimore Komunal (PZHK) janë identifikuar disa prioritete në ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave te zeza dhe Impiante për trajtimin e ujërave të tilla, për të cilat do të duhet të caktohen edhe kushtet e zhvillimit në mënyre që zhvillimi i tyre të jetë më i lehtë dhe më cilësore dhe duhet të jetë në përputhje me Direktivat e BE së.

Në Planin Zhvillimor Komunal, në planin e veprimit është planifikuar zëvendësimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në pjesën Urbane dhe Vendbanimet si:

- Përfundimi impiantit dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Gjakoves;
- Kyçja e të gjitha rrjeteve të kanalizimit në kuadër të kolektorëve;
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjeteve të reja dhe atyre ekzistuese;
- Zgjerimi i shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferik.

Pas hartimit të Hartës Zonale të komunës së Gjakovës çdo shtrirje e rrjetit qoftë në funksion të përmbushjes së **planit të Veprimit**- ku theksohet Zëvendësimi i rrjetit të kanalizimit, ndërtimi i kolektorëve dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, duhet bëhet një projekt ideor dhe kryesor,projekti duhet të përgatitet nga komuna dhe kompania Rajonale e Ujit “Gjakova” dhe akterët tjerë të rëndësishëm (qytetarët, bizneset, OJQ dhe hisetarët e tjerë të zonës për të cilën kryhet projekti), projektet të cilat hartohen duhet të jenë në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, normat teknike, dhe direktivat e BE-se dhe materialet të cilat përdoren duhet të jene ne përputhje me standardet DIN apo ISO.

Shtrirja e rrjeteve te cilat do te riparohen do te behet sipas normave te planifikimit hapësinor, ligjeve dhe udhëzime ne fuqi, vetëm ne raste ku nuk lejojnë mundësit ne teren te aplikohet një rregull i tille,

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

apo bien ndesh me rregulla tjera dhe në rastet kur zgjidhja inxhinierike ose edhe aspekti ekonomik,financiar e mjedisorë e favorizojnë një zgjidhje më të qëndrueshme në segmente të caktuara të zonës.

Shtirja e rrjeteve brenda projektit duhet të bëhet në harmoni me kushtet për përzgjedhjen e lokacionit të cilat janë të specifikuara të kushtet zhvillimore PR projektim.

Gjatë hartimit të projekteve kryesor duhet të paraqitet me kujdes detalet e pushtave dhe materialeve të përdorura.

Gjithashtu ashtu siç parashihet në PZHK, në HZK është parapare edhe zëvendësimi i rrjetit ekzistues në disa pjesë të qytetit të Gjakovës .

Dhe me këtë duhet të ndahen ujërat e zeza dhe Industriale nga ato atmosferike (drenazhimit), të trasohet rrjeti i ndare në mënyrë që trajtimi i tyre të bëhet veçantë dhe objektet për pastrimin e këtyre ujërave të dimensionohen me dimensione reale, trajtimi i tyre të jetë real dhe shfrytëzimi të jetë racional me destinacione sipas nevojave të qytetareve.

Gjatë projektimit hartuesi i projekteve duhet t'i ketë parasysh edhe zgjidhjen e sistemit të kanalizimit-sipas ndarjes.

Gjatë hartimit të projekteve të kanalizimëve brenda ndërtesave, objekteve (shtëpive) individual, objekteve industriale, institucionale etj komunat janë të obliguara , sipas ligjeve, udhëzimeve, direktivave dhe standarteve ndërkombetare të bëjnë ndarjen dhe integrimin e ujërave

- Ujërat në nyjet sanitare që vijnë nga tushet, lavamanet, lavatriqet dhe kuzhinat të trajtohen në formë të veçantë të grumbullimit dhe lagimit të tyre për në impiante trajtimi sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi;
- Ujërat që vijnë nga klozetat të trajtohen në formën e veçantë të grumbullimit dhe lagimit të tyre për në impiante trajtimi sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.
- Ujërat që vijnë nga qatitë e objekteve të trajtohen në formë të veçantë të grumbullimit dhe largimit të tyre nga objekti dhe të kenë mundësi të kthimit dhe shfrytëzimit të tyre për nevojat e përdorimit nëpër klozetat dhe forma të ndryshme të përdorimit brenda nyjeve sanitare të objekteve të ndryshme si dhe mundësia e ujitjen e kopshteve, pastrimin e trotuareve apo rrugëve;
- Komuna, konkretisht drejtorit që leshojnë leje për ndërtimin e objekteve të lartcekura brenda teritorit të komunës duhet t'i obligojnë Investitorët privat dhe Institucional (përmes rregulloreve të brendshme apo duke u thirrur në ligjet dhe udhëzimet për plotësimin kritereve përkatëse, gjatë hartimit të projekteve të mos leshohen lejet ndërtimore për gjitha

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

kategorit e objekteve pa u shiquar te gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative dhe plotësuar standardet dhe direktivat e BE-së.

- Te gjitha objektet industrial te vogla dhe te medha ne teritorin e komunes jane te obliguar qe brenda parcelave perkatese te bejn ndarjen e ujerave te ndotura me ato atmosferike dhe se jane te obliguara qe trajtimin e ujerave ta bejn brenda parces apo pozitë të pershtatshme në harmoni me lejet komunale dhe Ministrisë sipas direktivave te BE-se dhe ligjeve te R. Kosoves para shkarkimit ne kolektor apo recipient.¹⁵

▪ Rrjeti i ndarë

Duhet të trasohen dy rrjeta të kanalizimit paralele: Në mënyrë që në njërin anë të rrjedhin ujërat e zeza dhe industriale deri te stacioni për pastrim dhe pastaj lëshohen ne recipient dhe rrjeti i dytë (atmosferik), më i cekët i cili ndërtohet nën nivelin e rrugës dhe i përcjell ujërat atmosferik deri te pranuesi (recipienti) , pa pastrim. Edhe për arsyeje se ndërtohen dy rrjeta të kanalizimit, kjo mënyra ka përparësi të shumta: stacioni për pastrim ka dimensione më të vogla; rrjetat mund të ndërtohen në etapa (fillimisht për ujërat e zeza); janë të nevojshme investime fillestare më të vogla etj.

▪ Sistemi i gjysme i ndarë

Rrjeti gjysmë-ndarës i largon ujërat e zeza dhe industriale në një rrjet të kanalizimit kurse ato atmosferike në tjetër. Ndërmjet këtyre dy rrjetave ekziston pika e përbashkët në lloj të shahtës kapërderdhese (Ower flow chamber).

Në Gjakovë ne ndertimet apo zonat e reja duhet te aplikohen sistemi i ndar i kanalizimeve dhe ne zonat (ekzistuese) sistemi gjysem i ndarë.

Në HZK do të paraqiten kushtet e nevojshme dhe të domosdoshme për zhvillimin e projekteve të kanalizimit dhe objekteve tjera përcjellëse të bazuara ne Raportet Sektoriale dhe Planet Zhvillimore Komunale (PZHK).

▪ Ndërtesat përcjellëse-kanalizimi

Objektet përcjellëse përfshijnë:

- Pusetat kontrolluese;
- Objektet për ndarjen e kanalizimeve te përbashkëta (Ower Flow Chamber);
- Stacioni i pompave;
- Fabrikat për trajtimin e ujerave te zeza (impiantet).

▪ Pusetat Kontrolluese

Për te kontrolluar funksionimin e rrjetit te kanalizimit si dhe për te pastruar e mirëmbajtur tubat, ndërtohen puseta kontrolluese. Si ne pjesën urbane ashtu edhe atë rurale ne sistemet e vjetra zakonisht nuk janë aplikuar rregullat e vendosjes se pusetave te kontrollit sipas normave teknike te projektimit.

¹⁵ INSI

Gjate planifikimeve dhe hartimit të projekteve të reja Komuna duhet zbatuar me përpikëri kushtet e projektimit dhe ndërtimit (zbatimit) të pusetave kontrolluese. Te gjitha materialet të cilat përdoren për ndërtimin e pusetave duhet të jenë me standarde të larta dhe sipas ligjeve aktuale në fuqi.

Objektet për ndarjen e kanalizimeve të përbashkëta-përzieria (Owerflow Chamber);

Janë objekte konstruksioni të cilat aplikohen të kanalizimet e përbashkëta-përzieria, zakonisht aplikohen në zona urbane ku nuk mund të bëhen ndarja e veçantë e tubave atmosferik dhe ujërave të zeza brenda një zone të caktuar.

Praktikohen të zbatohen në zona afër lumenjëve apo kanaleve të mbyllura.




Figura 16 Puset për ndarjen e ujërave të përzieria (Owerflow Chamber)

▪ Stacioni i pompave

Vend lokacioni i pompave (stacioni i pompave) duhet të jete të projektuar në vende me të përshtatshme dhe sipas normave dhe standardeve për pajisje të tilla. Për llogaritje duhet shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi.

▪ Impiantet industriale

Autoriteti mjedisor duhet gjithmonë të kërkojë nga bizneset e mëdha, në veçanti ato që prodhojnë sasi të mëdha të ujërave të zeza, ujëra të zeza me koncentrim të lartë të ndotësve ose lëndëve ushqimore dhe mbeturinave të rrezikshme të lëngëta që të sigurojnë objektet e veta për impiantet për trajtim, të cilat që kontrollohen rregullisht nga institucionet e pavarura. Në sajë të natyrës bujqësore të ekonomisë vendore në Gjakovë, fukusi bie vetëm në sistemet për trajtimin e ujërave të zeza komunale (amvisërisë), të cilat mund të konsiderohet si burim kryesor të ujërave të zeza.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Impiantet industriale të përbëra nga më shumë halla punuese dhe ndërtesa administrative (ekonomi të bujqësisë), duhet të kenë rrjetin e vetë vetanak të oborrit prej gypave, pusetave kontrolluese dhe stacionin pastrues.

▪ **Ndarja e ujërave të ndotura**

- Ujërat e ndotura shtëpiake;
- Ujërat e ndotura nga sektorë të ndryshëm industrial;
- Ujërat e përziera/urbane (të cilat mund të jenë ujëra të ndotura shtëpiake, ose përzierje e ujërave shtëpiake dhe industriale dhe/ose ujëra atmosferikë/drenazhës).¹⁶

▪ **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit janë**

Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të ndotura, duhet të planifikohet në lokacionet, si në vijim:

- Në parcela kadastrale zhvillimore mesatare nga 5- 10 ha;
- Në afërsi dhe në drejtim të rrjedhës së jashtme të lumit;
- Me qëllim të shkarkimit të ujërave të trajtuara;
- Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- Në lokacione jashtë vendbanimeve, dhe të izoluara nga vendbanimet;
- Në 6.60 m në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 7.0 m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.50 m;
- Në 6.00 m në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 6.0 m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m;
- Trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5.00 m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m.¹⁷

▪ **Kushtet e vendosjes së gypave sipas kategorisë së rrugës:**

Kushtet për hartimin dhe ndërtimit të projekteve të kanalizimeve të ujërave të zeza sipas kategorisë së rrugëve janë:

- Gypat e kanalizimit të ujërave të zeza duhet të trasohen në aksin e rrugës.
- Thellësia minimale e vendosjes së gypave duhet të jetë 1.0 m nga pjesa e sipërme e gypit;
- Gjerësia e kanalit merret nga normativa duke ju referuar, Normat e gjerësisë së kanalit të kanalizimit;
- Diametri i gypave përcaktohet me Llogari hidraulike; Varësisht nga numri i banoreve të cilët jetojnë në atë zone
- (Varësisht nga koeficienti i ndërtimit dhe destinimit të zonës);
- Distanca në mes të pusetave duhet të jete nga 20 deri në 60 m;¹⁸

¹⁶ UA mbi normat teknike të planifikimit hapsinor

¹⁷ UA mbi normat teknike të planifikimit hapsinor

¹⁸ UA mbi normat teknike të planifikimit hapsinor

Analiza SWOT

Analiza SWOT

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundesi për permiresim.

Zonat me Probleme Mjedisore

Ky seksion bën një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në Gjakovë dhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

Diskutim i grupeve të faktorëve në analizën SWOT.

Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Të gjithë lumenjtë dhe proskat, vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkaktuar nga depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta. Pastrimi i lumenjve të Gjakovës kërkon një menaxhim më të mirë të mbetjeve të ngurta, sidomos në vendbanimet e mëdha, si dhe sigurimin e kolektorëve të duhur gjatë rrugës. Eksploatimi i rërës dhe zhavorit nga shtrati i lumenjve në Komunën e Gjakovës paraqet një problem në vete, nga ky eksploatim degradohet i tërë ekosistemi i lumit (mikrozoobentosi dhe makrozoobentosi) si dhe ndrohet edhe shtrati i lumit.

Nëse nuk kontrollohet rritja e numrit të automjeteve dhe nuk ndërmerren masa për të përmirësuar rrugët, standardet e karburanteve dhe të shkarkimeve, atëherë rritja eparashikuar me katër herë më shumë mjeteve do të ketë pasoja në cilësinë e ajrit. Masat e ndërmarra nga Qeveria për reduktimin e makinave të vjetra nëpërmjet taksimeve dhe renia e ritmit të ndërtimeve kanë dhënë efekte pozitive në ndotjen e ajrit, por janë të pamjaftueshme për të siguruar cilësi të ajrit dhe nivel të zhurmave brenda standardeve.

Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore

Sa i përket zonave të veçanta të mbrojtura për komunën e Gjakovës duhet respektuar dhe zbatuar: Ligji Nr. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA. Me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë natyrore ministria e EA konkretisht AMMK ka hartuar listen për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore në baze të kësaj liste në komunën e Gjakovës janë të mbrojtura 37 asete të kategorizuara sipas kategorive të listuara në tabelën e më poshtme.

- Monument i Natyrës – 1 Kanioni i Drinit të Bardhë;
- Pejsazh Natyror – 1 Shkugëz;
- Park Kombëtar – 1 Bjeshkët e Nemuna;

Asetet natyrore të përmbledhura:

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- Monument i Natyrës - karakter botanik, 27 asete;
- Monument i Natyrës - karakter hidrologjik, 6 asete;
- Monument i Natyrës – speologjik, 4 asete.

Përveç listës së monumenteve natyrore të mbrojtura komuna e Gjakovës ka edhe disa lokalitete tjera te cilat kane potencial qe të trajtohen si zona të mbrojtura në nivel komunale dhe ne të ardhmen të shiqohet mundësia e vendosjes se këtyre lokaliteteve ne liste të mbrojtur të trashëgimisë kulturore.

5. Shpella e Kukës;
6. Gurra e Thatë;
7. Gurra e Kusarit;
8. Ujëvara e Currelit

Agrumente të Analizës SWOT

Pikat e forta

Në komunën e Gjakovës ekzistojnë hulumtime të natyrave dhe fushave të ndryshme të cilat janë berë edhe në të kaluarën edhe tani ka një inventarizim të florës dhe faunës bukur të mirë, identifikim të problemeve mjedisore, ka analiza për ekosisteme bimore dhe ato shtazore kryesisht në mikro dhe zoobentos (nga studentët dhe studiues tjer) ka strategji të zhvillimit ekonomik lokal, Planin zhvillimior Urban dhe draft Planin Zhvillimor Komunal, si dhe këtë dokument VSM) i cili analizon në mënyrë sistematike ndikimet potenciale mjedisore nga aplikimi i Planit Zhvillimor Komunal. Duke qenë komunë me një turizëm të zhvilluar, kjo komunë është në avantazh për shkak se është kryeqendër e Kosovës por edhe vetë si komunë si zona ekonomike dhe sociale me potenciale të konsiderueshme të zhvillimit ekonomik, turistik, komunikim (rrjeti nacional dhe nderkombetare i infrastruktures). Pika të forta janë edhe prezenca e kapaciteteve të zhvilluara intelektuale, kapacitetet rionore. Kemi edhe për çdo ditë e më shumë instalimin e teknologjive inovative dhe reduktim të dukshëm të industrive ndotëse. Legjislacioni mjedisor është drejt përfundimit me ato të Bashkimit Europian.

Pikat e dobëta

Shtirja e vendbanimeve në zonat ku toka është e bonitetit të lart, poashtu edhe në zonat me vlera mjedisore. Koncentrimi i banorëve në disa fshatra por edhe në qendra për rreth rrugëve kryesore, kurse disa vendbanime po ballafaqohen me zbrastje nga banorët. Ndikimi i presionit të rritjes dhe zhvillimit në disa vendbanime tjera determinohen kryesisht me mungesën e vendeve të punës, papunësisë dhe kulturës së jetesës, faktorë që duhen të manaxhohen.

Në planin administrues niveli i ulët i aftësive në segmente të administratës lokale ngadalëson kapacitetet manaxheriale. Probleme me pronën private të truallit, privatizimet, prania e hot spoteve mjedisore, mungesa e zbatimit korrekt të legjislacionit, veçanërisht atij mjedisor, krahas zhvillimeve të pa kontrolluara gjate dy dekadëve të fundit, janë pjesë e pikave të dobëta në këtë analizë. Pika të dobta vazhdojnë të mbeten mungesite në trajtimin e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, të ndërtuar dhe natyrore, infrastrukturës, veçanërisht në furnizimin me

uje të pishem, kanalizimi i ujrave të zeza, mungesa e pastrimit të ujërave të zeza, manaxhimi i dobet i mbetjeve komunale, etj.

Mundësitë

Potencialin turistik që ka kjo komunë dhe mbeshtetjen e mundëshme të donatorve dhe qeverise, është e mundur që komuna të vazhdoj të hartojë dhe zbatojë plane, programe dhe iniciativa të tjera për zhvillimin e studjuar të pjesëve të trajtuar me këtë Plan Zhvillimor Komunal dhe trajtuara si zona për shfrytëzime të ndryshme, trajtimin e hapësirave të zgjeruara ndërtimore të parapara me planë, hapësirave pyjore, paisazheve atyre rekreative dhe permiresimin e treguesve mjedisorë. Në Planin Zhvillimor Komunal është e mundur të rritet ndjeshëm aplikimi i Ligjeve dhe Vendimeve të Kuvendit Komunal në favor të mjedisit dhe rritjes së financave publike komunale. Me qëllim të rritjes së hapësirave publike rekreative është e rekomanduar inkurajimi i biznesit privat në hapësirat rekreative (parqe, salla lojrash, fusha sporti, sipërfaqe për femijët). Rritja e cilësisë së transportit publik është një mundësi që duhet të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.

Kërcënimet

Humbja e vlerave të trashëgimis natyrore, Mos trajtimi i hot spoteve mjedisore (deponive ilegale të mbeturinave dhe mbetjeve tjera, vendeve të goditura me uranium të varfëruar nga lufta e fundit) mos trajtimi i zonave të mbrojtura, mos rikthimi i shtratit të lumenjve në gjendjen e më parshme duke i rregulluar edhe argjinaturat mundë të shkaktoj kërcënime serioze mjedisore dhe shëndetsore në komunën e Gjakovës dhe në rrethin pasi që ndotja dhe degradimi mjedisor nuk njohin kufij administrativ.

Me humbjen e vlerave natyrore, rekreative, shkencore dhe turistike, vendbanime të tëra të mbesin pa asnjë banor, kostoja e shërbimeve ngritet deri në shkallën që shkakton trazira sociale dhe ekonomike. Problemi i pronësisë së tokës sidomos mungesat e pronave komunale për zhvillime përbejnë një grup problemesh shqetësuese ndikimi i të cilëve do të vazhdojë gjatë.

Analiza AWOT

<p>Përparsitë Me HZK janë trajtuar disa nga problemet dhe sfidat mjedisore Kushte të përshtatshme fiziko-gjeografik, turizëm i zhvilluar dhe burime natyrore kryesisht të mjaftueshme; Interesim në rritje i qytetarve, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile për mjedisin Legjislacion mjedisor dhe planifikimi hapsinor i zhvilluar dhe përmirësuar; Prani e teknologjive inovative në procese industriale dhe ndërtimore; Kushte të mira të transportit të mallrave dhe njerzëve; Rritja e efektshmërisë së zbatimit të Ligjeve dhe detyrimeve financiare të popullsisë dhe biznesit në raport me taksat komunale; Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rëndësishme në kuadër të HZK-së;</p>	<p>Dobësitë Mungesa e disa informatave për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me HZK. Shkallë e lartë e ndërtimeve informale; Shpopullimi i zonave malore dhe përqëndrim i konsiderueshëm në zonat e ulta; Rrugë me përmbajtje jotë plotë (trotuar, parkingje, etj) Shkallë e konsiderueshme nga ndotja e zhurmës dhe gazrave të djegjeve të brendshme motorike; Motivimi i ulët në segmentin e caktuar të administratës publike dhe qeverisjes lokale; Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike; Ndërtimi i banimit kolektiv pa norma të duhura urbanistike dhe ndërtimore; Mungesa e koordinimit me komunat për rreth; Infrastrukturë jo shumë e zhvilluar dhe e pintepruar (jo shumë funksionale); Manaxhim i dobët i mbeturinave; Mos trajtimi i hot spotëve mjedisore; Menaxhim jo i mirë i turizmit; Shkallë e ulët e të hyrave vetanake në buxhetin e komunës;</p>
<p>Mundësitë Planifikimi i masave për mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit; Gadishmëri donatorve dhe qeverisës për trajtim të pikave të nxehta mjedisore; Zhvillimi i kapaciteteve manaxhuese të politikave, planeve dhe programeve në nivel komunal; Krijimi i një Forumi qytetar gjithë përfshirës për kualitet të jetës më të mirë, si një njësi për oponencë dhe edukim mjedisor; Bashkëpunimi i koordinuar me komunat tjera; Ndërtimi i impantit regjional dhe trajtimi i përkohëshëm në pikat e fundit të derdhjeve të ujit të përdorur. Përmirësimi i shërbimeve në transportin publik; Përfshirja e biznesit privat në hapësirat pyjore, të gjelbra dhe rekreative (parqe, salla lojrash, sipërfaqe për fëmijët).</p>	<p>Kërcënimet Rrezikimi i shëndetit të popullatës; Prishje e balancit mjedisor; Shkatërrimi i resurseve toksore, ujore dhe resurseve tjera; Shkatërrimi i ekosistemeve, biodiversitetit, florës dhe faunës; Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore; Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë; Pakësimi i hapësirave publike për shkak të presionit; Mungesa dhe/ose kosto e lartë për disponimin e sipërfaqeve të lira për projekte zhvillimore; Ulje e ndjeshme e biodiversitetit; Mungesa e koherencës midis aksioneve të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, donacioneve dhe departamenteve universitare/studiove profesionale etj.</p>

HARTA ZONALE KOMUNALE

SHKALLA QË HZK-ja NDIKON NË PLANET E TJERA

HZK-ja vlerësohet të ketë pasur një vështrim të plotë të planeve të ndryshme të cilat janë zhvilluar në nivel të Kosovës ose Planeve dhe Projekteve të cilat janë bërë më herët në Komunën e Gjakovës (PZHK)Kurse për zonën urbane ka PRRU ndersa më herët kanë ekzistuar plane detajizuese. Të gjitha këto plane janë marrë në shqyrtim dhe vlerësohet se gjendja në terren ka ndryshuar.

Disa nga aspekte kryesore të gjendjes aktuale mjedisore

Të dhënat më poshtë i referohen gjëndjes mjedisore të tanishme në komunën e Gjakovës. Qëllimi kryesor i diskutimit të dhënave bazë është të identifikojë gjëndjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të Hartës Zonale Komunal të komunës së Gjakovës Impaktet potenciale të zhvillimit të HZK-së mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e Dokumentit nëpërmjet indikatorëve të gjendur/të supozuar sasiorë ose cilësorë. Esencialisht, gjëndja mjedisore e komunës së Gjakovës karakterizohet nga përshkrimi i receptorve mjedisore, siç kërkohet nga Direktiva e VSM, të përshkruara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrorës;
- Cilësia e ajrit
- Bezdisjet- zhurma kundërmimi pamjet e pa këndshme;
- Faktorët kilamtikë, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peisazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike);
- Trashëgimia natyrore (Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore).

Shëndeti

Ndikimet në shëndetin e publik për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponente mjedisore të tilla si ajëri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit më njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapsirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqesimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Ne komunën e Gjakovës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF dhe AMF.

Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave te zeza si dhe manaxhimi i mbetjeve.
- Mbrojtja e Vegjetacioneve autoktone;
- Mbrojtja e zonave të llojeve bimore endemike;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore të pellgut;
- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit;

Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen

Te pjesa e gjendjes ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçrit natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensitivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustron në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani. Shumfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethë, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërsie pejsazhesh e gjelbrimi.

Zonimi i territorit të komunës

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsitë, infrastrukturën shoqërore arkitekturat, gjeomorfologjinë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Gjakovës me HZK janë trajtuar si më poshtë:

Zonat e ndërtimit në vendbanime:

- **Zonat e pazhvilluara me ndërtim:**

HZK-ja i ka identifikuar dhe trajtuar duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastrukturë hidrografike dhe infrastrukturë tjetër.

- **Zonat turistike**

HZK ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundëshëm në komunën e Gjakovës kurse nuk janë të prezantuar në hartën e turizmit.

Zona të mbrojtura

HZK-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimis kulturore - historike, peisazhike, mjedisore e turistike të Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat çënojnë identitetin e zonës. Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos çënuar identitetin e tyre dhe disa zona që shpallën të interesit komunal me HZK).

Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale

Zona industrial planifikohet të jetë lokale, dhe do zhvillohen kryesisht ku tashmë është krijuar një bërthamë e një zone industriale në qytet ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesat tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me HZK dhe duhet propozuar masat mjedisore. Në hartë nuk është e paraqitur kufiri i zonës industriale.

Pyllzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e blerta dhe të pushimit

Komunën e Gjakovës sikurse në gjitha komunat tjera të Kosovës zhvillimet nuk i kanë favorizuar pyjet dhe zhvillimin e tyre, sidomos pyjet e zonave të ulta (Shpërdhit me qarr). Shumë nga zonat e gjelbërta, zonat rekreative natyrore, në shumicën e rasteve vihen para shkatërrimit total të tyre, si pasojë prerjeve ilegale, djegjeve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe zonat e shkurreve dhe kullosat janë planifikuar në HZK. Deri tanishumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund të organizohen pushime vikendi apo diçka të ngjajshme.

Esenciale çka HZK-ja duhet ofruar është siguri i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe bicikletat dhe tampon zonave të zhvillimit industriale dhe tjera të ndjeshme, si dhe rritjen e fondit të gjelbërt në komunë.

Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik

- HZK duhet të tregojë çart në hartë vendet ku kemi erozion dhe çfare shkalle të erozionit nëse kemi erozion shumë të fort ose të fort at'her të merren rreptsisht masa për parandalimin e tyre, poashtu duhet të tregojë për zonat e vërshimeve dhe masat të cilat duhet të merren kundër vërshimeve.
- Zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hasirat e banimit duke e precizuar çart në hartë (pjesa grafike);
- zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;

- Zhvillimi i Pyjeve, hapsirave të gjelbërta, shiritave gjelbrues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në Planet Rregulluese dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

Biodiversiteti, Flora dhe Fauna

- Edhe pse jo i hulumtuar në detaje, bazuar në të dhënat nga hulumtimet e deritanishme si dhe nga hulumtimi i realizuar në këtë rast, mendojmë se territori i komunës së Gjakovës ka biodiversitet ^{mjaft} të larmishëm dhe të pasur. Ky diversitet i larmishëm i botës së gjallë është si rezultat i larmisë së ekosistemeve prezentë në këto hapësira. Në shtrirje horizontale dhe vertikale, diversiteti është i larmishëm duke filluar që nga ultësirat deri te lartësitë më të mëdha në malet e larta të territorit të hulumtuar. Llojet bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Gjakovës janë të përhapura në ekosisteme të ndryshme, si në lumenjë e përgjatë tyre (Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Llukaci PLVB të komunës së Gjakovës 2019-2024 31 dhe disa lumenjë të vegjël por të rëndësishëm), në liqen (Liqeni i Radoniqit), në toka pjellore, livadhe e kullosa, male e bjeshkë të larta. Ky diversiteti biologjik zhvillohet si rezultat i kësaj larmie territoriale me gjeologji, respektivisht me pedologji të ndryshme, duke filluar nga luginat fushat aluviale rreth lumenjëve, fushëgropa e Gjakovës, krahinat-hapësirat kodrinore si ajo e Hasit, Dushkajës etj., masivin malor në relacionin Qafë e Morinës-Qafë e Prushit, pjesët malore rrëzë Pashtrikut dhe deri te pjesët malore të Bjeshkëve të Namuna apo thënë ndryshe Alpeve Shqiptare - pjesa e Kosovës. Për shkak të vlerave të trashëgimisë natyrore rreth 5% (afro 3000 ha) të Parkut Nacional “Bjeshkët e Namuna” shtrihen në territorin e komunës së Gjakovës. Poashtu në kuadër të territorit të KK të Gjakovës, në kuadër të diversitetit biologjik ka vlera të trashëgimisë natyrore të cilat janë të mbrojtura me ligj por edhe të propozuara për mbrojtje me ligj (AKMM - IKMN 2008, 2010). Nga numri i gjithmbarshëm prej 3 Zona të Mbrojtura me Ligj (“Çabrat”, “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë” dhe “Shkugëza”), respektivisht 28 zona të propozuara për marrje nën mbrojtje ligjore të propozuara në vitin 2003; në mënyrë direkte apo indirekte është fjala edhe për vlera të biodiversitetit. Në kuadër PLVB në komunën e Gjakovës janë realizuar dhjetë ekspedita hulumtuese në terren (EK & DR / 07-17.09.2018) të cilat nxorën në shesh rezultate relevante të cilat do të paraqiten në këtë rast.
- Në këto terrene në fragmente të shkëputura e shpesh të vogla si rezultat i veprimtimit antropogjen rriten lloje bimore të ultësirave të cilat hyjnë në kuadër të vegjetacionit të pyjeve respektivisht shkurreve me shëlg e plep por edhe me verr e marinë (brukë) të cilat zhvillohen më tepër përgjatë luginave lumenjëve, ndërsa në aspektin sintaksonomik i takojnë klasëve Quercofagetea e Alnetea glutinosae, rendeve Alnetalia glutinosae dhe Populetalia albae si dhe alencave Alnion glutinosae, Salicion albae dhe Populion albae. Llojet më të shpeshta bimore të këtyre hapësirave në katin e drurëve janë prezente llojet Salix alba (dominion), Populus nigra, Ulmus effusa, Alnus glutinosa, Salix fragilis. Në katin e shkurreve janë prezente llojet bimore Salix purpurea, Frangula

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

alnus, Cornus sanguinea, Tamarix tetrandra ndërsa në katin e bimëve barishtore gjenden llojet bimore Galium palustre, Alisma plantago aquatica, Veronica anagallis, Mentha aquatica, Agrostis alba, etj.

- Deri më tani lloje shtazore të mbrojtura me ligj në Republikën e Kosovës dhe që gjenden edhe në territorin e komunës së Gjakovës janë llojet: Ursus arctos (Ariu i murrmë), Sciurus vulgaris (Ketri), Martes foina (Sqarhi, Kunadhja gushbardhë), Capreolus capreolus (Kaprolli) dhe Felis silvestris (Macja e egër).

• Përdorimi i Tokës dhe Peisazhi

Planifikimi i përdorimit të tokës dhe çështje të sigurimit të shërbimeve

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapsira banimi fillimisht po japin definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksione bazë të saj të cilat janë:

- Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;
- Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;
- Mbajtëse e biodiversitetit;
- Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;
- Burim materiale;
- Si depozitë karboni;
- Arkiv për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Disa nga zhvillimet në komunën e Gjakovës sidomos ndërtimet e pa planifikuara nuk kanë bërë një përdorim efikas dhe të qëndrueshëm të tokës. Shumë nga zhvillimet e paplanifikuara nëpër vendbanime, mund të thuhet se i kanë përkeqësuar problemet e infrastrukturës dhe kanë çuar në degradim mjedisor. Shumë nga kanalizimet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotura tashmë gjenden në tokë me pronsi private, për të cilat të drejtat e kalimit dhe përdorimit nuk janë plotësisht të përcaktuara, duke e kufizuar kështu mundësinë e hyrjes për mirëmbajtje.

Poashtu, pa ndonjë plan, apo edhe vlerësim të resurseve, janë aprovuar shumë projekte të reja. Nuk është e qartë se a është bërë vlerësimi i furnizimit të mjaftueshëm me ujë dhe energji i këtyre zhvillimeve të reja.

Infrastrukturën dhe shërbimet për vendbanimet, duhet ti siguroj Komuna. E kombinuar me një kërkesë për infrastrukturë dhe mobilizim të resurseve financiare, kushtet mjedisore në komunë vazhdojnë të jenë një problem.

Toka ndërtimore në territorin e komunës merr një rëndësi të posaçme; për efekt të mungesës së fondeve dhe planifikimeve, për gjatë 20 vjetëve të fundit në Kosovë, toka pronë publike është zvogëluar dhe prona private po dominon. Ritmet e çmimit të sipërfaqeve të konsideruara si truall kanë qënë të larta. Statuti privat dhe çmimi vështirëson sot komunën e

Gjakovës të gjëjë hapsira për vepra publike. Kjo do të vazhdojë edhe më tutje duke kufizuar shpesh implementimin e HZK-së në vepra publike (rrugë, lulishte, parqe, etj).

Çështje mjedisore që lidhen me përdorimin e tokës

- Përdorimi i tokës për ndërtim është në rritje dhe raporti ndërtim/sipërfaqe e gjelbërt është i disfavorshem duke krahasuar me normat europiane për etnitete me specifika të njejta në komunën e Gjakovës kemi shtrirje disperse të vendbanimeve;
- Planifikimi i zonave ndërtimore nuk duhet të prekë sipërfaqe të gjelbërta veç në raste të jashtezakonshme dhe duke i rikompensuar ato;

Duke pasur parasysh keto specifika, në kapitullin më poshtë paraqiten masa të pershatshme për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta. Për më tepër, paraqiten kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin e ndërtimeve, që përfshijnë kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, kriteret e trashëgimisë kulturore, kriteret peisazhike dhe ato inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Rreziket natyrore në mjedisin fizik

Me rritjen e ndërtimit dhe degradimit të pyjeve, rreziku i përmytjeve do të rritet shumë.

Kjo gjë përshkruhet mëposhtë në seksionin mbi Menaxhimin e Mbeturinave të lëngshme dhe Ujërave të Shiut.

Adaptimi dhe Zvogëlimi i Rrezikut të Katastrofave, përmirësimi i informacionit dhe reagimi për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore duhet parë me prioritet edhe atë në funksion të:

- Menaxhimit të Rrezikut të katastrofës;
- Forcimit të shërbimeve hidrometeorologjike;
- Caktimit të kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;
- Sigurimin e individëve dhe bizneseve nga katastrofat natyrore.

Në tabelën në vijim do të paraqesim zonat në të cilat duhet të merren masa kundër erozionit shumë të fort, erozionit të fortë sipas një klasifikimi të projektit EULUP në Kosovë.

Mjedisi i ndërtuar dhe kultura

Sikurse komuna tjera edhe komuna e Gjakovës është si komunë administrative jo fort e vjeter e disa nga vendbanimet e saj datojnë që nga lashtësia dhe prezantojnë vlera që janë të mbrojtura për nivelin e Kosovës.

Cilësia e ajrit

Industria e pa zhvilluar ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e ajrit, ndërkoh që zhvillime tjera pas luftës në Kosovë si komunikacioni, djegia e pa kontrolluar e mbeturinave, djegiet e biomasës, produkteve bujqësore lirimi i disa gazrave si freoneve, dhe gazrave azotike të cilat po përdoren kohëve të fundit në vend të karburanteve këto ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e ajrit në hapësira të ngushta siç janë fshatrat që ndodhen në luginë ku lëvizjet e masave të ajrit janë të vogla. Zhvillimet ekonomike dhe sociale pas luftës veçanërisht rritja e numrit të automjeteve kur dihet se pjesa më e madhe e tyre janë të stërvjetuara të viteve të 80-ta,

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

poashtu edhe veprimtarive ndërtuese kanë shkaktuar një ndotje të ajrit në Komunë. Në mënyrë të përbledhur po rendisim disa subfaktorë të cilat kanë ndikim në cilësinë e ajrit në komunën e Gjakovës :

- Komunikacioni hekurudhorë
- Rritja e lartë dhe përdorimi i shpeshtë i makinave private;
- Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- Edhe pse të vjetër gjendja teknike e tyre jo e mirë, duke liruara gazra dyfish më shumë se normal;
- Gati të gjitha objektet përdorin ngrohje individuale me dru dhe forma tjera të djegies;
- Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë dhe me plin;
- Nga të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territor të komunës së Gjakovës , shumica janë të asfaltuar;
- Djegiet e mbeturinave në deponi të egra;
- Djegiet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Një tjetër problem që lidhet me cilësinë e ajrit është edhe cilesia e karburanteve që përdorin automjetet. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojnë me naftë të cilësisë së dobët. Megjithatë lidhur me këta të fundit, ndikimi i tyre në cilësinë e ajrit të komunës së Gjakovës është minimal.

Zhurma dhe Kundërmimi

Një tjetër problem mjedisor më të cilin po ballafaqohet gjithnjë e më shumë Komuna e Gjakovës është zhurma duke e pasqyruar se këtu gjenden koncentrim i vendbanimeve dhe dendësi e konsiderueshme e banimit. Komuna e Gjakovës ka një rrjet të dendur rrugor. Me HZK, janë trajtuar disa nga masat mjedisore për amortizimin e zhurmës. Për gjatë rrugëve nacionale, hekurudhave dhe rrugëve rajonale duhet të parashihen masa mjedisore kundër zhurmës, siç janë barrierat fizike nga dheu, zona të gjelbërta me pyllëzim dhe pahi të plastifikuar në vendet ku janë më të nsjeshme (si shkolla dhe hapësira tjera publike dhe banuese), por për shkak të implikimeve financiare disa nga këto masa mund të mos zbatohen ose mund të mos implementohen në lokacione të caktuara. Komuna e Gjakovës këtu duhet të jetë vigjilente dhe të jetë e kyqur në kontrollin e ndërtimit të rrugëve.

Përpos këtyre akteve kemi edhe disa pika të ndotjes nëpër vendbanime. Megjithatë zhurma është në të gjitha raste përtej vlerave limit që përcakton Udhezimin “Per nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara” dhe Limitet e Pergjithshme për Nivelin e Zhurmave të OBSH. Një tjetër dukuri për tu vënë në dukje është niveli konstatant i zhurmës gjatë 24 orëve në zonën e bllokut e cila është njëherësh edhe zonë residenciale ku limiti i nivelit të zhurmës në orët e natës nuk duhet të kalojë 45 dBA, ndaj vlerave mbi 60 dBA. Sa i përket kundërmimit si aspekt tjetër i bezdisjes në komunën e Gjakovës vendet në të cilat kemi kundërmim janë deponit ilegale sidomos ato afër lumenjve për shkak të lagështisë të cilat sjellin në vazhdimësi bezdisje për qytetaret që jetojnë në ato zona. Vendshkarkimet e kanalizimeve të fshatrave dhe

vendshkarkimet individuale të kanalizimit të ujërave të zeza janë poashtu burim i kundërmimit, bezdisjes dhe sëmundjeve për qytetarët dhe kalimtarët. Komuna duhet të eliminoj me prioritet deponit ilegale rreth lumenjve dhe të ndërtoj impiante për pastrim të ujërave të zeza siç është parapar edhe me HZK.

Burimet ujore dhe furnizimi me uje

Kushtet zhvillimore të përcaktuara për rritjen e resurseve të ujit bazohen në Udhëzimin Administrativ për Hartën Zonale.

Më tej këto dokumente përcaktojnë kushte dhe sigurojnë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës dhe kornizën institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Në Planin Zhvillimor Komunal janë përcaktuar sipërfaqet (Pikat) dhe hapat e nevojshëm për rritjen e resurseve të ujit për komunën e Gjakovës

Kjo nënkupton që për përmbushjen e nevojave për furnizim me ujë të popullsisë dhe ekonomisë së komunës së Gjakovës do të nevojiten burime të reja dhe rritje të kapaciteteve të ujit dhe rezervuarëve të konsiderueshme në zonën urbane dhe rurale.

Sipas analizës së vlersimit të gjendje të ifrastrukturës së ujësjellësit, numrit të prognozuar të banorëve për secilin vendbanim deri në vitin 2028, përfshirë edhe banorët jo rezident, kërkesës mesatare sipas udhëzimit administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ndërtimit të hovshëm të njësisve banesore si dhe ndërtimit të lagjeve me ndërtime individuale:

Komuna ka nevojë që:

Për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme të furnizimit me ujë në të gjithë komunën deri në vitin 2028 të bëj:

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellësit në zona të reja të zhvillimit ndërtimor;
- Hapja e puseve të reja në disa disa vendbanime rurale;
- Rehabilitimi i stacioneve të pompave;
- Rritja e vëllimit të rezervuarëve dhe ndërtimi i rezervuarëve të ri;
- Mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit;
- Zëvendësimi (Ndërtimi) i gypave të vjeter AC, Çelik me PE-100-RC dhe Zgjerimi i rrjeteve primare të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në gjitha fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit;
- Krijimin e zonave dhe nënzonave për vendosjen e matëseve të ujit (DMA) për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit.
- Studimi i fizibilitetit - rritja e kapaciteteve akumuluese të ujit: (pellgu të lumit Drini I Bardh Erenik dhe Krena dhe lumenjve tjerë në Komunën e Gjakovës)

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- Studim i fizibilitetit mbi rrjetin e egzistues të ujësjellesit duke përfshir planifikimin dhe ridizajnimi i rrjetit primar të rrjetit të ujësjellësit (modelimi hidraulik) për qytetin.
- Rritja e kapaciteteve të rezervarëve, kaptazhe, fabrika për përpunimin e ujit dhe ndërtimi i rezervuarëve të rinjë në zonat e reja të zhvillimit të qytetit dhe fshatrave;
- Rehabilitimi i sistemit të ujësjellësit .

PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE

VI. QËLLIMET E VSM-së PËR HARTËN ZONALE KOMUNALE TË GJAKOVËS

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë HZK-së së Gjakovës, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë po njëjloj për Planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

Qëllimi Mjedisor 1 (QM1) – Ajri: Përmbushja e objektiveve afatmesme për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufijve maksimalë e normave të lejuara nga Bashkimi Europian.

Qëllimi Mjedisor 2 (QM2) – Uji: Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin e bashkisë, mbi burimet dhe trupat ujorë sipërfaqësorë e nëntokësorë, përfshirë ujin e pijshëm, ujërat bregdetare dhe brigjet.

Qëllimi Mjedisor 3 (QM3) – Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe burimeve natyrore të lidhura drejtpërdrejt me të.

Qëllimi Mjedisor 4 (QM4) – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të mjedisit.

Qëllimi Mjedisor 5 (QM5) – Pyjet: Konservimi, shtimi dhe manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike dhe ofrimit të një burimi të qëndrueshëm jetese për banorët e zonave rurale.

Qëllimi Mjedisor 6 (QM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet: Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.

Qëllimi Mjedisor 7 (QM 7) – Ndryshimet klimatike: Realizimi i masave dhe infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike, në përmbushje edhe të angazhimeve përkatëse kombëtare.

Qëllimi Mjedisor 8 (QM8) – Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi për jetëgjatësi i objekteve dhe zonave historike e të trashëgimisë kulturore e arkeologjike.

Qëllimi Mjedisor 9 (QM9) – Cilësia e jetës: Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.

- Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
 - Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, eliminimin e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
 - Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj);
 - Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim.

Qëllimet strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetes në komunë (rritja e sigurisë, shtim i mundësive për menyre aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

HZK-ja parashikon kushte dhe masa zhvillimore për Komunën si një e tërë me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këto faze, duke qenë HZK-ja, do jepen kufijt, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standartet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim përmes kushteve zhvillimore dhe masave, dhe më pas puna do vijojë me Planet Rregulluese të Hollësishme të detajojnë zhvillimin për çdo zonë banimi dhe zona tjera. HZK-ja do të përfshijë kushtet zhvillimore dhe masat për menaxhimin e pronës në menyre adekuate pa dallime të pronarve gjatë dhënies së kushteve në zona ndërtimore, gjelbrim etj. Sfidues është fakti nga se në HZK nuk vërehen sakt të specifikuar si zona zhvillimet e reja të infrastrukturës, zonat industriale, etj., të cilat do të analizohen ndikimi i tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve ose a janë marrë masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, pyllzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve, etj. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden vetëm në pjesën strategjike. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktike të këtyre kushteve zhvillimore të HZK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shiritat të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisorë të komunës.

Gjithashtu HZK-ja synon të integrojë dhe përmirësojë situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë më plleshmëri të dobëtdhe me përdorim të perzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i HZK-së është masat për rehabilitimin e pikave të nxehta mjedisorë (duke mos specifikuar sakt lokacionet e pikave të nxehta mjedisorë por kjo është trajtuar si problem).

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit mund të përmbledhen si mëposhte:

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

1. Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi i integruar i tyre;
2. Krijimi i një komune të qendrueshme dhe të shëndetshme;
3. Identifikimi dhe krijimi i habitatve të reja, dhe korridoreve te gjelberta;
4. Permiresimi i cilesise së ajrit, perfshire reduktimin e zhurmave;
5. Kursimi i, energjise dhe paksimi i emisioneve të gazeve serrë;
6. Cilesia e ujrave siperfaqesore në përputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives në kuader për Ujin të BE-së;
7. Reduktimi i intesnsitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me bicikleta;
8. Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, perfshire arkeologjike dhe arkitekturore;
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
11. Riperdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

6.1 Projekt-Raporti perfundimtar

Raporti Përfundimtar do të jetë rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të komunës, si edhe seancave të dëgjesave me pubikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet qe dalin gjate procesit, do u jepet pergjigje dhe do integrohen nese gjykohen të drejta, dhe ne fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Komuna dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

6.2 Roli dhe natyra e Hartës Zonale Komunale

Harta Zonale Komunale e Gjakovës është dokument i cili përmes kushteve zhvillimore dhe masave përcaktone drejtimet e zhvillimit të komunës duke marrë parasysh interesat e përbashkëta të banorëve të Komunës së Gjakovës për një mirëqenie dhe një zhvillim ekonomik, duke përmiresuar kualitetin e jetes se banoreve te vet. HZK kujdes të veçantë i kushton vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore dhe mbron resurset e këtij territori. Planifikimi hapësinor duhet të ketë rolin udhëheqes në zhvillimin e gjithëmbarshtëm prandaj Harta Zonale Komunale e Gjakovës do të përbëjë udhëzuesin bazë për:

- Identifikimin e lokacioneve me potencial te zhvillimit hapësinor në komunën e Gjakovës
- Përcaktimin politikave përmes kushteve zhvillimore dhe masat që i jep lidhur me shpërndarjen hapësinore të funksioneve të banimit, industrisë, shërbimeve, turizmit, zhvillimit rural dhe politikave në mbrojtjen e vlerave të trashëgimive kulturore, historike dhe natyrore.
- Identifikimin e rolit të vendbanimeve kryesore dhe veçanërisht të qytetit të Gjakovës – si qender administrative - duke kontribuar ne zhvillimin te pergjitheshem ekonomik, social dhe mjedisor te kesaj komune.

Harta Zonale Komunale përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës të planifikimit të integruar:

- Përcakton mënyrën dhe drejtimet e vendosjes së popullsisë, punësimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore për t'i shërbyer,
- Orienton dhe lehtëson vendimet politike për investimet publike në infrastrukturë teknike dhe sociale,
- Përkrah zhvillim të balansuar në mes të zonave urbane dhe zonave rurale dhe me shkallë të ndryshme ekonomike,
- Identifikon lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të komunës.

6.3 Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojnë zhvillimin komunal, të grupuara në katër kategori kryesore, përkatesisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, (2) kriteret të trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peisazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret të forta mjedisore-shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike).

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore përfshijnë:

- Peizazhet specifike, një fenomen natyror me rëndësi të jashtëzakonshme;
- Zonat përgjat lumenjve dhe disa rrjedheve tjera të identifikuar si biokoridore kryesore dhe bikoridore sekondare;
- Kaptazhat e burimeve ujore në të gjithë komunën;

Nuk lejohen ndërtimet në zonat e mësipërme që bartin vlera të veçanta mjedisore.

(II) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shtretërit e lumenjve dhe pjesët buferike rreth tyre
- Basenet nentokësore ujëmbajtëse;
- Zonat me pjerresi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmbytjeve (qofte dhe shumë të rralla), mund të shkaktojnë erodion të brigjeve, si dhe të cenojnë rregjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat me pjerresi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në këtë fazë të Planit Zhvillimor Komunal është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjatë hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrtësi dhe gjatë zhvillimeve të ardhshme mund të superpunohet me informata tjera dhe të shfrytëzohet si bazë për Plane Rregulluese dhe projekte tjera.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike) përfshijnë:

- Deponia e e egra përgjat lumenjve dhe kanalizimet që derdhen drejt për drejt në lumenj;
- Vendet e goditura me uranium të varfëruar
- Thertore;
- Ndërmarrjetë riparimit të automjeteve;

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- Deponit e veturave “varrezat e veturave”.

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlersimin e situates mjedisore mbi bazën e:

Kritere të trashëgimisë kulturore

Komuna e Gjakovës ka objekte të trashëgimise kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturoredhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashëgimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qellim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin eqendrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Lista e monumenteve te kultures do duhet rishikuar dhe lehtesuar ndjeshem. Disa prej monumenteve te kultures jane cenuar, tjetersuar apo zhdukur. Disa prej monumenteve kanë qenë shpallur për motive qartesisht politike dhe lista duhet avancuar.

Ka disa zona tradicionale me vlere konservimi që mund të mbrohen. Duke pasur vlera të ndërtimit tradicional, këto zonaturistike duhet ruajtur me karakter të veçant.

Kriteret peisazhike

Kjo komunë ka vlera të larta pejsazhike të llojeve të ndryshme si peizazhe që krijojnë pyjet dhe Malet që shtrihen nëjug, livadhet dhe fushat e mbjellura përgjat luginave të lumenjve. Kriteret peisazhike janë vështirë për tu përcaktuar, pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen caktuar në bashkepunim dhe pajtuesmeri me institucionet tjera.

Zona me vlera të larta peisazhike në të cilat nuk duhet të lejohet ndërtimi përfshijnë:

- Monument i Natyrës – 1 Kanioni i Drinit të Bardhë;
- Pejsazh Natyror – 1 Shkugëz;
- Park Kombëtar – 1 Bjeshkët e Nemuna;

Asetet natyrore të përmbledhura:

- Monument i Natyrës - karakter botanik, 27 asete;
- Monument i Natyrës - karakter hidrologjik, 6 asete;
- Monument i Natyrës – speologjik, 4 asete.

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për t’i mbrojtur sa më mirë, intervenimet e njeriut në pikat skenike-atraktive, duhet të minimizohen. Posaçërisht, në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit. Shkaktarët kryesorë të degradimit të peisazhit janë minierat sipërfaqësore (gurthyesit), djegja e pyjeve dhe prerja e pakontrolluar e tyre.

Duke pasur parasysh se Ligji i Planifikimit ngarkon komunat me përgatitjen e Planeve Hapesinore, ndërkohë që Gjakova edhe se ka përgatit këtë planë duhet që të gjejë mirekuptim dhe bashkepunim me Institucionet tjera kompetente dhe akterët tjer për nevojën e mos-lejimit te ndertimeve në keto zona, qofte duke e sanksionuar këtë edhe me akt-normativ.

VII. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QE KUFIZOJNE

ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të HZK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojne zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

Parimet e përgjithshme për planifikim hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmblihen në dhjetë pika si mëposhte:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve dhe komunikimin e habitateve mes veti;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aksesit i publikut në informacion; dhe Bashkëpunim ndërkombëtar.

Ne kuadër të hartimit të HZK-së parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përmes kushteve zhvillimore përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve – aksesit nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore – historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

VIII. VSM - VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I KOMPONENTEVE KRYESORE MJEDISORE

HZK është zhvilluar duke u bazuar në principet e mëposhtme. Ato janë principe të përgjithshme që duhet të ndërmerren nga HZK-ja duke u ngritur nga korniza legislative e një niveli më të lartë dhe Planin Hapësinor të Kosovës (zhvillim i qëndrueshëm dhe kohezion social). Gjakova si shumica e qyteteve të tjera përballet me një sërë problemesh mjedisore, si psh cilësi e dobët e ajrit, nivel i lartë i trafikut, nivel i lartë i zhurmës së ambjentit, mjedis i ndërtuar me cilësi të ulët, toka të braktisura, emisione të gazrave, shtrirje të gjërë urbane, dhe trajtimi i mbeturinave e kanalizimeve, etj. Këto problem lidhen me një zhvillim urban që nuk është i orientuar drejt mjedisit. Principet e përgjithshme për zhvillimin dhe mbrojtjen ofrojnë një kornizë direktivash të cilat vijnë nga një planifikim i rëndësishëm dhe dokumente zhvillimore në nivelin vendor, Europian, dhe botëror: Ligjet dhe udhëzimet administrative në Planifikimin Hapësinor dhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020; Principet udhëzuese për zhvillim të qëndrueshëm BE (nga strategjia tematike për direktivat mjedisore urbane për qytetet e së nesërme) Principet për zhvillim të qëndrueshëm – Agjenda 21 për të kundërtuar aspektet negative të listuara më lartë, janë listuar më poshtë disa principe të rëndësishme për HZK-n e Gjakovës

Tabela 28. Elementet e përfshira në VSM

Elementet e Përfshira në VSM	Kategoritë e përdorura gjatë vlerësimit Strategjik Mjedisor
Biodiversiteti, bota bimore dhe bota shtazore	Ruajtja e biodiversitetit dhe natyrës (që përfshinë botën bimore dhe shtazore, dhe funksionimi i ekosistemeve)
Popullsia	Popullsia (përfshirë efektet socio-ekonomike dhe çasja)
Shëndetësia e popullsisë	Shëndetësia e popullsisë
Toka	Toka (përfshirë shfrytëzimin e tokës, zona të rëndësishme gjeologjike, ndotja e tokës)
Uji	Burimi dhe cilësia e ujit (përfshirë ujërat e freskët të sipërfaqes dhe ujërat nëntokësor)
Ajri	Cilësia e ajrit
Faktorët klimatikë	Ndryshim i klimës (përfshirë emetimet e gasit të Serrave, efektet e parashikuara nga ndryshimi i klimës sikur: përmbytjet dhe aftësitë për t'u përshtatur
Asetet materiale dhe energjia	Menaxhimi i mbeturinave dhe mineraleve; dhe i energjisë
Trashëgimia kulturore, përfshirë atë arkeologjike dhe arkitektonike	Trashëgimia kulturore (përfshirë trashëgiminë arkologjike dhe arkitektonike)
Peizazhi	Peizazhi dhe pamja e qytetit

Për të ruajtur token bujqësore dhe për një përdorim më racional të territorit dhe mbrojtjes së burimeve, HZK duhet të synojë për një zhvillim më kompakt me dendësi më të lartë të zënies së tokave.

Përdorimi më i përzirë, densifikimi dhe kontrollimi i shtrirjes urbane janë tri çështjet kyçe që duhet të frymëzojnë HZK-në: më shumë ndërtesa, banorë, dyqane, dhe shërbime pranë njëra tjetrës që e lehtësojnë të ecurit, për të mundësuar një përdorim më efikas të shërbimeve dhe burimeve, dhe për të krijuar një vend më të përshtatshëm dhe kënaqshëm për të jetuar. Një qytet më kompakt është një qytet që konsumon më pak burime dhe mund të zbatojë sisteme të transportit në mënyrë më efektive me një kosto më të ulët.

IX. KUSHTET ZHVILLIMORE të HZK-së KUNDREJT OBJEKTIVAT TË VSM-së

VSM-ja si dokument duhet të jetë efektive në mbështetjen e procesit të planifikimit, fokusi i tij duhet ngushtuar, duke identifikuar çështjet specifike mjedisore (në aspektin e problemeve dhe mundësive) të cilat janë të rëndësishme. Problemet paraqesin çështjet kritike të cilat ne dëshirojmë t'i adresojmë dhe përmirësojmë përmes planit. Mundësitë janë elemente të kontekstit mjedisor që mund të përdoren në planin për t'i arritur objektivat e tij, ose për t'i përmirësuar kushtet mjedisore. Një gjë e tillë mundëson identifikimin e objektivave specifike të VSM-së për t'i adresuar çështjet e tilla dhe për t'i përdorur këto objektiva si referencë gjatë hartimit të planit, po ashtu gjatë zbatimit të tij. Objektivat e VSM-së janë identifikuar duke marrë parasysh edhe objektivat e zhvillimit mjedisor dhe të qëndrueshëm të përcaktuara në ligjet përkatëse dhe veprimet strategjike (shih Kapitullin 2). Objektivi i gjerë i Vlerësimit Strategjik Mjedisor është të integrojë çështjet mjedisore të politikave, planeve dhe programeve në proceset e vendim marrjes, të tilla që informacioni mjedisor që rrjedhin nga shqyrtimi i politikave të propozuara, planeve, programeve apo projekteve që është përdorur për të mbështetur vendim marrjen. Kushtet zhvillimore dhe masat të paraqitura me HZK mjaftueshëm i trajtojnë mbrojtjen e të gjitha komponentëve mjedisore si dhe mjedisin jetësor dhe shëndetin publik. Kushtet zhvillimore të përgjithshme, kushtet zhvillimore masat, Zonat mbishtresore dhe brezat mbrojtës të rrugëve burimeve të ujit dhe zonave të trashëgimisë parashohin kritere dhe kufizime për ndotjen akustike, për ajrin, ujin, tokën/dherat, Biodiversitetin dhe Ekosistemet në përgjithësi. Të gjitha këto kushte dhe masa të parapara me HZK janë në harmoni me objektivat e VSM-së të cekura më lart.

Tabela 29. Lista e zonave bazë

Emërtimi i Zonave	Përmbajtja Zonave (Shfrytëzimi i Planifikuar i	Kodi	Simboli
Zonë banimi	Banim Individual	ZB1	ZB1
	Banim Individual	ZB2	ZB2
	Banim Individual	ZB3	ZB3
	Banim Individual	ZB4	ZB4
	Banim Kolektiv	ZB5	ZB5
Zonë për shfrytëzim të përzier	Shfrytëzim të përzier	ZSHP1	ZSHP1
	Shfrytëzim të përzier	ZSHP2	ZSHP2
	Shfrytëzim të përzier	ZSHP3	ZSHP3
	Banim me aktivitate përcjellëse	ZSHP4	ZSHP4

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

	Banim me aktivitete përcjellëse	ZSHP5	ZSHP5
	Banim me aktivitete përcjellëse	ZSHP6	ZSHP6
	Banim me aktivitete përcjellëse	ZSHP7	ZSHP7
Zonë industriale	Zonë Industriale	ZI1	ZI1
Zonë komerciale	Afarizëm tregti-Biznese	ZK1	ZK1
	Afarizëm tregti-Biznese	ZK2	ZK2
	Treg	ZK3	ZK3
	Pompë Benzine	ZK4	ZK4
Zonë e shërbimeve	Varezat	ZSH1	ZSH1
	Shkollë Filllore	ZSH2	ZSH2
	Shkollë Mesme	ZSH3	ZSH3
	Religjion	ZSH4	ZSH4
	QKMF	ZSH5	ZSH5
	Çerdhe	ZSH6	ZSH6
	Qendër për të moshuar	ZSH7	ZSH7
	Kulturë	ZSH8	ZSH8
	Institucione	ZSH9	ZSH9
	Infrastrukturë bazene ujore	ZSH11	ZSH11
Zonë rekreative-turistike	Park/shesh	ZrT1	ZrT1
	Sport/rekreim	ZrT2	ZrT2
	Hapësirë e gjelbërt	ZrT3	ZrT3
Zonë e komunikacionit- transportit	Autoudhë	ZKT	ZKT
	Hekurudhë	ZKT	ZKT
	Koridoret e mbrojtura të mbrojtura	ZKT	ZKT
Zonë e mbrojtur	Peizazh i Mbrojtur	ZM	ZM
Zonë bujqësore	Bujqësi	Zb	Zb
Zonë pyjore	Zonë pyjore	ZP	ZP
Sipërfaqe ujore	Lumë	SU	SU1
Sipërfaqe ujore	Liçe	SU	SU2
Zonë e mbrojtur arkeologjike historike	Zona Arkeologjike dhe arkitektonike	ZmaH	ZmaH
Zonë-minierë sipërfaqësore	Minierë/gurore	ZmS	ZmS

Tabela 30 Kushtet zhvillimore për zonat e banimit individual.

Prodhim primarë	ZB1	ZB2	ZB3	ZB4	ZB5		
Bujqësi	LV,N	LV,N	LV,N	LV,N	LV,N	1.1.2	1.1.1
Pylltari	N	N	N	N	N		
Minierë dhe gurore	N	N	N	N	N		
Akuakulturë dhe peshkim	LV,N	LV,N	LV,N	LV,N	LV,N	1.4.2	1.4.1
Prodhimtari parësore tjetër	N	N	N	N	N		
Prodhim dytësor							

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Industri e lëndës së parë	N	N	N	N	N		
Industri e prodhimeve të rënda	N	N	N	N	N		
Industri e prodhimeve të lehta	N	N	N	N	N		
Prodhim i energjisë	N	N	N	N	N		
Prodhim tjetër dytësorë	N	N	N	N	N		
Prodhim tretësor							
Shërbim tregtar	LD, LV, N	LD, LV, N	LD, LV, N	LD, L V, N	LD, LV, N	3.1.2/3	3.1.1
Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	LV	LV	LV	LV	LV	3.2.1- 3.2.5	
Shërbim i komunitetit	LD, LV	LD, LV	LD, LV	LD, L V	LD, LV	3.3.1	
Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	LD, N	LD, N	LD, N	LD, N	LD, N		3.4.2
Shërbim tjetër	LD	LD	LD	LD	LD		
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike							
Rrjetet e transportit	LD, N	LD, N	LD, N	LD, N	LD, N		4.1.3/4
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	N	N	N	N	N		
Shërbim publik	LV	LV	LV	LV	LV	4.3.1- 4.3.4	
Banim							
Banim i përhershëm	L	L	L	L	L		
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	LD	LD	LD	LD	LD		
Banim tjetër	LV	LV	LV	LV	LV	5.3	
Shfrytëzim tjetër							
Tokë kalimtare	LP	LP	LP	LP	LP		
Tokë e braktisur	LP	LP	LP	LP	LP		
Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	LP	LP	LP	LP	LP		
Hapësirë në të cilën të gjitha shfrytëzimet janë të lejuara	LP	LP	LP	LP	LP		
Hapësirë pa ndonjë shfrytëzim të specifikuar apo të planifikuar	N	N	N	N	N		
Hapësirë me shfrytëzim të panjohur	N	N	N	N	N		
L-Lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar							

Tabela 31 Kushtet zhvillimore për zonat e banimit kolektiv.

Lloji i funksioneve dhe aktiviteteve	Kushtet e shfrytëzimit				Hilucs3	
Hilucs2	ZB6	ZB7	ZB8	ZB9	LV	N
Prodhim primarë						

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Lloji i funksioneve dhe aktiviteve	Kushtet e shfrytëzimit				Hilucs3
Bujqësi	N	N	N	N	
Pylltari	N	N	N	N	
Minierë dhe gurore	N	N	N	N	
Akuakulturë dhe peshkim	N	N	N	N	
Prodhimtari parësore tjetër	N	N	N	N	
Prodhim dytësor					
Industri e lëndës së parë	N	N	N	N	
Industri e prodhimeve të rënda	N	N	N	N	
Industri e prodhimeve të lehta	N	N	N	N	
Prodhim i energjisë	N	N	N	N	
Prodhim tjetër dytësorë	N	N	N	N	
Prodhim tretësor					
Shërbim tregtar	LD,LV,N	LD,LV,N	LD,LV,N	LD,LV,N	
Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	LV	LV	LV	LV	
Shërbim i komunitetit	LD,LV	LD,LV	LD,LV	LD,LV	
Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	LD,N	LD,N	LD,N	LD,N	
Shërbim tjetër	LD	LD	LD	LD	
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike					
Rrjetet e transportit	LD,N	LD,N	LD,N	LD,N	
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	N	N	N	N	
Shërbim publik	LV	LV	LV	LV	
Banim					
Banim i përhershëm	L	L	L	L	
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	LD	LD	LD	LD	
Banim tjetër	N	N	N	N	
Shfrytëzim tjetër					
Tokë kalimtare	LP	LP	LP	LP	
Tokë e braktisur	LP	LP	LP	LP	
Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	LP	LP	LP	LP	
Hapësirë në të cilën të gjitha shfrytëzimet janë të lejuara	LP	LP	LP	LP	
Hapësirë pa ndonjë shfrytëzim të specifikuar apo të planifikuar	N	N	N	N	
Hapësirë me shfrytëzim të panjohur	N	N	N	N	
L-lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar					

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

HZK-ja duke u bazuar edhe në PZHK ka dhënë një List të Zonave të cilat janë formuar duke precizuar në mënyrë të sakt zonat sipas Udhëzimit Administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Të dhënat e Gjakovës janë strukturuar sipas grupimit tematik të emrave dhe temave të direktivës INSPIRE si në vijim:

1. Grupimi statistikor, do të përmban informata për njësitë statistikore, shpërndarjen e popullsisë, shëndetin e njeriut dhe sigurinë;
2. Grupimi atmosferik, do të përmban informata për kushtet atmosferike dhe të dhënat meteorologjike gjeografike;
3. Grupimi sipas shkencës së tokës, do të përmban informata gjeologjike, pedologjike, zonat me rreziqe natyrore, burimet minerale, burimet energjetike;
4. Grupimi sipas mbulueshmërisë dhe shfrytëzimit të tokës do të përmbajë informata për gjendjen e mbulueshmërisë dhe shfrytëzimit të tokës sipas klasifikimit Corine CLC, HILUCS dhe HRSC; z
5. Grupimi sipas hipsometrisë (MDR), do të përmbajë imazheve ajrore, modelin digjital relievor, sistemeve referuese koordinative dhe rrjetit gjeografik;
6. Grupimi sipas monitorimit dhe vëzhgimeve mjedisore, do të përmbajë informata për pajisjet mjedisore të monitorimit, vëzhgimit dhe matjeve;
7. Grupimi sipas biodiversitetit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura, do të përmban informata për zonat e mbrojtura, menaxhimin e zonave / kufizimin / rregullimi i zonave dhe njësitë raportuese, habitatet dhe biotopet, shpërndarja e specieve, rajonet bio-gjeografike;
8. Grupimi sipas ndërtesave, shërbimeve komunale dhe shërbimeve publike do të përmbajë informata lidhur me infrastrukturën e publike; dhe
9. Të dhënat topografike dhe referencat kadastrale, do të përmban informata për hidrografinë, emrat gjeografik, njësitë administrative, parcelat kadastrale, adresat, ndërtesat dhe rrjetet e transportit.

Tabela 32. Lista e Zonave Mbishtresore

ZONAT MBISHTRESORE	Kodi
Zonë Seizmike	ZmSh-A
Zonë e Vërshimeve	ZmSh-B
Zonë e Akuifereve	ZmSh-C
Zonë e Pasurive Minerare	ZmSh-D
Zonë mbishtresore Arkeologjike	ZmSh-E
Zonë e Trashëgimisë Natyrore	ZmSh-G
Zonë me Uranium të Varfëruar	ZmSh-H

HZK-ja zonat mbishtresore i ka përdorur për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte, dhe masave mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike, për definimin e zonave mbishtresor kemi analizuar në komplet territorin e komunës së Gjakovës se ku ka nevojë të: përcaktohen masa mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;

Janë përcaktuar masa mbrojtëse dhe parandaluese për Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;

Janë përcaktuar masa mbrojtëse për resurset lokale natyrore, si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, etj. të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;

Të përcaktohen masa mbrojtëse për ndikimet në mjedis, si: ndotja e ajrit, zhurmës, etj.;

Të përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmbytja, sipërfaqet sizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, ortekëve, tërmetet, e të tjera; dhe Standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për tu zbatuar në gjithë territorin e Komunës së Gjakovës

Gjatë analizës së hollësishme është konstatuar se zona sizmike, zona e vërshimeve, dhe disa zona tjera në Gjakovës të pasura me pasuri nëntokësore plotësojnë kushtet e trajtimit si zona mbishtresore.

X. MASAT E NEVOJSHME NË HZK PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Në analizën e terrenit është vërtetuar se në Gjakovës kemi problem me shtrirjen shumë disperse (objekte të shpërndara) dhe shtrirje lineare sidomos përgjat rrugës të ndërtimeve të cilat më tutje paraqesin problem në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, pastaj shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore sidomos në zonën përgjat magjistraleve.

Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës tregon destinimin për përdorim të tokës deri në vitin 2028. Këtu prezantohen edhe kufijt e rinjë ndërtimor dhe kushtet zhvillimor të përgjithshme, kushtet zhvillimore dhe masa tjera për zhvillimet. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me plleshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Kemi të prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nxehta mjedisor.

Konfliktet e mundshme për hapsira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshjeje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale. Gjatë procesit të hartimit janë organizuar takimet me komunitetin për të filluar këtë proces.

Zhvillimi dhe rritja e Gjakovës besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Gjakova aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal, komuna e Gjakovës me kushte zhvillimore nga HZK ka mundësi të akomodojë një numër shumë më të madh popullsie me

zgjerimin e kufinjëve ndertimore dhe turistëve me zgjerimin e kapaciteteve receptive turistike. Burimet ujore nuk janë të mjaftueshme. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Gjakovës nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financimet mëdha në infrastrukturën mjedisore. Plani i njeh këto probleme dhe përpiqet në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

Ndikimi në klimë

Komuna e Gjakovës vlerësohet se nuk ka indikacione se me aktivitetin aktual dhe atë që do të ketë në perspektivë të ndikoj në klimën globale, pasi që komuna e Gjakovës përpos disa industrive përpunuese të vogla nuk ka ndonjë industri apo objekt industrial që do të emitonte gazra të serrës në atë masë sa të ketë ndikim në klimën globale. Ndërsa si komunë është nën ndikim të ndotjes së ajrit nga komunat tjera dhe nga ndotja globale. Është e rëndësishme që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerë klimatik. Megjithatë komunikacioni hekurudhor dhe ai rrugor sidomos tani me ndërtimin e autostradave në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mikroklimën rajonale duke ndikuar edhe në ngritjen e temperaturave dhe praninë e ndotësve në ajër, ujë dhe tokë.

Mbrojtja e pyjeve, zonave të gjelbra ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja

Destinimet për shfrytëzim dhe të planifikuar të tokës të propozuara nga PZHK-ja dhe kushteve zhvillimore nga HZK-ja krijojnë mundësinë për struktura reja të pyjeve, kryesisht për përdorim të ndryshëm, kështu duke krijuar edhe habitate natyrore dhe mjedise atraktive. Komuna duhet që në kuadër të zbatimit të planit të ketë në prioritet projektet si:

- Projekte pyllëzimi konform HZK-së;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit;
- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Projekte për ndërtim të infrastrukturës si rrugët malore melorim dhe drenazhim për pyjet, etj.
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;

Cilësia e ajrit

Industria e pa zhvilluar në komunën e Gjakovës ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e ajrit, ndërkohë që zhvillime tjera pas luftës në Kosovë si komunikacioni, djegia e pa kontrolluar e mbeturinave, djegiet e biomasës, produkteve bujqësore lirim dhe gazrave azotike të cilat po përdoren kohëve të fundit në vend të karburanteve këto ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e ajrit në hapësira të ngushta siç janë fshatrat që ndodhen në luginë ku lëvizjet e masave të ajrit janë të vogla. Zhvillimet ekonomike dhe sociale pas luftës veçanërisht rritja e numrit të automjeteve kur dihet se pjesa më e madhe e tyre janë të stërvjetuara të viteve të 80-ta, poashtu edhe veprimtarive ndërtuese kanë shkakuar një ndotje të ajrit në Komunë. Në mënyrë të përbledhur po rendisim disa subfaktorë të cilat kanë ndikim në cilësinë e ajrit në komunën e Gjakovës.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

- Komunikacioni Rrugor ;
- Rritja e lartë dhe përdorimi i shpeshtë i makinave private;
- Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro V apo VI;
- Edhe pse të vjetër gjendja teknike e tyre jo e mirë, duke liruar gazra dyfish më shumë se normal;
- Gati të gjitha objektet përdorin ngrohje individuale me dru dhe forma tjera të djegies;
- Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë dhe me plin;
- Nga të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territor të komunës së Gjakovës, shumica janë të asfaltuar;
- Djegiet e mbeturinave në deponi të egra;
- Djegiet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Një tjetër problem që lidhet me cilësinë e ajrit është edhe cilesia e karburanteve që përdorin automjetet. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojnë me naftë të cilësisë së dobët. Megjithatë lidhur me këta të fundit, ndikimi i tyre në cilësinë e ajrit të komunës së Gjakovës është minimal.

Rrezatimi jonizues dhe jojonizues

Rrezatimi është trajtuar në përgjithësi ndërkoh që është fushë mjaft komplekse dhe që duhet të trajtohet gjatë hartimit të planeve në përgjithësi.

Në këto zona:

Duhet të identifikohet lokacioni i saktë i goditjes me armë me përmbajtje të uranimit të varfëruar;

Duhet të bëhen studimet e nevojshme të fushës përkatëse në mënyrë që të vërtetohet saktësisht zona e ndikimit apo kërcënimit nga rrezatimi;

Në rreze prej 500m nga lokacioni i goditur, nuk lejohet asnjë aktivitet i cili kërcënon jetën dhe shëndetin e qytetarëve, përveç nëse rezultatet e studimit rekomandojnë masa ndryshe.

Rrugët e propozuara

Rrugët kryesisht janë të propozuara nga PZHK, dhe PRRU, kurse Harta Zonale Komunale jep kushtet për zhvillimin e rrugëve dhe ndërtimin e tyre. HZK propozon një kategorizim të rrugëve lokale dhe ndryshim ose zgjerim të traseve të disa rrugëve regjionale dhe magjistraleve si dhe propozon unazën e jashtme komunale dhe unazën urbane, poashtu HZK përcakton edhe brezat mbrojtës rrugor. Pozita e Gjakovës është një territor tranzit në mes të qendrave nacionale por edhe ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, vjen në shprehje edhe infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli nacional dhe e cila ka impaktet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugët tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për ruajtjen e tyre.

Ndikimi i HZK-së në Ekosistemet natyrore

Në disa zhvillime të cilat janë planifikuar ka disa ndikime të cilat janë të kthyeshme dhe të riparueshme. Në HZK janë propozuar masa kundër zhurmës dhe masa kundër ndotjes në pjesët ku ndjeshmëria në ekosisteme është e lartë. Ekosistemet ku atakohen janë ekosisteme pyjore në

disa korie (zabele) dhe në disa pjesë ekosisteme lumore por që ndikimi nuk është shumë i madh. Ndërkaq Plani parashe edhe projekte të cilat kanë ndikim pozitiv në ekosisteme siç shihen në hartat më posht.

Masat dhe kushtet për mbrojtjen e komponenteve kryesore mjedisore

Secili projekt dhe zonim dhe kushte të dhena zhvillimor dhe të përgjithshme dhe kushte tjera si dhe masat janë vlerësuar duke u bazuar në shkallën e ndjeshmërisë së komponenteve mjedisore ne komunën e Gjakovës.

Efektet kumulative

VSM-ja nuk do të kufizohet vetëm në analizën e elementeve individuale të planit, por duhet të bëjë gjithashtu edhe një vlerësim të përgjithshëm në vazhden e të gjitha aktiviteteve dhe politikave të cilat përfshihen në HZK-n e Gjakovës.

Në këtë Raport ndikimet mjedisore kumulative percaktohen si një kombinim i ndikimeve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit. Gjatë implementimit të zhvillimeve të planifikuara të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vleresohen impaktet mbi token, ajrin dhe faktorët klimatike, biodiversitetit impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të HZK-së shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- Ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- Burimet natyrore si burimet ujore, minerale dhe resurseve tjera të cilat kombinohen;
- Token, zona toke bujqesore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen si efekte;
- Faktorët klimatik, shkarkimet e gazeve serrë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatik, impaktet kumulative si shumë e impakteve të të gjithë veprimeve të HZK-së janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore:

- Shkarkimet limiteve të ndotësve
- Menaxhimin e mbetjeve inerte dhe
- Masia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serre.

Në vlerësimin e impakteve mbi ujin, natyren, trashëgimie kulturore dhe peisazhin, efekteve kumulative zakonisht nuk mund të shprehën si një shumë e impakteve të të gjithë veprimeve për të arritur zhvillimet përmes kushteve zhvillimore në HZK-së. Kur vleresohen efektet kumulative në aspektet e permendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në efektet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe ne distance) dhe kohës (afat-shkurter, afat-mesem dhe afat-gjate, perkohesisht dhe permanent) të efekteve.


Nëse vleresohen efektet mbi shëndetin njerëzor, efekti komulativ të HZK-së shprehen si efekte të kombinuara kumulative dhe zakonisht referohen për:

- Zvoglimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të bezdisjes akustike;
- Zvoglimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- Masat e marrura në HZK që lehtësojnë veprimtari shlodhëse dhe rekreative në një mjedis.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026


Kur vleresohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të HZK-së shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për zhvillimin e kushteve zhvillimore të HZK-së janë positive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse efektet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

Në vlerësimin e efekteve komulative në larmaninë biologjike të llojeve organike (biodiversitet) në zhvillimet e planifikuara shprehen si efekte të kombinuara duke rritur impaktin në biodiversitet, mirëpo me masat që janë marr me HZK efekti do të jet më i zbutur deri te efekti pozitiv për biodiversitetin.



Harta 10. Ndikimi i HZK-së në ekosistemet natyrore

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026



Harta 11. Parashikimi i ndikimeve të HZK-së në aspektin hapësinore.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Tabela 33. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të HZK-së në komponentet mjedisore

Komponentet mjedisore	Elementete e HZK-së					Vlerësimi i efekteve kumulative
	Kushtet Zhvillimore për rrugët e planifikuara	Autostradat dhe hekurudha	Kushtet Zhvillimore për Zonat e planifikuara të ndërtimeve	Kushtet Zhvillimore për Zonat ekonomike dhe industriale	Kushtet Zhvillimore për Pyllëzimi dhe bujqësi	
Ndryshimet klimatike	0	-	+	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Ndotja akustike	-	-	+	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Burimet natyrore	+	0	0	+	+	Pozitive
Toka	+	0	+	-	+	Pozitive
Uji	+	0	+	0	+	Pozitive
Ajri	+	-	+	0	+	Pozitive
Biodiversiteti	0	-	0	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës

XI. PROBLEME TË MJEDISIT NË GJAKOVË DHE PËRGJIGJA QË JEPET PËRMES KUSHTEVE ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME, KUSHTEVE ZHVILLIMORE DHE MASAVE NË HZK

Tabela e mëposhtme bënë një përmbledhje të problemeve mjedisore që u identifikuan në Kapitullin më lart dhe të shkallës në të cilën HZK-ja i u përgjigjet atyre, duke sugjeruar njëkohësisht edhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

Tabela 34 Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas HZK-së

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Propozimet për kushtet zhvillimore për HZK per destinimet dhe skenaret e zhvillimeve ne PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
1. Cilësi e ajrit.	Aktiviteti ndërtimor i pakontrolluar; Rrugë të pashtuara; Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve; Karburante të cilësisë jo të mirë; Gjeneratorë me naftë; Ngrohjet individuale.	Të gjitha shkaqet e përmendura e ulin cilësinë e ajrit edhe pse kjo komunë është e mbuluar mjaft me vegjetacion.	Nuk ka të dhëna që provojn këtë lidhje për sëmundjet, apo ndonje sëmundje tjetër që vjen si rezultat i cilësisë së ajrit.	Propozimet për pyllëzim Propozimet për shirita gjelbrues Propozimet për transportin publik dhe ciklizmit ka si qëllim ngadalësimin e rritjes së numrit të makinave private dhe reduktimin e ndotjes së ajrit të disa zonave të komunës. Rrugët e reja të cilat duhet të lehtësojë trafikun nëpër vendbanime.	Duhet të bëhen studime mbi pyllëzimin; Duhet të bëhen studime mbi transportin; Përdorimi i karburanteve më të pastra (përmbajtje e squfurit të bjerë); Përmirësimet e rrugëve nga Komuna e Gjakovës në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës.	Studim për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së dëmshme të ajrit në shëndetin publik dhe në ekonominë në tërësi; Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar ndotjen; Shtrimi i rrugëve, përmirësimi i trafikut edhe futja e korsive të biçikletave; Edukim më i mirë i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit; Përmirësimi i furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve; Vendosja e kriterëve strikte për pyllëzimin; Vendosja e kriterëve strikte për cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore).

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

<p>2. Cilësi jo e mirë e ujit të lumenjve</p>	<p>Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura fekale dhe mbetjeve industriale që shkaktohet nga mungesa e sistemit të grumbullimit dhe trajtimit adekuat të ujërave të ndotura.</p>	<p>Ndikim në shëndetin e popullatës njerëzore, humbje e flores dhe faunes në ekosisteme ujore (mikrozoobentosit dhe makrozoobentosit); Ndotja e rezervave të ujërave nëntokësorë.</p>	<p>Ndikon në sëmundjet infektive, sëmundjet tjera të cilat lidhen me përdorim të ujit dhe përmes zingjirit ushqimor.</p>	<p>Skenari i zhvillimit të PZHK në përputhje me studimin e Planit hapësinor të Kosovës. Vendi i identifikuar për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura është në përputhje me Planit hapësinor të Kosovës pjesa e trajtimit të ujërave të ndotura. Trajtimi i përkohshëm dhe sipas zonave I ujrave të ndotura. Kurse HZK jep kushte duke u bazuar në kete koncept</p>	<p>Përgatitja e Projekteve Sektoriale për Trajtimin e ujërave të zeza të Gjakovës</p>	<p>Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla që do të shoqerohet edhe me minimizimi i rrjedhjeve. Maksimizimi i lidhjeve. Rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Reduktimi i përdorimit të gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave, dhe ndertimi i impiantit të planifikuar.</p>
<p>3. Cilësi dhe sasi jo e kënaqshme e ujit të pijshëm</p>	<p>Humbje në sistem të furnizimit, tubat jo të cilësisë së duhur dhe mungesa e kontrollit të ujërave</p>	<p>Ndotja e ujërave nëntokësore Konsum i ujit në shishe dhe gjenerimi i mbetjeve plastike.</p>	<p>Shpërthim i sëmundjeve gastro-enterike, por lidhja e qartë nuk është provuar nga të dhënat shëndetësore.</p>	<p>Skenari i zhvillimit i PZHK përputhet me studimet e mëhershme për cilësinë dhe sasinë; Në PZHK janë parashikuar edhe përfshirja e infrastrukturës për shkak të interferencave që ka.</p>	<p>Duhet përgatiten projektet Sektoriale përkatës dhe trajtohet mundësia e financimit.</p>	<p>Zvogëlimi i humbjeve në rrjet. Shmangia e intersektimeve me linjat e ujrave të zeza. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme. Përgatitja e projekteve për të shkuar drejt furnizimit të vazhdueshëm me ujë; Mbrojtja e burimeve mbi sipërfaqe, eliminimi i shfrytëzuesve individual të burimeve ujore.</p>

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

<p>4. Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave</p>	<p>Mungesa e një sistemi reduktim-ripërdorim-riciklim për mbetjet e ngurta në nivel të Komunës së Gjakovës Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera. Nëse vazhdohet me këto ritme Gjakovës do të ketë disa deponi ilegal brenda viteve të ardhshme. Mbetjet ndërtimore, dhe ato të tjera përzihen me mbetjet komunale.</p>	<p>Komuna gjeneron sasi të konsiderueshme të mbetjesh të ngurta. Në disa vendëbanime të Gjakovës pamjet e mbeturinave mbeten të shëmtuara. Në komuna, sidomos në shtratin e lumit Erenik, Krena dhe Drini i Bardh dhe perroskat por edhe në lumenjt tjer pamja është shumë e shëmtuar. Mund të jenë burim semundjesh veçanërisht në stinë e nxehtë.</p>	<p>Djegia e mbeturinave shton ndotjen e ajrit. Personat që jetojnë pranë ktyre deponive dhe her pas here kontrollojnë mbetjet janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme në zona afër dhe në disa raste edhe brenda vendbanimeve të komunës së Gjakovës</p>	<p>HZK sugjeron adoptimin e një sistemi të integruar të administrimit të mbetjeve në bashkupunim me kompaninë regjionale, bazuar në itinerarin reduktim-ripërdorim-riciklim-rekuperim. HZK përmend riciklimin, selektimin, por nuk tregon për vendet apo zonat se ku do të grumbullohen selektohen dhe riciklohen mbeturinat në të ardhmen.</p>	<p>Duhet përgatitet Projekti Sektorial përkatës me mundësi financimi; duhet të propozoj vendet për deponim të përkohshëm në të cilat mundë të bëhet selektimi, grumbullimi dhe riciklimi i mbeturinave.</p>	<p>Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal. Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin. Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme. Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohëshme drejt asaj regjionale njëjtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina. Zbatimi i projekteve për pika grumbullimi në sistemin e stacioneve të transferit .</p>
---	--	---	---	---	---	--

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

<p>5. Rehabil-itimi /Inkapsulim i pikave te nxehta të ndotjes</p>	<p>Ndotja e tokes nga aktivite e ndryshme ekonomike dhe bujqësore</p>	<p>Ndotja e tokes dhe ajrit nga perberje të demshme per shëndetin e njeriut dhe biodiversitet</p>	<p>Ne vartesi te lendeve ndotese,mund të shkaktojnë një game të gjerë semundjesh</p>	<p>Propozohet të studiohen të gjitha hapësirat,zonat me rrethinë ku janë zhvilluar industritë të vogla ose edhe sot ku pjesërisht funksionojnë në territorin e komunës së Gjakovës që kane perdorur ose gjeneruar kimikate te rrezikshme per shendetin, para,gjatë edhe pas viteve 90-ta dhe mbi bazen e shkalles se rrezikut të behen nderhyrja teknike</p>	<p>Te mblidhet informacione më të thelluara për këtë gjendje, per nivelin dhe llojin e ndotjes,për ndikimet në tokë,ujë ajrë egzistencen e lidhjeve të territoreve te ndotura me kërcnimet për shëndetin,llojin e kërcnimit të bëhen analiza ne terren dhe laborator, të trajtohen me HZK vendet ku është goditur me Uranium të Varfëruar gjat luftës së fundit në mënyr që në të ardhmen të bëhen studime lidhur me ndikimin në mjedis të këtyre zonave dhe të bëhet inkapsulimi apo izolimi i këtyre zonave nëse është e nevojshme.</p>	<p>Plani i menaxhimit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta bazuar edhe në studim,analiz dhe VNM të detajuar; Masat adekuate për shëndetin e njerëzve; Masat tjera për konsolidim të tokës,mbrojtje të ujit dhe cilësisë së ajrit dheBiodiversitetit dhe ekosistemeve tjera.</p>
--	---	---	--	--	---	--

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

<p>6. Shtrirja e ndërtimeve</p>	<p>Nevojat për banim; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar brenda dhe rreth vendbanimeve sidomos nëpër terrene me tokë të plleshme bujqësore dhe ato kodrinore.</p>	<p>Humbje e tokës së plleshme dhe gjelbrimit e pemëve të ndryshme, humbje e shtresës së sipërme të tokës, rrjedhje dhe mundësi për rrëshqitje/ përmytje. Humbje e vlerave estetike. Humbje e vlerave peizazhistike të teritorit komunal.</p>	<p>Jo i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm; Por shtrirja pa përcjellë me infrastruktur normal që shkakton edhe pasoja në shëndet; Edhe rrëshqitjet e mundëshme të tokës dhe përmytjet mund të shkaktojnë dëme serioze për jetën dhe pronën. Edhe humbja e gjelbrimit ka ndikimin e vetë në shëndetin e njeriut.</p>	<p>Planifikohet kushte zhvillimore për kufirin ndërtimor për të gjitha vendbanimet; Standartet dhe normat e planifikimit të përdorura në HZK bëhen automatikisht të vlefshme; Për të gjitha vendbanimet në Komunë. Parqe,zona të gjelbra rreth disa vendbanimeve</p>	<p>HZK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor rreth vendbanimeve statusin e zonave ku nuk lejohet ndërtimi; HZK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të ndërtimit të marrin statusin e parkut,zones së gjelbërt</p>	<p>Të përgatitet ekipi dhe një plan i Menaxhimit të ndërtimeve; Të përgatiten projekte për gjelbrim dhe parqe Moratoriumi për ndërtimet duhet të shtrihet edhe në gjitha zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor. Është e nevojshme të hartohen Plane Rregulluese edhe për vendbanimet në konceptin e zhvillimit me nënqendra.</p>
<p>7. Degradimi i pyjeve,</p>	<p>Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve; Djegëjet e pyjeve; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i disa vendbanimeve.</p>	<p>Ndotja e ajrit; Ndotje e ujit, mungesë e kënaqësisë si për rezidentët ashtu edhe për vizitorët. Erozini në shkall të lart dhe prishje e balancit natyror.</p>	<p>Ndotja e ajrit edhe e ujit kan ndikim dhe pasoja në shëndet;</p>	<p>Revitalizimi i pyjeve ekzistuese; Propozohen mbulim me fidane të reja sipërfaqet e zhveshura; Dhe parqe tjera të reja në disa vendbanime.</p>	<p>Projekte konkrete pyllëzimi, revitalizimi,sanim për pyjet e Gjakovës, në zonat e parapara me HZK. Përgatitja e projekteve për shfrytëzimin e burimeve tjera alternative për ngrohje dhe energji tjera në mënyr që mos të shfrytëzohet druri për djegie.</p>	<p>Ngritja e një mekanizmi bashkpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte; Kushhtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjelbrim dhe tampon zona; Aktivizim i gjykatave,policis inspektorëve në mënyr cilësore. Në ish venddepozitimet legale dhe ilegale masat rehabilituese dhe ri gjelbrim ose rivitalizim të atyre ekosistemeve.</p>

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

<p>8. Degradimi i lumenjve, eksploatimi i rërës dhe Zhavorit, Gurëthyesit dhe degradimi natyror i tokës</p>	<p>Ekspluatimi i rërës dhe zhavorit nga lumenjt e Gjakovës sidomos nga lumi i Drinit të Bardhë, Erenik, Kren ka shkaktuar edhe dëmtimi i ekosistemit lumor. Degradimi i pjesëve të ndryshme të tokës gjat eksploatimit të gurëve nga gurëthyesit dhe shitësit e gurëve për dekorim.</p>	<p>Degradim i shtratit të lumit, dëmtim i faunës që si habitat kanë lumin apo lumin e përdorin si burim ushqimi, prishja e zingjirit ushqimor, degradim i tokës, pyjeve dhe hapësirave me pesazhe të bukura duke i shëndrruar në hendeqe të pa këdëshme.</p>	<p>Natyrshtëm ka ndikim në shëndet të popullatës njerzore dhe organizmave tjerë.</p>	<p>HZK ka trajtuar ndotjen që vjen nga gurthyesit, duke lënë hapësirë për trajtim të mëtutjeshëm në të ardhmen.</p>	<p>Duhet të parashihen masa për kthimin në gjendjen e më parshme të vendeve ku janë nxjerrur gurët, kurse te lumenjt të të rregullohen shtretit e tyre dhe të ndërpritet eksploatimi i rërës dhe zhavorit nga shtrati i lumit.</p>	<p>Në bashkpunim me nivelin qendror të merren masa për rehabilitimin e vendeve ku është eksploatuar. Të rregullohen argjinaturat e lumenjve dhe të parandalohen hudhjet e mbeturinave dhe kanalizimeve në lumenj.</p>
<p>9. Humbje e trashëgimisë së ndërtuar</p>	<p>Zhvillimet me tendencë të ndryshme nëpër vendbanime nuk janë në harmoni me arkitekturën ekzistuese.</p>	<p>Humbja e disa nga karakteristikat unike të vendbanimeve, cenim i identitetit dhe e kujtesës historike, kryesisht hubja e objekteve të trashëgimisë kulturore karakteristike për këtë zonë.</p>	<p>Të dhëna të pa disponueshme por aspektin psikologjik dhe shpirtor mendohet se do jetë prezent.</p>	<p>Identifikon zonat brenda studimit të cilat do të ruhen. Propozon masat për ruajtjen. E orienton presionin për ndërtime drejt vendbanimeve dhe zonave më pak të pasura me këtë lloj trashëgimie</p>	<p>Identifikimi i instrumentave ekonomike dhe të valorizimit të territorit (psh, itinerare apo shtigje kulturore) që mund të bëhen mbështetje për komunitetet autoktone të Gjakovës që banojnë në këto vendbanime dhe zona.</p>	<p>Zgjerimi dhe mbajtja/pasurimi i listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat, ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimisë së ndërtuar</p>
<p>10. Rrezik për tërmet, rrëshqitja e tokës, vërshimet</p>	<p>Sikurse i tërë territori i Kosovës edhe Gjakovës bënë pjesë në zonë sizmike</p>	<p>Varsisht por dine të jetë me ndikim të lartë mjedisor sidomos nga</p>	<p>Mund të rezultojë në katastrof</p>	<p>HZK përmes kushteve shtesë në Zonat mbishtrësore paraqet në mënyrë specifike zonat e</p>	<p>HZK duhet të tregoj dhe paraqes grafikisht për zonat të cilat janë në ndikim të rreziqeve të përmendura.</p>	<p>Studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmikenë rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet patur parasysh</p>

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

dhe element tjer rreziku	aktive të nivelit mesatar; Ka erosion e burime tjera rreziku.	ndikimet indirekte		rrezikuara nga tërmetet, nuk tregojnë për zonat ku ka erozion dhe shkarje dheu dhe çfarë shkalle si dhe nuk tregojnë por zonat të cilat janë nën ndikim të vërshimeve dhe mbytjeve.	Komuna duhet të ndërtojë brenda standarteve të larta anti-sizmike,	raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.
11. Rreziqe nga uraniumi.	Hedhja e predhave nga NATO-ja gjat luftës në Kosovë në baze të informatave ka edhe lokacione mbrenda territorit të Gjakovës	Mund të shkaktoj probleme të shumta shëndetësore, por më kryesore është kanceri.	Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj radioaktivitetit mund të shkaktojë kancer.	Është trajtuar me HZK.	Kërkohen studime dhe hulumtime shtesë për të përcaktuar rrezen e veprimit	Duhet të bëhen studime të mëtejme në nivel vendi dhe sipas nevojës do duhej hartuar strategji e veçant për këtë problematikë.
12. Rreziqe nga Zjarret.	Shkatërimi i pyjeve, rrezikimi i pasurisë dhe pronës së qytetarëve, ndotja e ajrit.	Shkatërimi i pasurisë qytetare duke djegur pronën dhe pasuritë tjera të paluajtshme.	Rrezikimi i jetës së qytetarëve dhe pasurisë.	Bëhë identifikim të zonave me probabilitet të zjarrndezjes dhe krijon kushte që zjarret të menaxhohen më lehtë.	Duhet ndërhyrje bonifikuese në ndërtesat me përmbajtje amianti - asbesti.	Duhet bëhen studime të mëtejme mbi shkaqet e zjarrvënjes, kohën dhe lokacionet më të atakuara.
13. Rënie e biodiversitetit dhe humbje e florës dhe faunës.	Rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimet me karakter ndërtimi po shkaktojnë humbje në pyje dhe habitat. rritje e ndotjes, zhurmës dhe forma tjera të bezdisjes dhe gjuetia e pa kontrolluar.	Nuk njihet plotësisht, por ka probleme të përgjithshme të humbjeve ekologjike. Rënie e efektit zbutës të florës për gjurmën e karbonit në disa zona të komunës	Humbje e zingjirit ushqimor, Aspekti kulturor, shkencor dhe rekreativ. Ndikim negativ në gjendjen psikologjike të banorëve.	Përkufizimi i ndërtimit është propozim i drejtpërdrejtë, dhe ulja e zhvillimit të çrregullt të vendbanimeve do të sjellë edhe uljen e humbjes në biodiversitet.	Projekte të asistuar nga BE, me qëllim fuqizimin e monitorimit të mjedisit në komunë duhet zhvilluar studime të situatës.	Nevoja për të pasur një studim bazë për biodiversitetin me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitetin dhe inventarizimin e florës dhe faunës, mundësitë për përmirësimin e situatës.

Draft Raporti i VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Gjakovës 2022 - 2026

<p>14. Zonat e ndikimit të aktiviteteve në Gjakovës</p>	<p>Të gjitha problemet e lartpërmendura, por nuk ka informacion të detajuar mbi ndikimin</p>	<p>Ndotje e lumenjve, ajrit dhe tokës</p>	<p>Nuk dihen në hollësi por nënkuptohen</p>	<p>Jashtë studimit, por problemet janë të njohura, sidomos rritja vendbanimeve dhe zhvillimet tjera industrial dhe ndërtimore.</p>	<p>Projekte të asistuar nga MMPH, BE etj për identifikimin e nivelit të ndikimit dhe zones së veprimit loka, komunal, kombëtar ose edhe ndërkombëtar</p>	<p>Nevoja për të pasur një studim bazë për Gjakovën me qëllim identifikimin e ndikimit të aktiviteteve në zona dhe mundësitë për përmirësimin e situatës</p>
<p>15. Ndotje akustike në Gjakovë</p>	<p>Komunikacioni hekurudhor, qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët maxhistrale dhe regjionale mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, numri i lartë i automjeteve private për shkak të mosefiçensës së transportit publik, ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standarteve, cilësia e ulët e automjeteve.</p>	<p>Nivel i lartë i zhurmës në vendbanimet pran arterieve kryesore rrugore, hekurudhore si dhe zonat turistike.</p>	<p>Efekte kronike dhe akute në sistemin e dëgjimit, dhe dëmtim i sistemit nervor.</p>	<p>Krijimi i një rrjeti më të disiplinuar dhe më të mirë rrugor.</p>	<p>Edukimi qytetar për mosshkaktimin e ndotjes akustike. Aplikimi në ndërtimet ekzistuese dhe të reja të materialeve izolues të zhurmave.</p>	<p>Masa të karakterit rregullator për standartet e mjeteve që lëvizin në komunë dhe penalitetet ndaj shkaktuesve të zhurmave në vendbanimet e Gjakovës. Përmirësimi i transportit publik; Krijimi i barrierave me bimësi aty ku është e mundur anës rrugëve si dhe pengesa tjera të përshtatëshme.</p>

MONITORIMI

MONITORIMI

E njejta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktives se BE për VSM-n. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPHI-ja nëpërmjet AKMM Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Me qëllim që HZK-ja të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruar edhe më sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qenë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutuese të HZK-së. Plani Monitorimit përmbledh shumë treguesë që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kësaj ndermarrje kërkon angazhimin e mjaftë institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbeshtetur në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Gjakovës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të HZK-së. Këtu përfshihen qoftë Planet, projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i HZK-së në Plane Rregulluese për vendbanimet me nënqendra, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Gjakovës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerezore dhe financiare të gjithë këto veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar Drejtorin e Planifikimit e Mjedisit dhe struktura të tjera në vartësi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilësine e ndertimeve, ecurine e pyllzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, ecurine nderimit të rrugëve të reja përfshirë ato për qarkullimin me bicikleta dhe të tjere indikatorë që janë paraqitur në programin e monitorimit të HZK-së.

Rezultatet e monitorimit, në Komunën e Gjakovës sipas ligjit për VSM-n, duhet të publikojnë në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjera të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM, për monitorimin dhe rezultatet të përcillenë komunës së Gjakovës dhe Agjensise Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor të publikojnë në kuadrin e Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Receptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtjes së Mjedisit	Synimi	Indikator	Raportimi	Institucioni pergjegjes
Shendeti i banoreve	Promovimi per krijimin e nje komune të qendrueshem dhe të shëndetshme	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem konform stand. te BE ujrut sipërfaqore dhe nentokesore destinuar per uje te pishem 2. Cilesia e ujit te pishem konform standardit 3. Dendesia e popullsisë e qendrushme në vendbanimet me trend të rritjes së popullsisë	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem, kundrejt standardit te BE. 2. Cilesia e ujit te pishem ne perputhje me standardin 3.Dendesia mestare për këto vendbanime	1. Rap.Vjetor 2. Rap.Vejtor 3.Rap.Vjetor	1. Drejtoria per Urbanizëm dhe Planifikim dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. 2 Drejtoria per Urbanizëm 3. Komuna e Gjakovës
G	Ruajtja e llojeve të cilat janë në rrezik të zhdukjes nga aktiviteti njerzor	1. ndalimi i gjuetis së egër 2. marrja emasave per mbledhesit e bimeve mjekuese 3.Rehabilitimi i siperfaqeve te pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra ne zonat e banimit 5. Krijimi i korridoreve të gjelbra dhe tampon zonave	1. Siperfaqet e reja te krijuara, sip. m ² 2. Siperfaqe te reja, m ² 3.Siperfaqet te rehabilituara, m ² 5. Siperfaqe te kthyer ne zone te gjelber, pjese e koridorrit dhe tampon zona; m ²	1. Raportim 1 here vit 2. Raportim 1 here ne vit. 3. Raportim 1 here ne vit 4. Raportim 1 here ne vit 5. Raportim 1 here ne vit	1. Komuna e Gjakovës dhe MMPHI 2. Komuna e Gjakovës dhe MMPHI 3. Komuna e Gjakovës dhe MMPHI 4. Komuna e Gjakovës dhe MMPHI & MBPZHR 5. Komuna e Gjakovës dhe MMPHI & MBPZHR dhe Ministria e Infrastrukturës
Ajri	Permiresimi i cilesise se ajrit	1. Ulja e niveli te ndotjes se ajrit per: NOx; CO2 ; O3, PM10. 2. Rruge te asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelt te zhurmave ne zonat e ndjeshme ndaj zhurmave 4. Aplikimi ne banesat e reja i materialeve termizolues dhe mbrojtje akustike	1. Arritja e vlerave te standardit per cilesin e ajrit lidhur me tregusit mbi norme 2. Gjatesia e rrugeve te asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmes gjate dites dhe nates 4. Ulja e niveli te zhurmave ne mjediste e banimit	1. Raportim 1 here ne 6 muaj 2. Raportim 1 here ne vit 3. Raportim 1 here ne 6 muaj 4. Raportim 1 here ne vit	1. AMMK dhe Komuna e Gjakovës 2. Komuna e Gjakovës 3. Komuna e Gjakovës 4. Komuna e Gjakovës
Faktoret klimatik	Kursimi i, energjise dhe paksimi i emisioneve te gazeve serre	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat. 2. Promovimi i paneleve diellor per gjenerim energjie ne ndertesat residenciale dhe sociale dhe energjia e	1. Siperfaqja e objekteve (m ²) me izolim adekuat 2. Siperfaqja (m ²)e paneleve te instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Gjakovës 2 Komuna e Gjakovës

		krijuar nga era	nga energjia e erës (m ²)		
Uji	Cilesia e ujrave sip. ne perputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives kuadre per ujin te BE	1.Shmangia e shkarkimeve te ujrave te ndotura ne Lumenj 2. Sigurimi i hudhjeve të mbeturinave në lumenj. me qellim ruajtien e niveleve minimal të ndotjes	1a. Vellimi i ujrave qe shkarkohen ne Lumenj; 1b. Vellimi i ujrave mbi normat e lejuara qe shkarkohen Lumenjë; m3. 2. Siperfaqia e ndotjes (m ²) vllimi i mbeturinave (kg ose m ³) ,lloji mbeturinave shkruhet emir i saktë i mbeturinave të forta të gjetura në shtrat të lumit	1.Dy here ne vit 2. Dy here ne vit	1. Komuna e Gjakovës , AMMK. 2. Komuna e Gjakovës dhe AKMM
Mbetjet	3)Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi qendrueshem i tyre b) Shnderrimi i pikave te nxehta mjedisore ne siperfaqe te gjelbra/parqe ose zona residenciale	a.1. Pakesimi ne burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa konteniere per ndarjen ne burim te mbetjeve urbane b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i pikave te nxehta ne territoret te mbyllura	a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara. a.2. Numri i residenteve qe mbuloohen nga sherbimi me kontenier b.1. m ² te rehabilituara ose inkapsuluara	a.1. 1 here ne vit a.2. 1 here ne vit b.1. 1 here ne vit	a.1. Komuna e Gjakovës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjesisht AKMM a.2 Komuna e Gjakovës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjesisht AKMM b.1. Komuna e Gjakovës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjesisht AKMM
Rrugjet dhe Transporti	Reduktimi i intesnsitetit te trafikut nepermjet promovimit te transportit publik, qarkullimi me bicikleta ku mundet me ndodhë	1.Zgjerimi i rrjetit rrugor per trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive per bicikleta 3. Ndertimi i rrugeve te reja me hapsira te pershtatshme trotuaresh (perfshire korsite e bicikletave). Zgjerimi i trotuareve gjate rehabilitimit te rrugeve ekzistuese. 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugeve lokale	1. Km rruge shtese qe mbuloohen nga trafiku urban. 2. Km korsit shtese per levizje me bicikleta. Numuri i bicikletave ne qarkullim. 3. Km rruge te reja dhe te rehabilituara. m ² trotuare dhe korsit bicikletash te shtuara. 4. Km rruge lokale te rehabilituara ose/dhe asfaltuara	1.1 here ne vit 2. 1 here ne vit 3. 1 here ne vit 4. 1 here ne vit	1. Komuna e Gjakovës ,Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 2. Komuna e Gjakovës . 3. Komuna e Gjakovës , Ministria e infrastrukturës dhe MMPHI 4. Komuna e Gjakovës .
Trashegimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtja e vlerave te kulturore, perfshire ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirembajtja dhe ruajtja e objekteve te trashegimise kulturore	1.Numri i objekteve/ndertesave me status mbrojtjes 2. Numri i objekteve/ndertesave te restauruara	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Gjakovës Instituti për mbrojtjen e Monumenteve 2. Komuna e Gjakovës Instituti për mbrojtjen e Monumenteve

Trashëgimia natyrore dhe zonat e mbrojtura	Mbrojtja e vlerave të trashëgimis natyrore, llojeve të cilat janë në listën për mbrojtje	Promovimin e vlerave natyrore rekreative, turistike dhe shkencore të këtyre zonave dhe rendesisë së llojeve të cilat janë në Listën për mbrojtje.	Gjetja e formave për sensibilizim dhe kërkime shkencore me të shumta.	1 here ne vit	Komuna e Gjakovës , Ministria e MMPH-ja dhe instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
Peizazhi, pyjet dhe toka	1.Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror ne hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Riperdorimi i tokave te ndotura 4.Mirmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5.Kultivim i pyjeve të reja.	1. Shtimi i hapësirave të reja dhe numurit të pemeve e shkurreve. 2. Dhenie e statusi mbrojtje dhe hartimi i nje plani manaxhimi mjedisor i ktyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave te ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe venia ne efciense per zona te gjelbera/parqe ose rezidenciale 4 ..Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5. Pyllëzimi I hapësirave të zhveshura	1. Sipërfaqet ne m ² dhe numuri i pemeve te mbjella 2.Progresi i zbatimit te planit 3. Sipërfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m ²) dhe e vene ne perdorim sipas HZK. 4. Sipërfaqe toke së zhvilluar pyjore (ha) 4. Sipërfaqe toke së re pyjore (ha)	1.Një here ne vit 2. Një here ne vit 3. Një here ne vit 4. Një here ne vit 5. Një here ne vit	1. Komuna e Gjakovës 2. Komuna e Gjakovës 3. Komuna e Gjakovës 4. Komuna e Gjakovës dhe MBPZHR 5. Komuna e Gjakovës dhe MBPZHR

PERFUNDIME

Gjakova shikuar edhe nga aspekti mjedisor në nivel të komunave të Kosovës është vend mjaft atraktiv, për të jetuar, vepruar dhe për të zhvilluar aktivitete tjera jetësore. Është toka kualitative, peizazhet e bukura si Malet e Sharrit me biodiversitetit, ekosistemeve të veçanta, shtrirja e mbulesave vegjetative nga nivelet me të ulëta deri te zona mesatare. Padyshim që hartimi dhe zbatimi i HZK-së dhe sugjerimeve të cilat u dalin nga VSM-ja në përgjithësi do të kenë ndikime pozitive në mjedis dhe do të paraqesin përpjekjet më serioze për baraspeshë mjedisore në këtë Komunë .

Duke analizuar HZK-në Gjakovë shihet qartë se HZK-ja prezanton një profil, koncept të zhvillimit hapësinor, Vizion, prioritete strategjike, strategji e masa zbatimi, në HZK vërehen edhe përpjekje për të orientuar rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të Gjakovës bazuar edhe në disa shembuj të përkufizimit të zonave të ndërtimit (jo në definim të zonave në bazë të analizave profesionale) e me qëllim dendësimin në zonat që janë ende në proces zhvillimi dhe kanë synim zgjerimi edhe në zonat e reja të banimit duke marrë parasysh edhe shërbime të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Gjakovës

HZK-ja ka rrol përmbytësor edhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë së ndërtimeve. HZK-ja dhe sugjerimet që dalin nga VSM duhet të ndikojnë pozitivisht në revitalizimin e ekosistemeve të degraduara, ripyllëzimin e zonave të zhveshura, pyllëzimin e disa zonave që vazhdimisht janë nën ndikimin e erozionit. Pozitivisht do të ndikoj edhe në ruajtjen e zonave të pasura me ujëra nëntokësore, ekosistemeve të lumenjve nga degradimi dhe nga ndërtimet në brigje të lumenjve.

Gjatë hartimit të VSM-së kemi hasur disa sfida por ndër ato kryesore gjatë hartimit të VSM-së ka qenë, nga se në HZK bazuar në harta, informata, hulumtime, analiza profesionale dhe ligje nuk janë definuar tregues numerik ose kualitativ për disa pika,vija dhe sipërfaqe të rëndësishme për trajtim adekuat të aspektit mjedisor të planit, vlen të vihet theksi në zonat e zhvillimeve të reja të infrastrukturës (korridorët rrugore, hekurudhore), zona industriale (sipërfaqja), ndikimi i tyre në korridorët e qarkullimit të shtazëve, masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin,zonat me ujëra nëntokësore, zonat me erozion,zonat me deponi dhe ndotje, zonat me mundësi pyllëzimi dhe ripyllëzimi, shiritat e gjelbër, tampon zonat, parqet, tok e ndotur nga pesticidet nuk përmendet as si informatë etj. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden vetëm në pjesën strategjike. Një sfidë e veçante mbetet zbatimi në praktike i këtyre synimeve të HZK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shiritat të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisore të komunës.

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:

- **Definimi në harta i zonave me potenciale rrezatimi, por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit dhe uraniumit të varfëruar në vendet ku është goditur me bomba në luftën e fundit mendohet të paraqitet si një burim vazhdueshëm i ndotjes në komunën e Gjakovës.**
- **Definimi në harta i zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe Vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;**

- Definimi i zonës industriale në aspektin hapësinor dhe të tipit të industrisë dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të zonës duke ofruar bazat për trajtim të zonës industriale me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të precizohen në HZK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si mas të rëndësishme mjedisore.
- Definimi në HZK i zonave, Vijave ose mundsisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi tranzite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera.
- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujrat nëntokësor dhe sipërfaqësor.
- Definimi dhe trajtimi i koridoreve transportuese në aspektin mjedisor
- Definimi i pejsazheve, parqeve dhe monumenteve tjera me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave.
- Trajtimi i ngrohjes së qytetit të Gjakovës por edhe vendbanimeve si një dimension i rëndësishëm i ndotjes dhe ndikimit në ekosisteme.
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.

LITERATURA

- American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press;
- Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2018-2019;
- Raport, Emetimi e Gazrave Serrë në Kosovë 2014-2019;
- Mjedisi i Kosovës 2020 Raport i treguesve mjedisorë;
- Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2020;
- Draft Harta Zonale Komunale e Gjakovës
- Plani Zhvillimor Komunal 2021-2029;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020;
- Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë, Raporti mbi gjendjen 2018;
- Gjendja e Ujerave ne Kosove 2015;
- Raporti vjetor per gjendjen e ajrit 2020;
- Raporti per mbulushmërinë e tokave CLC 2018;
- VSM e PZHK të Komunës së Gjakovës;
- Komuna e Gjakovës. Hartat e prezantuar në PZHK;
- Draft Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030;
- Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë;
- Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches.